

ZIJA ÇELA

**Gjaku i
dallëndyshe**

BIBLIOTEKA

roman

2/11/51
C 37
45912

45912
AR



45912



Në tren.



Në tren



Me t'u nisur treni, ai filloi të më rrëfente.

Dasma u bë në oborr, ndërsa vrasja në rrugë. Nuk mund të thuash që ishte vrasja e parë, sepse e para kishte ndodhur në tarracën e oborrit. Veçse, në të dyja rastet, u vra i njëjti Kristo, Kristo Kubati i fshatit Bardhgolem.

Herën e parë ai u vra ndanë tryezës së pi-jeve dhe të gjithë e pamë se atë e qëlloi Çonda. Kur e vunë kufomën në karrocë dhe e nisën për në zyrën e këshillit, me mend ne i kishim dhënë lamtumirën Kristos. Po në rrugë ndodhi mreku-llia dhe Kristoja u ringjall. Siç ishte i shtrirë në shpinë, ai u ngrit ndenjtur duke u kapur në par-makët e karrocës, pastaj brofi më këmbë. Të gjithë e dëgjuaam se kujt i thirri, të gjithë e pa-më kur filloi të shkujdej dhe, pak nga pak,

kuptuam se po qeshte me të madhe. Tamam në atë çast e qëlluan për herë të dytë dhe kësaj radhe Kristoja nuk mundi të bënte më shaka: plumbin e kishte marrë në shpatull. Po atë mbrëmje, në dafrungën e dasmës, ai kishte kënduar: «Nuk dua të më mbyllësh në zemrën tënde.»

Vrasja tjetër ndodhi rreth një orë më vonë. Ajo u bë në dhomën e dhëndrit, por pa praninë e tij. Madje, pa praninë e asnjë dëshmitari të dukshëm. Ishte një vetëvrasje. Kur po vente për t'u mbyllur në dhomë, Çonda më kaloi pranë, fare pranë dhe, më pas, doktor Zhavelloja më tha: «Të iku nga duart, qyqar!» Fjalën e fundit gjithmonë e kam mbajtur për vete, sado që kurrë nuk kam qenë i sigurt në u tha «qyqar» për mua apo «qyqari» për të vdekurin. Ai përcaktim Çondës nuk i shkonte, ndërsa mua më duhej të pranoja se isha treguar i ngathët. Por as nëpër mend...

Kështu si flet ti, e ndërpreva, duket sikur e ke hetuar ngjarjen. Vërtet ke bërë hetime?

Bashkudhëtari im ktheu kokën nga dritarja e vagonit. E kishte kthyer disa herë dhe unë po krijoja përshtypjen se i vlerësonte ndijimet pa-more. Në një pellg ndanë trasesë lahej një tufë rosash dhe ai kapsalliti sytë. Pastaj pellgu mbaroi, por m'u duk se ai vazhdoi të mendonte për rosat, dhe të mendonte si për ca krijesa që s'dihej kujt i përkisnin më shumë: ujit apo tokës. Kur mbaroi rreshti i plepave, në të majtë u duk toka e rrafshtë dhe andej ajri ishte i bollshëm. Ai nuk kapsalliti më sytë. Ndoshta ia kishte platur vështrimin fusha, me atë thellësinë ndjellëse dhe intime të qetësisë së saj. Edhe vetë sikur u bë më intim, duke m'u drejtuar me «ti».

Pra, përmende hetime?, pyeti. E dija se do të ma bëje këtë pyetje. Kushdo në vend tënd do ta bënte. Kur ndodh një vrasje, jemi mësuar të kërkojmë fajin e individit. Prandaj dhe thirret hetuesi, që të vërë gishtin. Po unë jam Baltazari, babai im binte kushëri i largët, nga e ëma, me doktor Zhavellon. Mos më merr për tjetër njeri? Dikur kam qenë trajner futbollit dhe me ekipin tim jemi ngjitur një vit deri në vendin e gjashtë në spartakiadë.

Papritur, si ta kishte ngacmuar një shkak më tepër, u zgjat dhe mori çantën e dorës në skarën sipër ndenjësve.

Hetime u bënë, por i bëri tjetërkush. Unë u thirra vetëm për të dëshmuar, kaq. Dosja u mbyll, s'kishte kush të dilte para gjykatësit për t'u gjykuar. Për atë që kishte ndodhur, na duhej që secili të gjykonte vetveten. I gjithë fshati. Sidomos unë... E di ti ç'do të thotë të jesh zgjedhur *shoqërues i dhëndrit?! Nuk e di. Se mos vetëm ti nuk e di.*

Baltazari bëri të hapte çantën, po gishtërinjtë iu mpinë në tokëzat e kapakut. Gjatë kësaj vonese të pavullnetshme, kapsalliti sytë përsëri, sikur ajo që po matej të thoshte ishte e pamundur të rrokej me pak fjalë, pasi i përkiste vërtet edhe tokës, edhe ujit, edhe ajrit.

Sa gjëra nuk dihen në këtë botë, foli më në fund. Megjithëse, të thuash të drejtën, bota nuk është dhe aq e madhe. Njeriu është i madh. Dhe njeriu është i madh se, mes njerëzish të ngjashëm, është i pangjashëm. Ajo që ndodh me të dhe që duket e ngjashme me çfarë i ka ndodhur një tjetri, është vetëm një shajni. Të lutem, mundo-

hu të vësh në hesap qoftë edhe këtë hollësi: ai Kristo Kubati që u vra, kishte një zakon të habitshëm: një zot e di përse e kruante fytyrën gjithnjë dhe përse lëkura i rripej përreth mollëzave. Ti ke dëgjuar për gjarprin që e lëshon lëkurën e vjetër në pranverë: po edhe ai ashtu dukej, sikur kishte disa shtresa dhe gjithnjë ngutej për t'i nxjerrë fytyrës lëkurën që i duhej. Atë natë që vdiq, ka qenë më ngacmues se kurrë.

Tashmë Baltazari e kishte hapur çantën. Lëvizja e dorës së tij po bëhej e vrullshme dhe, ndërsa prisja të nxirrte ndonjë atllas të botës ose ndonjë fotografi të Kristos, ai nxori një libër.

E ke lexuar besoj, tha pa e vënë në dyshim. Unë pardje e bleva në Vlorë. Mbarova shërbimin, u mbylla në hotel dhe e lexova gjithë natën. E nisa nga fundi, sepse në fund të pasqyrës së lëndës gjeta titullin: «Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar». Po, lexoja e mendoja me bindje se bota është me të vërtetë e vogël dhe njeriu është me të vërtetë i madh. Ashtu si natyra, njeriu nuk përsërit. E çuditshme, apo jo?

Nuk e mora për pyetje që kërkonte përgjigje, por edhe diç më pengoi që ta merrja si të tillë. Dhe ai, duke u përgjigjur po vetë, e mblo-
dhi tërë lëmshin në një pikë:

Është e çuditshme, sepse ajo vdekje për të cilën bën fjalë ky libër u paralajmërua shumë herë, madje deri dhe pak çaste para se të bëhej vrasja, e megjithatë krimi u krye. Santiago Navrari u vra, binjakët Vikario pranuan se e kishin vrarë me paramendim, dolën në gjyq dhe u dënuan aq sa u dënuan. Të më falësh që po hyj në atë zonë rreptësie, ku i lejohet të hyjë vetëm

shkrimtarit. Por unë kam bindjen time. Po të mundte të ndodhte edhe një herë ajo që ndodhi, Santiago Nasari nuk do të vritej. Ai nuk do të vritej, sepse Anhela Vikarioja nuk do të mundte të gënjente për herë të dytë. Nuk do të vritej, sepse nga të gjithë ata njerëz, që e dinin se krimi do të kryhej, do të dilte të paktën njëri që ta lajmëronte në kohë Santiago Nasarin, duke provuar kështu se *fati vetëm një herë mund të na bëjë të padukshëm*. Më në fund, ai nuk do të vritej, sepse vetë vëllezërit Vikario nuk do të ishin në gjendje ta ribënin vrasjen.

Në rastin e Çondës asnjë paralajmërim nuk pati dhe askush nuk mund të thotë se ditën e dasmës kapi ndonjë shenjë të keqe. Denoncimi, përpara se të ndodhnin vrasjet, ishte i pamundur. Megjithatë, qind herë po të mund të rindodhte ngjarja, qind herë do të përfundonte me gjak. Gjaku po, ishte paralajmëruar. Por hajde kapi ato paralajmërimet që jepen, për shembull, qind vjet më parë!... A të mbushet mendja se ajo që kishte ndodhur është krejt e papërsëritshme dhe ia vlen të ta tregoj?

Ja dhe një hollësi tjetër, shtoi duke nënqeshur, por tani kundër meje dhe në të mirë të ngjashmërisë. Më duket se ngjarjet e «Kronikës» zhvillohen në Karaibe. Për t'u çuditur, fati e kishte sjellë që edhe ai zavalli ynë, doktor Zhavelloja, të kishte qenë përtej oqeanit, por në Indi. Kur u kthye prej andej, solli gjithi-gjithë një këndes plaçka: një hamak, një ventilator, dy-tri erashka, ca vegla mjekësie dhe stringëla të tjera panairi. E vure në hesap këtë rastësi?

Kishim për të udhëtuar nja gjashtë orë të

mira bashkë dhe ajo që vura më tepër në hesap ishte koha. Po ta ndërprisja me gjithfarë përgjigjesh e me gjithfarë pyetjesh që më ngjallte kreshëria e parë, koha s'do të mjaftonte. Më erdhi në ndihmë edhe instinkti i Shternit: njerëzit duhen lënë të tregojnë ashtu si dinë.¹⁾

1) Në romanin e tij «Tristram Shandy» Shterni nuk i përmbahet as kronologjisë së kapitujve. Për shembull, kapitulli i 297 e i 298 gjenden pas kapitullit të 304-t. Për këtë Shterni shprehet kështu: «Dëshiroj vetëm që kjo të jetë mësim për botën që t'i lërë njerëzit t'i rrëfejnë tregimet e veta sipas dëshirës së tyre.» (Shënimet janë të redaktorit).

~~Qytet~~

Pjesa e parë

Shoqëruesi i dhëndrit mbahet mend. Edhe ai i mban mend të gjitha. Unë mbaj mend gjithçka që ndodhi në atë dasmë. Fshati mban mend gjithçka që ka ndodhur nëpër dasma.

Atë mëngjes më ngriti nga dysheku flakërima e agut. M'u duk se në dritare kishin vënë perde të kuqërremtë dhe m'u kujtua *qyleri*, siç i thoshim ne dhomës së dhëndrit. Dhomën e dhëndrit e kisha parë për herë të fundit të hënën dhe, pastaj, nuk kisha vajtur më në shtëpinë e doktor Zhavellos, i cili martonte të birin. Duhej të prisja ditën e caktuar. Atë ditë më zgjoi flakërima e agut dhe, kur dola në kopsht, besova se isha ngritur nga dysheku me cigare të ndezur. Ishte hera e parë që pija duhan esëll.

Matanë gardhit, në kopshtin e tij, rrinte në

stol plaku i Qejvanëve. Qejvan Qejvani më foli pa kthyer kokën:

— Baltazar, e pe togerin?

— Nuk e pashë, — iu përgjigja, duke i dhënë rëndësi pyetjes së tij.

— Këtej kaloi, pra. Kodoshi, kishte nxjerrë në shëtitje gjelin e egër. Unë di se langonjve u bëhet gjimnastika e mëngjesit!

Toger Zhavelloja ishte xhaxhai i dhëndrit, vëlla prej një nëne e një babai me doktor Zhavellon. Ai më kishte bërë një premtim dhe mendova mos kishte kaluar për mua andej.

— I foli kujt? — pyeta Qejvanin.

— I foli gjelit, — tha plaku. — Po më shpëtoj më i foli gjeli atij. S'e di sa u morën vesh njëri me tjetrin.

Bistaku i shelgut që kisha përdredhur në gardh u thye dhe më mbeti në dorë. Plaku ktheu kokën nga unë.

— Kodoshi, — përsëriti.

— E nga ia mbajti toger Zhavelloja? — pyeta.

— S'e pashë as nga erdhi dhe as nga shkoi, — tha Qejvani. — Mua vetëm veshët më kanë mbetur, sy nuk kam më. Po njeriu, edhe duke dëgjuar, mund të shohë. Unë i dëgjova ata të dy që kaluan këtej.

Plaku u ngrit nga stoli dhe u ul në postiqen që ishte shtruar rrëzë plepit. Postiqja ishte e madhe, po vetëm anëve u kishin mbetur ca thekë leshi, pjesa tjetër ishte rrjepur me kohë dhe lëkura ishte holluar aq shumë, sa dukej sikur e kishin kaluar në qostër. Postiqja nuk hiqej nga kopshti që nga pranvera deri në vjeshtë vonë, dhe në fshat thuhej se ajo lëkurë ishte edhe dyshe-

ku i Qejvanit. Sa herë ma kishte dashur puna të ngrihesha shumë herët në mëngjes, plakun në kopsht e kisha gjetur. Megjithatë, nuk besoja se ai edhe flinte aty.

Atë mëngjes unë besova se Qejvani ishte gdhirë në kopsht.

Nxora kutinë dhe piva një cigare tjetër esëll. Plaku nuk pinte duhan. Ai rrinte ndenjtur, me këmbët e kryqosura nën vete dhe kurrizin mbështetur në trungun e plepit.

— Baltazar, — më thirri pas pak, — e hënë është sot?

— E enjte, Qejvan.

E dija mirë që ishte e enjte. Atë mëngjes unë duhej të paraqitesha në shtëpinë ku bëhej dasma. Po nuk mund të shkoja dokurdo. Fshati ende nuk e dinte se cili ishte zgjedhur shoqërues i dhëndrit. Dhe nuk kishte të drejtë ta dinte para castit të caktuar. Secili nga ata që kishte qenë kandidat i mundshëm dinte vetëm kaq: meqë të mbrëmshmen lajmësi nuk kishte trokitur në shtëpinë e tij, ajo çfarë kishte qenë e mundshme mbrëmë, në mëngjes ishte e pamundur. Asnjëri nga ata nuk mund të shkelte i pari në shtëpinë e dhëndrit, ky nder i takonte vetëm të zgjedhurit të tij. Unë isha veshur me petka të mira dhe, që të mos zbulohesha para kohe, nuk kisha dalë në rrugë, po prisja në kopsht.

— E hënë është sot, Baltazar? — thirri edhe një herë plaku.

Unë nuk harxhova frymë t'i jepja më përgjigje. Për atë të gjitha ditët ishin e hënë dhe çdo e hënë ishte një vuaitje. Të hënave kishte njerëz që e kishin parë edhe duke qarë.

Plaku nuk po qante. Ai kishte përpara një kaçile të vogël me rrush amerikan dhe qëmtonte kokrrat më të pjekura. Unë mendova për Lolën, gruan e doktor Zhavellos. Ç'bënte Lola tani? Kishte filluar të zinte brumin për bukën e ëmbël? Ai mëngjes, për së pari, i takonte nënës së dhëndrit. Lola, siç më tregoi më vonë, e kishte zënë brumin qëmenatë. Por u vonua, sepse i shkrepëi të sitte edhe sheqerin. Doktor Zhavelloja i rrinte mbi kokë dhe shante të vëllanë, togerin, i cili në vend që të qëndronte në shtëpi e të kënaqej me ritualin e vjetër të dasmës, nxirrte bidat duke shëtitur gjelin. Gjelat as në Bombej nuk i shëtisnin, tha doktor Zhavelloja. Doli se sheqeri nuk mund të sitej dhe kushedi në e sitnin edhe në Bombej, siç kishte porositur doktori Lola me të kunatën, gruan e toger Zhavellos, u vunë ta dëlirnin me dorë në një tabaka me syprinë biluri. Oriz nuk ishte dhe mel nuk gjetën, por gjetën ca qime zhuke që ishin ngjitur nga thesi. Unë për vete po kënaqem, u fryu qimeve doktori. Të paktën ti të kënaqesh, nxitoi t'i thoshte gruaja e togerit, nga frika mos tjetri kujtohej përsëri për gjelin. Muti i mutit, shau të vëllanë doktori. Po Kondoja gati është?, pyeti të shoqen. Po vete të shoh në e ka mbushur pushkën, nuk dua të më shpëtojë asnjë kënaqësi nga dasma e djalit.

Plaku Qejvan e kishte mënjeluar kaçilen. Edhe këmbët nuk i mbante më të kryqosura, i kishte lëshuar përpara të përthyerë pakëz ndër gju-një. Me duart mbështetur në tokë, ai dukej sikur do të brofte për t'u afruar te gardhi. Mua më vështronte ashtu? Përpara më kishte, me gjysmën e trupit që më dilte sipër gardhit, por nuk

më shihte. Plaku shihte Vogël Hetën. Dikur, në dasmën e Vogël Hetës, ai kishte qenë shoqërues i dhëndrit. Këtë ma pati thënë im atë. Por gjithë fshati e dinte: Qejvan Qejvani kishte qenë shoqërues i Vogël Hetës. Si çdo shoqërues, po ta lypte puna gjatë dasmës, ai duhej të linte edhe kokën për dhëndrin. Kokën nuk e la, u rrezikua të linte nderin. Ajo natë kur Vogël Heta fjeti për herë të parë me nusen, kishte qenë shumë e gjatë për Qejvanin. Shoqëruesi i dhëndrit e kishte pritur mëngjesin gjithë ankth, duke baritur në kopshtin e tij. Pikërisht herët në mëngjes, duke shtënë me pushkë nga dritarja e *qylerit*, Vogël Heta duhej të njoftonte fshatin, dhe bashkë me fshatin shoqëruesin e tij, se nusen që mori e kishte gjetur të virgjër.

Më në fund, u dëgjuan tri të shtëna dhe unë nuk kisha përse të prisja më. E hodha cigaren dhe mora të largohesha nga gardhi.

— Baltazar, — më thirri Qejvani, — i dëgjo ve pushkët?

— I dëgjova, — thashë.

— E hënë është sot?

— E enjte, pra!

— E hënë, e hënë, — ngulmoi plaku. Brofi në këmbë dhe u afrua pranë gardhit. — Vogël Heta më nxori nga pengu: nusen e gjeti të paprishur. Më jep një duhan tani!

I dhashë cigare dhe, kur e ndezi, ai filloi të qante në këmbë. Pastaj më pyeti në kishte kaluar shumë kohë që nga dasma e Vogël Hetës. Pesëdhjetë vjet, i thashë. U kujtova se kishin kaluar plot pesëdhjetë vjet.

— E kam pritur mjaft? — pyeti.

— Mjaft, — thashë.

— Ta kishte gjetur të shoqen të paprishur, do të kishte shtënë me pushkë deri tani?

— Vogël Heta ka vdekur, — thashë unë.

— Po nuk kam vdekur unë, — tha plaku. — Kam qenë shoqërues i tij. A ka ndonjë shpresë sikur ta pres më?

Në të vërtetë, nuk kishte pasur asnjë shpresë qysh atëherë, në vitin 1901, kur Vogël Heta ishte martuar. Të hënën në mëngjes, pas natës së çarçafit, ai e kishte lëshuar të shoqen se nuk e kishte gjetur të virgjër.

— Ndize cigaren, — i thashë.

Plaku nuk e ndezi. Ai qante vetëm me një sy. Syri tjetër, që ishte krejt i thatë, nuk i bindej, ruante një shkëlqim të ftohtë.

— Kush martohet? — pyeti.

Nga kreu i rrugicës që kalonte ndanë kopshteve, erdhi buçima grykore e gjelit të egër.

— Nipi i togerit, — thashë.

Plaku vaisi kokën në një sup, duke dashur të më shihte më mirë. Pandeha se syri i djathtë do t'i binte në tokë. E kishte të rremë, sy prej xhami. E zuri me shuplakë dhe më vështroi me syrin tjetër. Vetëm me atë mund të qante.

— Kodoshi, — murmuriti për toger Zhavelon.

Sado që m'u dhimbs, isha i detyruar ta lija. U largova me mendjen te Kondoja që bëhej dhëndër.

Lola e kishte hedhur në magje sheqerin e dëlirur. Pastaj i kishte thirrur të birit: Kondo, Kondo! Gati është, ishte përgjigjur i ati, Zhavelloja. Im kunat duket sikur do të martohet vetë,

i kishte thënë Lolës e shoqja e togerit. Ua, ai ka shterur me kohë, kishte qeshur Lola. Kondoja ishte afruar te magjja dhe, me tytën e pushkës, kishte përzier brumin e sheqerin. Pastaj kishte dalë në oborr. Doktor Zhavelloja i kishte thënë diçka nga shkallët e tremes, po Kondoja s'e kishte kthyer kokën. Me po atë armë, me të cilën kishte përzier brumin e ëmbël, kishte qëlluar tri herë në ajër për të lajmëruar fshatin e shoqëruesin e tij për hapjen e dasmës.

Vetëm tre-katër vjet më vonë e mora vesh se çfarë i kishte thënë doktori të birit nga shkallët e tremes. I harlisur nga gëzimi i dasmës, doktor Zhavelloja e kishte zënë me të pira që të mbrëmshmen. Në mëngjes ai i kishte ndjekur të gjitha veprimet e Kondos me shishen e uzos në dorë. Por, në çastin kur peri erdhi në të këputur dhe s'mund të kishte më kthim prapa, një mendim i frikshëm e kishte bërë esëll doktorin.

— Kondo, mor bir! — Ende s'ishte dëgjuar e shtëna e parë. — Mendohu edhe një herë, sa ka kohë!

U dëgjua e para.

— Mos thuash pastaj...

U dëgjua e dyta.

— Mos thuash pastaj se të morëm ne më qafë!

U dëgjua edhe e shtëna e tretë. Tani mund të dilja në rrugë i shpallur si shoqëruesi i dhëndrit.

Ishte e enjtja e fundit e korrikut, viti 1951.

Vëre në hesap, tani, po ai Zhavello m'u drejtua mua të dielën mbrëma me qortimin e hidhur: «Të iku nga duart, qyqar!» Natyrisht, këto fjalë

doktori m'i tha pasi ishte dëgjuar krisma e revolverit në dhomën e dhëndrit. Atje paqi vetëm një të shtënë.

Unë e pikasa Çondën që kur u ngrit nga tryeza. Po vendi im nuk ishte më në tryezë, unë rrija në treme. Ndonjëri nga ata që e patën pranë, pohoi sikur ai tha: «Po shkoj të ndahem!» Unë dëgjova vetëm një zë që thujse thirri: «E lini të shkojë, ai ka të drejtë të ndahet me të mbesën dhe dhëndrin!» Të tjerët ia ngulën sytë, si të kishin frikë se mos në ato fjalë fshihej ndonjë kurth, pas vrasjes së Kristos. Qetësohu, pra, qetësohu, i fola dallëndyshes që nuk po gjente qetësi nën strehën e tremes. Ishte varur jashtë folesë, sepse dhoma e saj e vetme prej balte nuk e zinte bashkë me të vegjlit. Për pak, ajo desh u rrëzua dhe më bëri fresk përmbi kokë duke tundur njërin krah. Unë pashë andej, nga tryeza e të zotit të shtëpisë. Doktor Zhavelloja s'e kishte më erashkën në dorë. Llambat me vajguri dhe një hënë e turbullt korriku ia kishin ngjyrosur fytyrën si me një shtresë sarikane. Pikërisht në këtë çast, sipas tij, më paskësh dhënë shenjë për Çondën. Po s'kisha përse ta ndiqja Çondën, në donte t'i thoshte diçka së mbesës, Anës, që prapa derës. Në mënyrën e vet, përpara se togeri të kryente detyrën (siç u shpreh), përpara se ta mbante në gjendje arresti për vrasje (siç po shprehem unë), Conda donte të ndahej disi me çiftin e ri. Qetësohu, pra, qetësohu! Civit-civit!, s'pushonte dallëndvshja mëmë dhe unë s'i dëgjova çivitë e derës. Të hënë, kur kishim mbikëqyrur *qylerin*, isha kujdesur që femrat e menteshave t'i mbushja me një gisht graso. Edhe mandallit i kisha

vënë një shtresë të hollë llaku të zi. Doja ta zbu-
kuroja.

Nuk u afrova te dera, po prita në treme. U
kujtova çfarë thuhej në fshat për të vdekurin,
Kriston, në të gjallë të tij: «Më sa shkulet pylli
nga era, aq të hiqet Kristoja nga dera!» Disa
thonë se vrapuan prapa shtëpisë për t'i folur Çon-
dës nga dritarja. Por nuk arritën: në atë anë nuk
kishte truall oborri. Një rriskë toke kishte rrësh-
qitur pak nga pak, muri ngrihej drejt e mbi
shkëmb dhe në fund të rrëpirës, dymbëdhjetë a
pesëmbëdhjetë metra poshtë, ndodhej shtrati i
thatë i përroit.

Edhe doktori, duan të thonë disa, megjithëse e
njihte shtëpinë e vet, u vërtit një grimë
me të tjerët. Alarmi dhe rrëmuja e morën me
vete. Pastaj ngriti kokën lart e vëzhgoi gjatë, si
të priste ndonjë zbarkim nga ajri. Nuk tha gjë,
nuk përmendi ndonjë emër. Po deri atëherë ve-
tëm ai e dinte që nën çati ishte fshehur një njeri.
Doktor Zhavelloja e kishte vënë të përgjonte
dhëndrin e nusen përmes vrimave të tavanit. Za-
koni nuk e thoshte, po atij ia thoshte koka. Më
vonë, dëgjova se edhe zakoni e lejonte. Përpara
dasmës, doktori kishte pyetur për të gjitha. Dikush
i kishte kujtuar se, në kohë të mëparshme, sa
herë kishte dyshime për natën e parë, çifti mund
të përgjohej. Ai e njihte të birin dhe kishte pa-
sur frikë se, po të mos e gjente Anën të virgjër,
bënte ndonjë mynxyrë me armë. Po kishte pasur
frikë edhe të kundërtën: Kondoja e donte Anën
dhe gjithsesi, të virgjër apo të pavirgjër, mund ta
mbante duke sajuar ndonjë provë të gënjeshtërt.
Ai, të cilit në këtë rast nuk i jepej emër, po quhej

thjesht i Paemri, në kohën e vet e kishte gjetur marifetin: Vogël Heta e kishte hedhur natën e parë duke e shpuar të shoqen me biçak rrëzë kofshës dhe, të nesërmen, çarçafi me «lulen» e gjakut që nxjerrë në gardhin e oborrit. Po kushedi përse, nuk guxoi ta jepte me një të shtënë pushke siharriqin e virgjërisë. Kurse përgjuesi nuk e ruajti të fshehtë, po hapi fjalë. Nga fjalët, Vogël Heta e lëshoi të shoqen.

Nën çati doktor Zhavelloja kishte vënë një rojë. Vetëm roja e pa atë që ndodhi me Çondën.

Ja kështu, dola nga kopshti dhe në krye të rrugicës, ku fillonte xhadeja me kalldrëm, gjeta vërtet toger Zhavellon. Përreth tij ishin mbledhur njerëz që bënë sehir gjelin e egër.

— U mor vesh tani, — më tha, — ti qenke shoqëruesi i Kondos.

— S'e ke ditur?

— Më plaçin sytë! — u betua. — Kjo dasmë po fillon krejt sipas zakonit. Ai Zhavelloja tjetër, — tha për të vëllanë, doktorin, — po tregohet usta e shkuar ustait: ka mbushur një defter me shënime dhe dasma do të bëhet si qëmoti.

— Më ke premtuar një të fshehtë, — e nxita.

— E ç'do të na mbetej deri të dielën, po t'i zbuloja të gjitha?! — qeshi togeri.

Sipas një stereotipi të krijuar s'di qyshkur, ai i lexonte gazetën vetëm të shtunave dhe mburrej që, me të shtunën, ishte në gjendje të nënkuptonte të gjitha lajmet e javës. Pandeha mos dinte ndonjë të fshehtë që do të publikohej të

nesërmen dhe e cyta përsëri. Pse, ç'më di mua, ia bëri ai, gjeneralin Rixhuej?! Dhe shtoi se e fshehta kishte të bënte posaçërisht me mua.

— Po Çondën, — pyeti, — ta ka zënë syri gjekundi?

— Nuk e kam parë, — thashë.

— Flitet se krushka s'e ka ftuar Çondën as në dasmën e së bijës. Shushulla ka vite që nuk i flet me gojë të vëllait. Aman, mor Baltazar, si do t'i vejë filli kësaj dasme?!

— Nga ana jonë apo e krushkës? — pyeta.

S'i vuri në peshore fjalët e mia, si të mos isha fare aty. Pa dëgjo, ma tundi gishtin si duke dashur të më bënte sus, dhe shtoi: Një në dorë, Kim Ir Seni, komandanti suprem i ushtrisë koreane, dhe Peng Ten Huai, komandanti i vullnetarëve kinezë, kanë lëshuar një komunikatë të përbashkët. Ata i japin përgjigje kryekomandantit të forcave të Kombeve të Bashkuara, gjeneralit Rixhuej, për zhvillimin e negociatave mbi pushimin e luftimeve. Dy në dorë, francezit Frederik, kryetar i Këshillit Botëror të Paqes, iu dorëzua çmimi ndërkombëtar për forcimin e paqes midis popujve. Tri në dorë, nga rrethi i Dibrës u nis për në Burrel stafeta e paqes, për nder të festivalit të rinisë botërore në Berlin. Katër në dorë, në centralin hidroelektrik... Dëgjo, Baltazar, nuk ka shenja më të mira se këto për një dasmë. Në paqe do të kalojë!

Ishin të gjitha lajme të vjetra, që ai i kishte lexuar nga fillimi i muajit, ndonjë të shtunë, në gazetë, ose ia kishin thënë në informacionet politike. Ndoshta vetëm ndonjëri më kishte shpë-

tuar, sepse atëherë, për një paragjykim të pashpjegueshëm, nuk e lexoja gazetën të martave.

Togeri e kishte lidhur nga këmba gjelin e egër dhe ia shkurtoi gjalmin duke e mbledhur në kyçin e dorës.

— Shiko, Baltazar, ç'mjekër që më ka nën sqep, hardalli: gjashtë gisht e ka!

— S'kemi arritur te gjashta, — i thashë, — e pesta të mbeti në dorë.

Dhe ai përsëri, si të mos isha fare aty, s'i vuri në peshore fjalët e mia. Pa orën e xhepit dhe lëshoi një fishkëllimë të përmbajtur. Gjeli sec iu përgjigj duke rokanisur me sqep. Paska vajtur vonë, tha togeri.

— Aman, mor Baltazar, kam rënë në hall. Ai Zhavelloja tjetër, — tha për të vëllanë, — pandeh njëlloj si mileti që më vjen prapa, se kam dalë në rrugë për t'u zdërhallur me gjelin. Kurse mua më nxjerr koka tym: t'ia fal gjelin krushkës, që është grua vejushë dhe të vëllanë nuk e qas në shtëpi, apo ta jap ndihmë për Korenë. E ke lexuar gazetën? «Zëri i popullit» shkruante se Selmani nga Gramshi dha pesëqind lekë, tre metra stof dhe një këmishë për Korenë. Unë gjeneral Rixhuj nuk jam, por as më poshtë se Selmani i Gramshit toger Zhavelloja nuk bie! Shko, Baltazar, shko, ty mezi po të presin. Kurse unë do të bëj njërën, në shtëpi nuk kthehem më me gjel!

Ndërsa po largohej, i kujtova përsëri për atë të pestën.

— Ka ndodhur muaj i fortë, — m'u përgjigj. — Tani vrite rradaken e gjeje vetë!

Muaji i fortë do të thoshte me pesë të diela. Dhe e diela e pestë ishte e dasmës së Kondos.

Mora xhadenë nga veriu dhe u nisa drejt shtëpisë së doktorit. Të gjithë sa më shihnin kthenin kokën nga unë, sepse e kuptonin nga petkat që isha i zgjedhur. Plaka e Kubatëve më pa nga dritarja dhe më ndali.

— Prit, Baltazar! — Pas një grime u kthye me një filxhan mjaltë të tretur në ujë. E hodhi shurupin para këmbëve të mia dhe më tha ta kapërceja. — Hap sytë, Baltazar, nuk është çilimllëk të jesh shoqëruar i dhëndrit!

Të dielën mbrëma, po nga ajo dritare, do të jepte kujën kur po ia sillnin Kriston të vdekur.

Te Zhavellot më prisnin vërtet. Por pati një ngatërrësë të vogël. Doktorin ishte në oborr, me shpinë nga porta dhe, kur hyra unë, u kthye i trembur:

— Djall, pandeha se ishte Çonda! Le që zakoni nuk e thotë të vijnë në shtëpinë e dhëndrit njerëz nga të nuses.

Pastaj, duke më zgjatur shishen e uzos, më pyeti, si togeri, në e kisha parë Çondën gjëkund. Pse gjithë ky shqetësim, thashë, Çonda s'ka për të vajtur as tek e motra.

— Fakti që nuk shkon tek e motra s'e përjashton mundësinë për të ardhur këtu, — më kundërshtoi. — Dhe s'është punë shqetësimi, — më kundërshtoi prapë, — thjesht, nuk dua të vijë. Megjithëse ai është burrë i mirë dhe i heq kape-lën.

Doktori zuri me gishtërinj strehën e borsalinës, po për ta hequr nuk e hoqi nga koka. Dhe mua kurrë s'ka për të m'u shqitur nga mendja ai

çast: nëpërmjet qelqit të shishes, pashë një fytyrë krejt të çmeritur. Sado që kishin nisur gjin-kallat, ishte ende herët dhe në ploçat e oborrit nuk ishte tharë vesa e agut. Prej asaj grië të mbyllët e të amullt, m'u duk se gjithë oborri ishte shtruar me pasqyra të prishura. Madje, me të arritur në treme e me të dëgjuar zëra grash në korridor, thashë se për pasqyrat më donin edhe atje brenda dhe më erdhën në majë të gjuhës ca fjalë të ashpra: Ç'keni që më pyesni mua për Çondën, se mos i di unë të gjitha sa kanë ndodhur deri tani, që të parashoh se ç'mund të ndodhë pas-këtaj?!

— Doktor! prandaj u xhingos me të vëllanë, — po i thoshte Lola së kunatës, — togeri s'duhej të kishte dalë nga shtëpia, pa ardhur Baltazari... Hajde, Baltazar, me këmbë të mbarë! Kondoja po pret brenda që ta nxjerrësh ti.

Iu afrova dhomës që ishte përgatitur për natën e martesës.

— Dhëndër, — fola para derës, — jam unë, shoqëruesi yt, dhe tani jam gati të të shoqëroj.

— Ndal! Kondo, mos e hap derën, — thirri doktori. — Harrove të trokasësh, — më tha mua.

Trokita, por jo me çaparin e gishtit. I rashë derës me pëllëmbën e hapur, siç e donte zakoni.

Kondoja doli duke qeshur.

— Më hëngri, — tha për të atin, — të gjitha m'i kërkon një më një. Je i kënaqur, Baltazar?

— Ju keni shumë për të biseduar, — na tha doktori, — bisedoni brenda. Mos janë ftohur kafet?

I kishin shpënë kafet në dhomën e dhëndrit

ende pa vajtur unë. Në qyler nuk pashë ndonjë pasqyrë, por prapëseprapë nuk ndihesha i kthjellët. Kësaj here paqartësinë e kisha me veten. Më duhej ta falendëroja Kondon për nderin që më kishte bërë, po s'e dija përse më kishte zgjedhur pikërisht mua shoqërues të tij. Nga të gjitha ato që çoja në mendje, vetëm një kusht e plotësoja me siguri: isha i martuar. Një beqar, sado i dhënë të ishte dhëndri pas tij, nuk mund të zgjidhej shoqërues. E pyeta:

— Vetë deshe, Kondo?

— Vetë, kush tjetër! — tha ai. — Kam frikë se babai mund të më vërë përgjues të dielën mbrëma. Mos e harro këtë, Baltazar, ai s'duhet të na e hedhë të dyve.

— Po sikur?

— S'do ta doja më jetën, — tha ca fjalë të rënda Kondoja. — T'u themi ta na i ngrohini kafet përsëri?

— Mirë janë dhe kështu, mbase kanë kulluar, — thashë.

Dhe duke pirë kafën turke, doja t'i nxirrja fundin asaj paqartësisë sime. Të fshehtën që më besoi do t'ia besonte cilitdo në vendin tim. Po pse isha unë shoqëruesi? Midis kushërinjve të tij, unë isha nga më të largët. Midis shokëve, prapë kishte të tjerë më të afërt në fshat, por kishte bërë edhe shokë të rinj në qytet. Kondo, nuk pi ujë kaq sa më the, ke ndonjë shpjegim tjetër? Ama dhe ti!, ia bëri ai, duke më kursyer pa më quajtur kokëmushkë ose naiv.

Në atë zgjedhje kishte pasur edhe një shtysë nga doktori. Po e quaj arsye sentimentale. Unë e Kondoja kishim lindur brenda një nate. Të dje-

shmen, fshati ynë kishte jetuar një ngjarje të bujshme: në Livadhin e Garave kishte dhënë shfaqje një pehlivan i huaj, që ua kishte marrë mendjen njerëzve me akrobacitë e tij, sidomos me disa pantomima prej klouni. Në mëngjes që marrë vesh se te Zhavellot ishin bërë me djalë dhe, duke dashur që fëmija të bëhej njeri i madh, ia kishin vënë emrin Pehlivan. Mirëpo u hapën fjalë se, po atë natë, fshati ishte bërë me dy Pehlivanë dhe, ky tjetri, isha unë. Zhavellot na vunë *embargon*, nuk erdhën as për ta gostitur me petulla kushërirën e tyre, mëmën time lehonë. U bë sherr i madh dhe u kërkua të dihej se cili ishte Pehlivani i parë. Fshati dëshmoi se, në fillim, pushka ishte dëgjuar në shtëpinë e Zhavellove, prandaj, në qoftë se do të kishte vetëm një Pehlivan, ai u takonte atyre. Ashtu u bë, por Zhavellot pastaj u treguan zemërgjerë, bile babai i Pehlivanit kërkoi të bëhej edhe nuni im. Meqë plot njerëz ia kishin mësuar emrin atij akrobatit të huaj dhe ata mund të betoheshin lirisht se nuni nuk gënjente, fshati njëloj mund të kishte dy Pehlivanë, mjaft që tjetri të quhej Baltazar. Dhe përsëri ashtu u bë, por u zhbë ajo që u rregullua në fillim. Nuk kaluan as dy javë dhe plaku i Zhavellove vdiq. Plaka nguli këmbë që nipcja të mbannte emrin e gjyshit. Meshkujt e Zhavellove e humbën davanë dhe Pehlivani i tyre u kthye në Kondo.

— E ke harruar se im atë ka qenë nuni yt?

— Ajo që po më tërheq tani është tjetër. —
— thashë. — Kisha harruar se në të dy kemi lindur në një orë.

Dolëm në oborr dhe atje gjetëm doktorin që

vinte rrotull me gratë. Së shoqes, Lolës, ia kishte shkuar krahun *alla bulevard*, ndërsa së kumatës i kishte hedhur supeve krahun tjetër. Në atë dorë mbante edhe shishen e uzos.

— Të të trashëgohet djali, nun! — e përshëndeta.

Doktori i çliroi duart menjëherë dhe bëri me to një gjest të gjerë e shumë domethënës. Ai preku strehën e borsalinës e tha:

— Të heq kapelën, shoqërues, kurrë nuk jam penduar që kam qenë nuni yt. Kështu si shoqëron sot Kondon tim, të shoqërofshin engjëjt në parajsë! Erdhi dita, Baltazar, ta tregosh veten peh-livan të vërtetë, domethënë të shkathët. Me push-tetin e shoqëruesit, ti mund të bësh shumë që im bir ta gëzojë dasmën plotësisht.

— Do ta gëzojë, — i premtova.

Ia mbërriti edhe togeri, duke kënduar nën zë tërë qejf. Por ajo çfarë tha nuk përputhej aspak me pamjen.

— Më ka këputur ca të shara nga gardhi, që ta mbaj mend.

— Kush paska guxuar?!

— Qorri, — tha togeri.

— Ç'ia vë veshin qorrit dhe ti! Plaku i Qejvanëve s'e lan gojën ndonjëherë, ai vetëm të shajë di, — e qetësoi doktori.

Togeri fishkëlleu dhe, te porta e oborrit, ia behu gjeli.

— Ky s'ka më nevojë për gjalm, më njeh nga era.

— S'e dhe?! — u habita.

— S'më la ai, — u shfajësua togeri, — qorri i Qejvanëve. Më një sy njeriu duhet t'i shohë

gjërat të zvogëluara, kurse ai i sheh anapollo. E ndava mendjen t'ia çoja gjelin krushkës. Po sapo hyra në rrugicë, ma priti tjetri nga gardhi: «Ç'e ke atë kalë, toger?» Bah, çfarë syri ka, torollaku! Të paktën ta merrte për kalë edhe Komisioni i Ndihmave, se ia falja Koresë. Më poshtë se Selmani i Gramshit një Zhavello s'ka pse bie! Apo jo, doktor?

Doktori i zgjati shishen. Togeri piu fare pak dhe shtrembëroi fytyrën, si ta neveriste uzon. Atij i pëlqenin më shumë të ngrënat se të pirat.

— Mjaft që të mos zdërhallesh rrugash me gjelin e egër, — tha doktori. — Është turp të të shohë njerëzia, sot është një e kremte për ne: hapëm dasmën e Kondos.

— Më duket se prapë do të fitojë krushka. Ç'të bësh, kështu i do drutë mushka, — qortoi veten togeri. Ndërsa para të vëllait u shfajësua aty për aty: — Në fund të fundit, siç ka derra të butë, ka dhe derra të egër. Po puna është se edhe derrin e egër nuk e jep dot për rinoceront. Hajde, Zhavello, hajde, — ia hodhi doktorit, — ke parë botë me sy! E si, yërtet, sa një elefant ishin rinocerontët në Indi?!

Marr të flas për dasmën, të tregoj për Çondën dhe, dua s'dua, s'më lënë të tjerët rreth e rrotull.

Kuptohet se doktori, nganjëherë, këpuste të trasha dhe e shiste hipopotamin për rinoceront. Si iku dhe si mori rrugët e mërgimit, nuk e mbaj mend, fëmijë kam qenë. Por, kur u kthye, Zogu kishte fluturuar, kishin mbaruar edhe Ducja e Hitleri. Kurse ai, Zhavelloja ynë, kishte bërë për-

pjetë. Ai nuk ishte më një Zhavello, po doktor Zhavello. Dolëm për ta pritur dhe, te sheshi i fshatit, kryetari i këshillit e përshëndeti i pari:

— Ike dhe erdhe, ardhsh për të mos ikur kurrë më! Fshati ka nevojë për ty, doktor, populli po të pret.

— Populli e meriton medicinën, rroftë populli! — thirri doktori. — Rroftë miqësia shqiptaro-indiane!

Këtë parullë nuk do të kishte më rast ta përsëriste, sepse nuk do të kishte më rast as ta dëgjonte. Por edhe unë nuk do të kisha tjetër rast ta shihja doktorin duke hequr borsalinën e tij. E hoqi me një lëvizje të prerë e të shkurtër, plot vendosmëri, pa pyetur se ishte ende pisku i dimrit, koha kur në fshatin tonë fryjnë ato erërat e lagështa që brejnë edhe hatullat e çatisë. Se kush e kishte sjellë nga qyteti me veturë të hapur dhe veç kur e pamë doktorin të ngrihej më këmbë, mu aty te ndenjësja e parë, e të nxirrte kokën tullace sipër baxhës së makinës. Ishte kaq i mallëngjyer, sa u vu të shtypte kapakët e syve me dorë. Qerpikët e rëndë i dridheshin nga pak dhe u jepnin mollëzave të tij diçka prej vezave të peshkut.

— Po, vëllezër, në botën oqeanike rriteshin banane. Banane do të rriten edhe këtu. Ju luftuat për të mirën e përgjithshme, por edhe unë luftova atje. Luftova të bëhesha diçka, që të mundem t'ju jem sa më i vlefshëm! Jepi, Kacel, — i foli shoferit. Doktori filloi të shpërndante ca të puthura me dorë dhe të tundte në erë borsalinën me strehë rrethore.

Ndoshta qysh atëherë, togerit i mbeti ajo shprehja: «Jepi, Zhavello!» Ai arriti me vonesë

te sheshi, gjithë duke u mbushur me frymë prej vrapimit. Dëgjo vetëm fjalët e fundit dhe kushedi në i ra në pjesë edhe ndonjë nga puthjet në erë.

— Cillo, Cillo,— e pikasi në largim doktori. — Nderimet e mia për zonjën, mëmën tënde, Cillo!

— Nderime qenefi, Zhavello! Gomar, po unë jam yt vëlla, — u bë spec togeri. Pastaj m'u kthye mua, si të isha unë fajtor: — Të pjerdhsha në vesh, ç'nun që më ke, mor Baltazar! Kopuku, kujton se polici i sotëm është po ai xhandari i djeshëm. Po unë nuk jam as polic! Kovaç, — i foli kryetarit të këshillit, — del njeri t'ia çojë Cillos nderimet e mia për zonjën mëmë?

— Mos luaj me të fjeturit, toger, Cilloja është në varreza.

— Të pjerdhsha në vesh, Baltazar, për nunin që më ke!

Togeri hodhi duart në bel dhe ndoqi me sy makinën që shkundej, duke u larguar në xhadenë me kalldrëm. Erdhi një çast që vetura u bë sa një brumbull qershor.

Pikërisht në qershor edhe e pashë për së dyti doktorin. U mbyll në shtëpi e nuk bëri çap jashtë gjithë atë kohë. Ata që venin për ta gjetur, ia hëngrën llokumet. Po banane s'pa kush me sy. Gjithë-gjithë, dy kokrra kishte pasur në fundin e një kutie dhe ato i hëngrën që në fillim fare: njëren Lola, tjetren togeri. Kondoja mbeti pa gjë.

Kur vajta unë për vizitë, e shoqja e kishte përgatitur. Asaj ia kishte mbledhur rripat togeri. Po të mos njohë edhe njerëzit e tij, do të thotë se yt shoq ka lajthitur, e kishte paralajmëruar të kunatën.

— Hajde, Pehlivan, — më priti krahëhapur doktori. — Pa shiko, moj Lola, ka mbetur ndonjë banane për të qerasur?

— Nuk jam Pehlivani, jam Baltazari, — thashë.

— Ashtu?! — iu tundën qerpikët e rëndë Zhavellos. — Si e lamë atëherë, moj Lola, do të kishte një apo dy Pehlivanë në fshatin tonë?

Gruaja i foli ca fjalë duke u skuqur dhe u largua nga tremja. Aty mora vesh se edhe Lola s'e thërriste më në emër, po me ofiqin tërheqës; doktor.

— Ah, — psherëtiu nuni im, — vetëm elektriku mungon. Ç'e do mullirin, kur s'ka ujë!

Në tryezën e madhe të tremes ishte vënë një ventilator. Atje nën diellin e verdhë të Hindit, ndoshta doktori ishte mësuar me ventilator. Siç kishte mërdhirë kur kishte ardhur në shkurt, tani që dielli ynë po forcohej, ndoshta kishte nevojë për fresk. Unë isha ulur pranë tryezës dhe helika e ventilatorit më kujtonte fletët e mullirit me erë.

— Më thanë se ke qenë në qytet, — tha doktori.

— Kam qenë, — thashë, — kërkova ndonjë top futboll.

— Ç'film luante atje?

— «Gjergj Sakadze».

— Për t'u çuditur, — tha, — Gjergj Kastriotin nuk e kishin dëgjuar në Indi, në Filipine po. E takove Kondon tim?

— E takova, — thashë, — vajtëm bashkë në kinema.

— Lola, — i thirri befas së shoqes, që kish-

te hyrë brenda për bananet, — më sill çantën e kirurgjisë! Ç'e ke atë puçërr në mjekër, Baltazar? Është një abses dhe duhet hapur.

— Sot kam ardhur të të shoh dhe jo të më shohësh, — thashë. — Nuk e lëmë për nesër?

— Si të duash, — buzëqeshi doktori, — jam nuni yt dhe nuk përtoj. Nesër do të hap dhe ambulancën, më kanë dhënë një lokal poshtë zyrave të këshillit. Të pres, Baltazar.

Lola, megjithatë, e solli çantën, që e vuri në tryezë, ku ishte ventilatori dhe borsalina e doktorit. Po erashkat ku i kishte? Hëpërhë nuk i pashë. U kujtova për fjalët që qarkullonin në fshat. Thuhej se, gjithë-gjithë, kishte sjellë një këndes plaçka. Por, sidoqoftë, ato nuk mund t'i mbartte një këndes çfarëdo. Më vonë, kur pashë gjelin e egër të togerit, m'u duk se ai, edhe pse me vonesë, kishte gjetur tamam «kalin» që duhej për bagazhet e të vëllait.

— Kështu pra, Baltazar, e paske takuar tim bir, — tha doktori. — Ti dhe Kondoja jeni dy Pehlivanë e, prapëseprapë, dy pole të kundërta: domethënë, Veriu dhe Jugu. Mirëpo në Veri e në Jug globi paraqitet në hartë njëlloj i shtypur. Të paktën, kështu e kam parë në Bombej. — Ai kafshoi një llokum, nga ato që solli Lola për mua në vend të bananeve. — Siç e sheh, ti dhe Kondoja jeni dy të kundërta të ëmbëlsuara, gati-gati e njëjta gjë. Dhe nuk ka mësim më të madh nga ai që të jep vetë planeti ku jeton! Po e morët jetën si një sferë të rrumbullakët e të lëmuar, ajo do t'ju shkasë nga duart, Baltazar. Të lutem, kur ta takosh herë tjetër, ia thuaj këtë edhe Kondos.

— Çfarë t'i them? — e pyeta i pasqaruar.

Doktori u tund në hamakun e tij. Me shtratin ajror ai kishte zënë vetëm një rënë anë të tremes. Një palë litarë i kishte lidhur në shtyllat ku mbaronin shkallinat, kurse palën tjetër në hekurat e dritares. Pasi u tund disa herë, u ngrit ndenjor dhe i kërkoi së shoqes t'i jepte borsalinën.

— T'i thuash se një edhe një bëjnë dy dhe se këtë nuk e luan as topi. Ah, sa e ëmbël është jeta, Baltazar, dhe sa bukur do të jetë kur të martojmë Kondon! Po ti për vete qenke martuar shpejt.

Lëvizi nga të dy anët, duke kërkuar erashkat. Një edhe një, natyrisht, bëjnë dy. Po atij ç'i duheshin dy erashka njëherësh?!

Doktorit i mbeti qejfi nga i vëllai për punën e gjelit ose për atë të mushkës e të krushkës që togeri e bëri çorbë.

— Lola, ka filluar të bëjë vapë, — i thirri së shoqes.

Ajo i solli dy erashka dhe ai të dyja i përdori, njëllor si katër vjet më parë, kur i kisha vajtur vizitë dhe e pata gjetur në hamak. I vëllai nuk duroi më dhe u fut në plevicë me gjelin e egër. Unë e Kondoja qëndruam në oborr, duke pritur se mos i shkullnim doktorit ndonjë fjalë për përgjuesin.

— Prapë ka pasur natën aeroplanë, — m'u drejtua ai. — I dëgjove?

— Jo, — thashë, — u zgjova vetëm kur kishin filluar kundërajrorët. Përgjues ishin?

— Spiunë, — tha doktori, — aeroplanë spiunë. Të shohim ç'do të thonë gazetatat e sotme.

Shpesh, togeri i merr lajmet më shpejt se ne, nëpërmjet komandës. Toger, — i thirri të vëllait duke hapur derën e plevicës, ku nxori kokën një qengj bardhosh, — nga kishin ardhur aeroplanët?.. Hm, ç'u bë ky?!

S'e kishim vënë re togerin kur kishte dalë nga plevica. Ai doli edhe nga dhoma e tij me ca bomba në rripin e mesit dhe një automatik anglez në krah. Nuk e dija si dhe ku e kishte kaluar natën, as në kishte fjetur ndopak. Për toger Zhavellon thuhej se mund të flinte më këmbë, si kuajt.

— Ku vajti tërë ajo paqe, toger? — i kujtova bisedën që kishim bërë në rrugë.

— Paqja është një dëshirë, — tha ai, — kurse lufta një realitet. Nuk mund të besohet se natën s'ka pasur gjëkundë desantim diversantësh.

— E nga kishin ardhur kaçatorët e huaj? — përfitoi ta pyeste përsëri doktori.

— Nga ajri, Zhavello! Spiunët e përgjuesit, zakonisht, andej vijnë. — Toger shkundi me pëllëmbë fundin e këmbëzave të pantallonave. Ishte mbathur me opinga dhe iu zbuluan pecat, që ia mbështillnin shputat deri përmbi trinë. — Hap sytë, Kondo, dëgjomë mua: nuk është çudi që edhe ty të të bëhet peshqesh ndonjë përgjues pikërisht nga ajri!

Unë e Kondoja ngritëm kokën përnjëherësh nga çatia.

— Është për t'u dhjerë surratin atyre që shkelin hapësirën ajrore, — shau togeri i ngutur.

— Bëj ç'bëj e kthehu shpejt. I thonë dasmë, — e porositi doktori.

— Edhe të vdekurin, duke e çuar në varreza,

Pajja është dëshira
lufta është realitet

ashtu e qajnë nganjëherë: bëj ç'bëj e kthehu shpejt! — qeshi togeri/ Te porta e oborrit u bë shumë serioz dhe vazhdoi me të vëllanë! — Në luftë e di kur shkon, por nuk e di kur kthehesh. Dhe as nëse kthehesh më. Është për t'u dhjerë surratin atyre që shkelin hapësirën ajrore dhe ta zënë dasmën në fyt!

Doktori e pikasi që po vështronim nga çatia dhe që dyshonim se mos i vinte Kondos përgjues për natën e parë të martesës. Një grimë herë vështroi edhe ai me ne. Pastaj mblodhi erashkën dhe lidhi duart nga prapa.

— Kondo, — i foli të birit, — ja ku ke Baltazarin, shoqëruesin tënd, dëshmitar: dëshiron ta gozhdosh baxhën e tavanit?

— Po, — tha Kondoja. Dhe sesi i hynë në punë ato fjalët e togerit: — Paqja është një dëshirë, unë dëshiroj të jem i qetë me veten. Po të më vihej përgjues për natën e parë dhe unë ta zbuloja, do ta vrisja, cilido të ishte. Dëgjove, Baltazar?

— Dëgjova, — thashë. — Do ta gozhdojmë.

Për të na qetësuar përfundimisht, doktori propozoi që baxhën e tavanit ta gozhdonim që të nesërmen.

Dola për ca psonisje të vogla të dasmës dhe më ra në mend se doktorit i pëlqente fjala *nesër*. Edhe para katër vjetësh ashtu e la me mua, t'i veja të nesërmen në infermieri. Ai e mbajti fjalën, ndërsa unë nuk vajta. Që të nesërmen, doktori e hapi vërtet infermierinë. E shihja shpesh në mëngjes, kur kalonte me çantën e kirurgjisë, disi i fryrë e me trupin drejt si t'ia kishin vënë shpatullat në allçi. Bluzën e bardhë e vishte që në

shtëpi dhe, kështu, dilte krejt i bërë gati. Vetëm borsalinën nuk e hiqte nga koka. Infermiera ishte poshtë, në katin e parë të një ndërtese që ishte përshtatur për këshillin e lokalitetit, postën, zyrën e kadastrës etj. Në qoshen e një muri të jashtëm, nga i binte të kalonte doktorit, dilte nga suvaja një shufër teli, që kishte mbetur prej skelave kur i ishin bërë meremetime ndërtesës. Në mëngjes e në drekë, po dhe herë tjetër kur doktorit i duhej të kalonte nga qoshja e murit, ata që ndodheshin te sheshi bënë sehir në do ta përkulte apo jo pak trupin Zhavelloja. Me sa dukej, borsalina i zinte në tel dhe nga toka ngrihej pluhur, sa herë që doktori shfrynte bulçitë dhe gju-njëzohej për të marrë kapelën e rrëzuar me një «Plaç!» të fortë. «Plaç!» tani e «Plaç!» pastaj, dy vjet duroi dhe është për t'u habitur si nuk plasi edhe vetë. Asnjëherë nuk iu dha ta këpuste atë copë teli ose ta ngrinte më lart. Po ndoshta çdo ditë e linte për të nesërmen dhe, meqë çdo e nesërme ka një të nesërme tjetër, teli mbeti aty. Për ta hequr ndonjë bamirës nuk mund të bëhej fjalë, se edhe vetë miqtë e ngushtë të doktorit vinnin baste me gota rakie. Madje, njëherë, u trazua edhe Kondoja. Kur pa se i' ati e kaloi qoshen pa e pësuar, i thirri sa i hante në kokë: «Më fike, baba! Kisha besim te ti, por e pësova!» Dhe pagoi një shishe të tërë, sepse ndodhi që doktori u përkul pakëz, ndërsa ai kishte votuar për kapelën në tokë.

Unë hyra në dyqanin e shitblerjes dhe mbusha një torbë me karamеле. Bleva gjithashtu cigare të gatshme, se kutinë e duhanit e kisha të vogël. Cigare «Diamanti» morën edhe për Shu-

shullën, më tha shitësi. Po kush kishte marrë «Diamanti» për krushkën? Dola e vajta te qoshja e murit. Doja të shihja në ishte ende teli i bor-salinës. Dikush kishte varur në të një lëkurë de-leje për t'u tharë. Maza e saj ishte ende e ngroh-të, si ajo këmisha e gruas që sapo është hequr nga trupi.

M'u bë se nga prapa, andej nga ishte Rrapi i Kovaçëve, po më këqyrnin në zverk e po flitnin për mua. Nuk m'u dha të largohesha, sepse dë-gjova hapa që vraponin dhe një njeri që qante me lebeti.

— Ç'ke? — e pyetën.

Ai që qante u përgjigj:

— Më ka pickuar gjarpri!

Dhe ai që kishte pyetur, foli prapë:

— Ah, thashë se mos të dhimhte dhëmballa!

U ktheva përgjysmë dhe pashë Çondën, që kishte mbuluar një rën faqe me shuplakë e kishte shtrembëruar qafën andej. Dukej sikur koka do t'i këputej dhe ai kishte vendosur ta mbante në pëllëmbë.

— Nuk do të ndezësh një «Diamanti», Bal-tazar? — më ftoi.

Iu afrova ta uroja për dasmën e së mbesës dhe atij iu bë qejfi shumë. Nuk e dinte ende se cilin kishte zgjedhur Kondoja shoqërues, po më pa të veshur me petka të reja dhe nuhati diçka.

— Më vjen mirë, — tha. — Meqë donin sho-qërues, balanca të peshojë nga të dy anët: me Zhavellot je kushëri nga jot ëmë, ndërsa gjyshi im e ka marrë gruan në fisin tënd.

Unë e dija, po ishte hera e parë që Çonda ma

përmendte se gjyshi i tij, dikur, e kishte marrë gruan në fisin tim.

— Të dhemb? — e pyeta për dhëmballën.

Çonda vështroi thikat e kasapit si të donte të më thoshte se po e çapërlonte dhimbja. Kryetari i këshillit të fshatit, Kovaçi, që po bënte punën e kasapit, e kishte copëtuar mishin dhe po e fuste në thes. Kushedi ç'po mendonte tjetër, po kur ia lidhi grykën thesit dhe ngjeshi trinat e durave prapa ijeve, duke shkrythur kryqet, foli kështu:

— Pse nuk ia jep Baltazarit ta çojë?

— E thamë atë, do ta çosh ti. Dhe ta bindësh time motër të mos hedhë vickla: është tjetër mëria që ka me mua, tjetër borxhi që ka daja për mbesën. Në u dashtë, mos ia zër në gojë emrin tim, i thuaj se e ka nga këshilli këtë mish.

— Sikur t'ia çoja me një procesverbal të këshillit? — u lëkund Kovaçi.

— Puna jote, — tha shkurt Çonda.

Kishte harruar të më jepte cigare dhe e nxori paketën, që ma dorëzoi me ç'kishte brenda.

— Ndize vetë e çoja ta ndezë edhe doktorit. — m'u lut. — E di se zakoni nuk e përmban, po i thuaj e ke nga daja i nuses.

E përkuli kokën shumë andej nga kishte zënë faqen me pëllëmbë dhe qafa iu zbulua deri në rrëzë. M'u duk se për Anën, mbesën e tij të vetme, Çonda ishte i gatshëm të vinte edhe kokën në tepsi.

— Kaq shumë të dhemb? — e pyeta.

— Po çmendem, — tha. — Një fjalë goje: të të zërë dhëmballa e qumështit në pleqëri!

Bëri t'i ndihmonte Kovaçit për thesin, por

u vonua. Tjetri pati kohë të zgjidhte gomarin, që e kishte lidhur te rrapi, dhe ta hidhte thesin mbi samar. Me të lëvizur ne, qentë iu vërsulën zorrëve dhe mushkërive të bardha. Hungërima e tyre na ndoqi përgjatë sheshit.

Pastaj aty u përsërit një skenë gati si në teatër. Ai i gjarprit ishte mbështetur në mur dhe priste sa të zienin gjilpërat në infermieri. Sipër pulpës, për të ndaluar kalimin e helmit, ia kishte shtrënguar këmbën me fashë. Kovaçi, natyrisht, s'e kishte pasur mendjen pak më parë dhe e pyeti:

— Ç'ke, Neço?

— Më ka kafshuar gjarpri.

— Më mirë gjarpri sesa Kristoja, — ia fashiti hallin, sipas vetes, Kovaçi. — Të siguroj, Baltazar, se nuk njoh njeri që ta ketë gjuhën më të helmatisur nga Kristo Kubati. Më ka pickuar njëherë dhe akoma e kam në zemër helmin e tij. Do të shërohesh, Neço! — i thirri tjetrit.

Çonda u kthye anash për Kovaçin apo për Neçon. E kisha ngjitur dhe, nga goditja e supit të tij, e ndjeva se u kthye vrullshëm. Por po i flisnin nga dyqani i opingarit dhe ai u shkëput për të takuar dikë.

E vëzhgova thjesht nga një hamendje. Aty përpara ishin nja dy-tri arka boshe zarzavatesh: ai nuk u erdhi rrotull, i shkelmoi mënjanë dhe vajti drejt e në dyqan. Nganjëherë, për t'u afruar ku donte, Çonda bënte më shumë hapa nga ç'duhej, sikur të mos e llogariste dot rrugën më të shkurtër; herë tjetër i binte pikërisht rrugës më të shkurtër, por pa llogaritur pengesat që dilnin. Më ishte shpifur një hamendje sikur Çondës i

mungonte disi ndjenja e masës në perceptimin e hapësirës dhe të kohës.

— Nuk vjen me mua, Baltazar?

— Jam i zënë me punët e dasmës, — i thashë Kovaçit. — Pastaj, e le të shkoje vetë dhe i zoti e nxjerr gomarin nga balta.

Ai tërhoqi gomarin nga kapistalli dhe tha:

— Po, Kovaç Kovaçi nuk ia ha fjalën Çondës!

S'e di përse, në atë rast, kryetari i këshillit e përforcoi emrin e tij. Përveç Kovaçit, në fshatin tonë kishte dhe të tjerë që mbanin të njëjtin emër dhe të njëjtin mbiemër. E mbanin edhe Qejvan Qejvani, fqinji im dhe Kubat Kubati, vëllai i Kristos që u vra në dasmë.

Mbasi u shuan të dy me armë zjarri, kam pyetur veten nëse ai kthim vrikthi (ndeshja në supin tim) dhe ajo xhindosje e Çondës për të vajtur sa më shkurt në dyqanin e opingarit (shkelmimi i arkave) kishin lidhje pikërisht me Kriston. E dëgjoi Kovaçin kur përmendi emrin e Kristos dhe atë helmin e gjuhës së tij prej gjarpri, apo rastisi që Çonda të kishte ndonjë ngut me atë tjetrin? E kishte në zemër, që atëherë, farën e atij dyshimit të vjetër, i cili, në qoftë se nuk e ndillte për kob, prapëseprapë s'e linte as t'ia kthente shpinën me qetësi? Ç'hije e fshehtë dhe e pashqitshme e ndiqte nga kujtimi i Kanisë, mbesës tjetër, që ai e kishte marrë me vete në luftë dhe pastaj ishte kthyer pa të? Shushulla kishte mbetur shpejt vejushë, po i shoqi e kishte lënë me dy vajza. Duke i ikur njëra e duke mbetur qyqe me tjetrën, ajo

kishte thënë se për Kaninë s'do të ngushëllohej kurrë.

— Është ²llahtari që i gjalli të mos gjejë dot ngushëllim për të vdekurin, — më tha Kubat Kubati, kur i vajta në kryeshëndoshë për Kriston.

Binte një afsh shiu dhe ai kërkoi të më përcillte. Poshtë i thirri së ëmës të na zbriste një çadër me ndonjë njeri. Po prisnim para portës së jashtme, kur u duk plaka në dritaren e katit të dytë.

— Me kë je aty, Kubat? — pyeti të birin.

— Me Baltazarin, nënë.

— Me cilin Pehlivan, me atë që u martua apo me atë që ishte shoqërues i dhëndrit?

— Mos ia vër veshin, — më porositi Kubati.

— U thuaj atyre se Kristoja im tani është në varreza dhe herë tjetër të mos bëjnë dasmë me mish njeriu!

Dikush ia hodhi duart supeve dhe e tërhoqi plakën nga dritarja. M'u duk se ishte Timoja, djali më i ri i asaj shtëpie, që unë e kisha qendërsulmuesin e skuadrës së futbollit.

— E ka humbur fare pas vrasjes së Kristos, — tha Kubati për të ëmën, — rri fillikat në dhomë dhe s'i del më njeriu.

I kërkova të falur që nuk kisha marrë pjesë në varrimin e Kristos. I falur je, më tha, dhe nuk mungove vetëm ti. Ai e dinte arsyeën përse kishim munguar. Shumë nga burrat e fshatit kishin vajtur në Dardhali të përcillnin Çondën, sepse varrimi u bë në një ditë.

Nuk mbetëm krejt vetëm, tha Kubati, përcjellën e shtuan sidomos gratë që e kishin porosi nga burrat. Arkivolin e Kristos e vumë në karrocë

dhe u nisëm në varreza. Përse me karrocë?, u habita unë. Apo... Jo, tha ai, ishim aq burra sa për ta mbajtur arkivolin në supe, po ashtu m'u dha. Kristoja në karrocë vdiq dhe me karrocë e varrosëm. Ka qenë si një biçim kalorësi, Baltazar. Pastaj nuk u pajtua me veten e shtoi: As mish, as peshk, s'di ç'ka qenë im vëlla!

Mërmërima e shiut sikur ia mbyti fjalët e fundit. Mbase edhe psherëtiu, sepse u duk sikur po i mbahej fryma. Sidoqoftë, në atë ulje të pavullnetshme të zërit, kuptohej që po thoshte gjëra të rënda, nga ato që njeriut i dhembin fort e s'mund t'i shqitë lehtë nga vetja, prandaj dhe as ndihet i nderuar, po as nuk i pëlqen të marrë rolin e gjykatësit. Kubati nuk po gjykonte të vdekurin, po të gjallin. Dukej se i vëllai nuk kishte vdekur tek ai. Po edhe mënyra se si kishte mbaruar, nuk e linte të vdiste. Shpesh, jehona e së shkuarës nuk është veçse hija që lënë pas rrethanat.

— S'kam dëgjuar tjetër rast që dikush të jetë vrarë dy herë: një herë u vra në oborr dhe herën e dytë në rrugë.

— Sikur ndodhën tri vrasje, — thashë, — bashkë me atë të Çondës.

— Tri janë, — tha Kubati, — por e para fare ka disa vjet që ka ndodhur. Në njëfarë mënyrë, edhe ajo ka lidhje me dy të tjerat, veçse nuk u bë në dasmë.

Ma kaloi çadrën mua dhe zuri të mbështilte një cigare nga kutia e vet. Muzg ende nuk ishte, po shiu që shtohej e bënte pasditen të errët.

— E ke anuar çadrën shumë nga unë, do të të laget shpatulla, — tha.

— S'e kuptova, cila ishte ajo e para? — pyeta.

E kishte gojën të zënë, se po grinte me dhëmbë kartën e cigares. Pështyu dhe grimcat e letrës sikur u dogjën në flakën e një vetëtime. Më shkoi mendja se edhe fytyra e tij, me atë përzhi-tje pikash të zeza e porët e hapura si hoje, duhet të ishte djegur ndonjëherë. Dhe ishte djegur ose nga shkrumbi i vetëtimave, ose nga shkrumbi i barutit. Kubati kishte luftuar me një brigadë partizane larg këtyre anëve, kishte vajtur deri në Jugosllavi dhe, nga të gjithë burrat e fshatit tonë që dolën partizanë, ai u kthye i fundit.

— S'e kuptove cila është e para?! — foli. — Të m'i kishe thënë këto fjalë me kohë, edhe mundet. Po tani të gjithë po kujtohen për atë të parën. Ti e di historinë e Kanisë? — më pyeti.

— E kisha dëgjuar gjithsesi, po të enjten, tri ditë para gjëmës, e pyeta Çondën dhe ai ma tregoi.

— Tha gjë për tim vëlla?

— Emrin e Kristos nuk e përmendi atëherë.

— Ajo ka qenë e para, Baltazar, vrasja e Kanisë, — tha Kubati. — Ka qenë vrasje apo vetëvrasje, ç'mund të ndërrojë nga kjo?! Por tani, me sa duket, kujtimi i saj u nxit njerëzve nevojën për të gjykuar dy të tjerat. Ma dëgjon një fjalë? — qëndroi në vend.

E kishte ndëzur cigaren dhe, kur e thithte, shihja shkëndijën që i afrohej te goja. Përse po ma kërkonte atë kapar? Me atë shpuzë zjarri, që sikur po e thëllinte për ta çuar drejt e në zgavrën e stomakut, kushedi sa i rëndë do të ishte guri që do të më varte në qafë mua, shoqëruesit të dhëndrit. Ai tha:

— Shko, bëfsh natën e mirë, Baltazar! Po ta lë çadrën se ke një copë rrugë deri në shtëpi. Ndër-

sa të vdekurit, mos ki merak, janë të mbrojtur në varreza.

Nuk pata kohë as ta mbaja, as t'i thosha tjetër fjalë. Por edhe nuk isha në gjendje. Të gjithë e kishim kokën ende të nxehtë dhe ndiheshim të pangushëlluar. Shumëkush kërkonte, gati-gati, një hakmarrje absurde, por pa e kthyer majën e thikës nga vetja. Mendova se fytyra e Kubatit patjetër ishte djegur. Mendova se ka njerëz që, kur u bien mbi kurriz urët e zjarrit, nuk i tundin supet për t'ua hedhur të tjerëve.

Desha ta gradoja nga koka ime e djalli më përmbajti pa i thënë: «Natën e mirë, gjeneral!»

Po, ndoshta, kisha filluar të mendoja për të vdekurit që janë të mbrojtur në varreza. Dhe të vdekurit, vërtet, nuk i trazon as rrebeshi i shiut, po s'dihet sa të mbrojtur janë gjithnjë nga të gjallët.

E prita Çondën derisa doli nga dyqani i opingarit.

— Këtu qenke?! — tha ai. — Të dija tek ime motër tani, me Kovaçin. Të paskam vonuar, Baltazar.

M'u duk se gjuha i qe trashur pakëz dhe, ngaqë gojën e mbante të mbuluar me shami, e pyeta i habitur:

— E hoqe?

— Çfarë të hiqja?! — u habit edhe ai.

— Dhëmballën, — thashë.

— Tek opingari do ta hiqja?! — qeshi.

Më zuri prapa arrçin e qafës dhe ma shtrëngoi. M'u duk sikur po më lëshonte milingona në

kurriz. Ishin mornica dhe ato m'u ngritën në mish nga gabimi që kisha bërë. Megjithatë, shpejtova të çlirohesh nga duart e tij.

— Ç'më di mua, Baltazar, njeri që i ka shkuar koha?! Vetëm dikur, kur më zuri halli i madh e s'kisha si t'ia bëja ndryshe, më ka hequr një dhëmb opingari i Dardhaliut. Dhe e mbaj mend: nëna ime, ndjestë pastë, më vuri ta pështyja gjakun me kallam, që të mos më bëheshin pis rrobat.

Tek opingari e kishin thirrur për t'i bërë dhëmballës banjë me raki të fortë. Gjysmën e shishes e kishte gëlltitur, ndërsa gjysmën tjetër e kishte harxhuar me gargarë. Po gjuha një sfungjer prej mishi është, Baltazar, tha Çonda, thith e shkreta dhe pastaj fryhet. Sidoqoftë, gjuhën e atij Kristo Kubatit unë s'e kam!

Nuk e pashë të nevojshme t'ia thosha këtë përmendje, më pas, vëllait të Kristos, apo më kishte dalë nga mendja? Ato ditët e para të mynxyrës, sikur m'u zbraz koka dhe shumë hollësi të ngjarjes u fundosën tek unë. Vëre në hesap, dy ditë më prapa s'u kujtova t'i thosha gjeneral Kubatit se, në të vërtetë, Çonda ia kishte zënë të vëllanë në gojë. Po deri në atë çast, ende s'e kisha pyetur për Kaninë.

Çonda ishte veshur si unë, me rroba të reja. Vecse të tijat m'u dukën petka arke dhe, ndoshta, tamam atë ditë i vishte për herë të parë. Nuk mund të them se e shtrëngonin, por as se ndihej shumë rehat me to. Për një ditë vere, pantallonat prej shajaku e me kallca të mbërthyera ishin disi të rënda. Ndërsa setra, ndoshta, ishte e lehtë. Por

kadifeja e saj, me një ngjyrë vjollcë të mbyllët, shumë të mbyllët, merrte diell.

— Baltazar, — kërkoi të dinte, kur ia hodha fjalën për Kaninë, — përse më pyet për të vdekurën? Dhëndri, që ti shoqëron, ka marrë vajzën tjetër të sime motre.

I kishte rënë pikës, e kisha prekur ku nuk më takonte. Por Kania kishte shkuar pa dhëndër, pa shoqërues të dhëndrit e pa shoqëruese të saj. Ajo ishte bërë grua pa u martuar.

Çonda i qe lutur së motrës: Shushullë, ma jep mbesën me vete. Ajo nuk ia kishte dhënë, se Kania ishte fare e re. Çonda i kishte thënë edhe një herë tjetër, kur zbriti nga malet. Ajo prapë s'ia kishte dhënë. Çonda s'hoqi dorë dhe, herën e tretë, Shushulla e vuri të betohej se, ashtu siç po ia merrte, edhe do t'ia kthente të bijën. Do të ta kthej, gjallë e shëndoshë, u betua ai.

— Baltazar, nuk më the, pse më pyete për Kaninë? — më kujtoi Çonda.

— Kam dëgjuar gjithsesi, desha të di të vërtetën.

— Baltazar, në këtë botë të gjithë të lënë, — tha Çonda. — Mua që të flas, të gjithë më kanë lënë. Por mos më kundërshto dhe ki parasysh: e vërteta s'është kurrë një për të gjithë. Unë po të them të vërtetën time, ndërsa të vërtetën e saj Kania e ka marrë me vete. E vërteta e motrës sime, Shushullës, nuk çon peshë.

Dhe herën e tretë, ai e mori. Në batalion Çonda nuk e shihte shpesh, por të gjithë e ndienin se, ngado të luftonte, Kaninë e ndiqte betimi i dajës. Pastaj, një ditë, Kania u gdhi ndryshe. Kur e pyesnin se çfarë kishte, ajo përgjigjej: «Mos u

shqetësoni, jam pak sëmurë dhe kjo është po aq e vërtetë sa një edhe një bëjnë dy!» Që një dhe një bëjnë dy, e mori vesh tamam daja i saj, Çonda. E pa një ditë duke vjellë dhe i tha:

— E helmuar je?

— Ndoshta, — tha Kania.

— Ushqimi të ka dogënisur apo të ka helmuar akrepi?

— Akrepi apo bleta, llafe janë këto, dajë!

— Llafë janë, — tha ai. — Po si do të bëjmë?

— Për çfarë, Çondë? — i foli në emër mbesa.

— Shushulla të pret, — tha ai, — i kam dhënë fjalën.

— Im më të presë dhe daja ta mbajë fjalën, — tha ajo.

— Po si?! Kështu as Shushulla të pret dhe as unë nuk mund ta mbaj fjalën.

— Ne njerëz jemi, dajë, nganjëherë fati vendos mbi ne.

Dhe vërtet, i takonte të vendoste fatit. Ose të vendoste gjyqi partizan. Por vendosi Çonda.

Kishim në batalion një burrë të mirë, tregoi ai, një njeri që e quanin Pero. O Pero, i thashë njëherë, mbesa ime është sëmurë. Nuk e di, tha ai, nuk jam këtu për të vërejtur të sëmurët. E ka vërejtur gjithë batalioni, thashë, por njerëzit ende s'janë ndier. S'kam dëgjuar, tha Peroja, dhe sytë nuk na janë dhënë për të parë vetëm të tjerët. Të tjerët nuk mund t'i shohësh, pa parë në fillim veten, më tha Peroja. E shihe veten, pra, e zura unë dhe e pyeta: Sikur Kania të ishte mbesa jote, ç'do të bëje ti? Çdo gjë që bie mbi të tjerët, edhe kur përpiqemi ta hedhim në kurrizin tonë, peshon më lehtë, tha ai. Prandaj, të ishte mbesa ime,

do të flisja ndryshe. Do të flisje apo do të veproje ndryshe?, e pyeta. Për të vepruar, tha Peroja, në rrethanat tona vepron vetëm gjyqi partizan. Dhe gjyqi partizan për faje të tilla, me sa di unë, jep vetëm një dënim.

— Baltazar, — tha Çonda, — s'më mbushet mendja, pse më pyete për Kaninë?

— Jam i ri, — thashë, — që atëherë kanë kaluar vite.

— Shtatë vjet, — tha ai. — Dhe tani që të takoj, duhet të ishe shtatë vjet më i rritur, por po të gjej shtatë vjet më të ri. Ti je fëmijë, Baltazar. Kurse Shushulla edhe atëherë ka qenë grua e pjekur. Ime motër kurrë s'ka dashur të më pyesë për Kaninë.

— E besoj, — thashë.

— Ç'rëndësi ka në e beson, — u ngatërrua ai. — Ti beson të vërtetën time, por të sajën Kania e mori me vete. Bile sot është e vërteta e Shushullës që duhet vënë në peshore.

— E pastaj? — e pyeta.

— Gjyqi, — tha ai.

Ishte një gjyq që ia kishte bërë vetë Çonda. Po ngjiteshim te stanet, tregoi ai. Ajo kishte vjellë rrugës edhe kur po zbrisnim, po e përpjeta t'i zbulon të gjitha. E përpjeta, thoshte Peroja, mund të jetë karrierë për një njeri, rekord për një sportist, dashuri për një femër. Të jetë ç'të jetë, ajo t'i zbulon të gjitha. Baltazar, sepse në të gjitha rastet e përpjeta është edhe një marramendje. Kania vulli dhe unë e pyeta se me cilin e kishte barrën.

«A dihet me kë e pati Krishtin shën Mëria, dajë?» — ma ktheu ajo.

«Ç'do të thuash?»

«Këtu të gjithë janë shpirtra», — tha ajo.

«Janë partizanë, — thashë, — dhe në mes të partizanëve ka dhe tradhtarë.»

«Tradhtari je ti, dajë», — tha Kania.

Ku ishte Peroja? S'e kisha aty. Bashkë kishim qenë dhe na kishte lënë vetëm. Dhe vetëm, njeriu flet sipas vetes.

«Me cilin e ke kopilin, Kani?» — s'iu ndava më.

«Fëmija gjithmonë ka një baba, — tha ajo. — Dajë, nuk jam një shën Mëri.»

«Po s'je as shën Kani», — i thashë.

«Nuk jam. Dhe kujt do t'i vlente të isha një shenjtorë?!»

«Askujt, — thashë, — nuk di që mëkataret t'i kenë vlejtur dikujt... Pero!» — thirra.

«Këtu jam! — u përgjigj më tutje ai. — Zakoni i fshatit dhe gjyqi partizan jep vetëm një dënim për atë dhe për atë tjetrin që fshihet prapa saj.»

«Ç'më rrokanis, Pero, pordhët e tua do të dëgjoj?! Këtu vihet koka në tepsia.»

«Vetëm koka është juaja, — tha ai, — tepsia është jona, Çondë!»

Kur hoqa armën nga krahu, Kania kishte hequr gjithashtu çdo shpresë. E dinte dënimin, sado që ndoshta nuk donte ta besonte. S'e di në e kam besuar edhe unë. Po i afrohesha për t'i thënë të më jepte një shuplakë turinjve, se mbase vija në vete. Por ajo u tërhoq deri në zgrip të greminës. Kur zgjata duart për ta mbajtur, pandehi se ngrita armën për ta qëlluar dhe nuk e pashë më. Atëhere qëllova në ajër.

«Perol!»

«Eja, — tha ai, — nuk ka më nevojë. Tepsinë tani ma lër mua!»

Dhe vajti e tha në batalion se Çonda kishte bërë atë që do të bënte gjyqi partizan. Veçse e paskështa bërë pak më përpara, ngaqë Kaninë e kisha mbesë. Peroja ende rron. Edhe unë rroj, por për time motër, qysh atëherë, djalli ka vetëm një fytyrë: fytyrën time, Baltazar.

Pikërisht këtë çast Çondës i luajti koka përmbi supe dhe ai preku qafën që sikur iu hollua. Po zgjatej për të vështruar diku përpara. Nga tendosja, e hapi edhe syrin e majtë, të rrëzuarin, siç i thoshim ne. Të majtin e mbante gjithnjë të mbyllur, sikur të tjerët nuk duhej të zbulonin se ç'kishte parë me atë sy.

— Ç'i ke ata damarë gjaku, Çondë?

Ai çoi dorën te qafa.

— Ku? — pyeti.

— Në sy, — thashë.

— Ah, — e kaloi ai, — syri merr shpesh ngjyrën e asaj që sheh. Pa shih kush po na vjen!

Po vinte Kovaç Kovaçi me thesin e mishit që ende kullonte gjak. Nuk kishte pasur kohë për t'u tharë.

— Jot motër s'e deshi, — tha Kovaçi. — I thuaj Çondës, më porositi, se mishin e deles nuk e këmbej me atë tjetrin që më solle atëherë. Dhe kështu ma pate sjellë, copa-copa, veçse jo në thes.

Ia patën çuar Kaninë për ta varrosur në fshat. Në trupin e saj nuk u gjet asnjë plumb dhe gjyqi partizan nuk merrte dot vendim as ndaj së vdekurës, as ndaj Çondës. Shushullës i thanë se ishte aksident, por u përhapën gjithfarë fjalësh dhe,

siç u duk më vonë, bashkë me të bijën ajo kishte varrosur edhe të vëllanë.

— Ç'ta bëj? — pyeti Kovaçi për mishin.

— Ç'më pyet mua, këshill je e s'ditke ç'ta bësh!

Çonda ende s'e kishte hequr dorën nga rrëza e qafës, shuplaka ia kishte mbuluar gropëzat e vogla në vijën e gropës së fytit. Pastaj ngjiti gishtin e madh në një anë, treguesin e ngjiti në anën tjetër dhe filloi të fërkonte qafën me gishtërinj lart e poshtë. Dukej se i kishte ngecur një komb që s'po mundej ta gëlltiste.

Gomari ngriti kokën për të pallur dhe Kovaçi, që nuk e lëshonte kapistrën nga dora, e ndaloi menjëherë duke ia zënë kafshës nofullat me sqetullën e tij.

— Hidhua qenve mishin, — tha Çonda, — nuk besoj që edhe qentë të jenë kundër meje.

E ftova të vinte mik në shtëpinë time, por ai ishte i nxehur dhe nuk pranoi.

Edhe gruaja e togerit me mish po dilte nga shtëpia, por ishte mish që mbahej në këmbët e veta.

Në kthim kisha parë në rrugë anëtarët e KOMISIONIT TË GRUMBULLIMIT TË NDIHMAVE. Pandeha se gruaja e togerit po shkonte ta dorëzonte gjelin si ndihmë për Korenë. Por më tha se togeri para se të nisej me FORCAT E NDJEKJES... Këtu mund të bëj një sqarim të vogël: në fshatin tonë, atë kohë, gjithçka që ishte e re ose disi e veçantë shkruhej me shkronja të mëdha dhe gjithçka që i takonte regjimit të përmbysur

shkruhej me shkronjë të vogël. Ndoshta njerëzit e bënin nga padija, ndoshta nga entuziazmi i tepërt. Entuziazmi i fillestarëve gjithmonë është me tepri. Para se të nisej me FORCAT E NDJEKJES, më tha Katerina, togeri ia kishte lënë amanet që gjelin t'ia çonte krushkës.

— Sa për Korenë, — shtoi pa ia kërkuar unë, — im shoq e di vetë. Ai nuk e lë veten të bjerë më poshtë se kurrkush, as se Selmani i Gramshit!

— Po për mua, — e pyeta, — të la ndonjë amanet? Kishte për të më zbuluar një të fshehtë.

— Mos e ke fjalën për «Qimen e Pejgamberit»? — i dogji.

Më ngatërroi keq dhe ika pa i dhënë asnjë përgjigje, sepse nuk e dija ç'ishte ajo «qime». Kam dyshuar gjithmonë se as vetë Katerina nuk e dinte. Për së pari togeri ishte martuar në kryeqytet, në mbrëmjen e 17 nëntorit 1946. Në pranverë i vdiq e shoqja, një tuberkuloze me kavernë, dhe ai u bashkua me FORCAT E NDJEKJES, për së dyti u martua në vjeshtën e vitit pasardhës, por kësaj here mori nuse në fshatin e tij. Një natë gruaja i gjeti në xhepin e xhaketës së uniformës një kuti të vogël metalike. Kutia dukej se nuk kishte kapak dhe se ishte e mbyllur hermetikisht. Por nga njëra anë, nëpërmjet një pjese të tejpa-shme, shihej përbrenda një cullufe flokësh. Flokët, me një përndritje floriri, ishin biondë dhe gruaja ngriti tri versione: Ishin të ndonjë diversanti të rëndësishëm që vinte nga jashtë dhe që i shoqi e kishte asgjësuar fytafytyt? Ishin një kujtim i nënës së tij, plakës së Zhavellove, që kishte rrojtur deri vonë? Apo ishte një nuskë, në një

Besmirë

ZIHALT

formë të maskuar, që dikush ia kishte dhënë të shoqit për t'ia turbulluar mendjen? Toger, i thirri ajo duke i treguar kutinë, vetëm një berberi mund t'i gjenden në xhep xhingla të tilla! Për të qenë burrë, nuk është e thënë të jesh edhe berber, qeshi togeri. Lëre, ç'ke me të, ajo u tregon të gjallëve se janë të vdekshëm dhe të vdekurit i sjell prapë te të gjallët. Kështu është, Katerinë, tha togeri me dorën sipër cullës së flokëve, të betohem për këtë Qime të Pejgamberit! Katerina, siç i pati treguar mëmës sime, as kuptoi ndonjë gjë për të qenë, por as mbeti e zhgënjyer. Ajo qeshi me të shoqin, të cilin e donte pa rezerva. Dhe vetë togeri, nga ana e tij, pakëz i zhurmshëm, por i çiltër e babaxhan, nuk mbante rezerva. Madje duke sikur mund të përshtatej e të kënaqte njëloj edhe shtatë gra, mjaft të marotohej me to.

Në oborr kishin filluar punën dallëndyshet. Një lehonë kishte qëndruar në zgrip të folesë dhe, sado që përpiqej ta ruante drejtpeshimin duke hapur krahët e duke kthyer bishtin, dukej sikur do të rrëzohej. Gjithë koka i shkundej e gjithë trupi i dridhej. Ajo po konte të vegjlit.

I fola Kondos, djalit të doktorit, po s'm'u përgjigj. Hamaku i të zotit të shtëpisë ishte bosh. Në tryezë sikur s'kishte ndërruar asgjë, aty ishin ventilatori dhe dorashkat. Duke ecur drejt tremes, pata kohë të mendoja edhe pak për Çondën.

Ai e kishte hequr setrën, por unë s'e kisha vënë re në kishte apo jo armë me vete. Në anët tona, kush i kishte, në luftë dhe në dasmë shkonte me armë. Çonda kishte ardhur për dasmën e së mbesës, kjo dukej sheshit. Ishte veshur krejt me të reja, ishte qethur kare e ishte rruar edhe kon-

tra. Kjo përkujdesje e veçantë e tregonte si një kujdestar të vjetër konvikti që bëhet gati të marrë pjesë në ngjarjen më të shënuar të jetës: në përrurimin e konviktit të ri. Ai më kishte thënë se, për ta qethur, e kishte qethur kryetari i këshillit. Dhe Kovaçi e kishte tepruar duke ia marrë flokët tepër lart. Në mëngjes, për ta rruar, e kishte rruar gjithashtu Kovaçi dhe ishte ai që i kishte propozuar t'i binte një brisk kontra. Më rropi, më kishte thënë, po ç'del nga kjo? Prapëseprapë, ime motër nuk e do mishin tim. Ai luajti me këto fjalë, pasi i kishte thënë Kovaçit që mishin e dëles t'ua hidhte qenve. Atëherë kuptova se nuk kishte për të trokitur tek e motra para së shtunës, ditën kur bëhej dasma në shtëpinë e vajzës. Deri atëherë do të ishte mik i Kovaçit ose i ndonjë tjetri. Në fshatin tonë, Çondës nuk i mungonin as miqtë, as dashamirët. Ai nuk kishte luftuar më shumë se Kubati. Po Kubat Kubati ishte një gjeneral, shumë-shumë, për fshatin tonë. Kurse gjeneral Çonda ose, siç njihej ndryshe, Çonda i Vitorisë, ishte popullor edhe në qytet. Atë e kishte bërë të dukshëm fati i tij individual, domethënë disa ngjarje e rrethana që, edhe pse mund të përsëriten shpesh, ai i kishte jetuar në mënyrën e tij. Për mua, Çonda ishte një individ që gjithçka ia nënshtronte pushtetit të kokës së tij.

E merr me mend tani habinë time kur, pas pak, dëgjova edhe doktorin të thoshte diçka të tillë. Si vura torbën me karamelle në tryezën e tremes, nuk pata nevojë të thërrisja më, Zhavellot, dolën njëri pas tjetrit. Kondoja i pari. E dyta Lola me tepsinë e brumit të ëmbël. Pastaj doli doktori me një bidon të vogël në dorë.

— Eja, Baltazar, është çasti i zjarrit dhe shoqëruesi i dhëndrit e zbukuron ceremonialin.

U afruam te furra, në qoshe të oborrit, për të pjekur bukën. Doktor Zhavelloja përkuli trupin te gryka e furrës dhe filloi të stërpikte drutë me bidon. Lola i vuri shkrepësen. Pastaj, duke parë të shoqin që po pinte nga bidoni, i foli me një respekt të tronditur:

— Doktor, po më bën të nxjerr zorrët përjashta! E përse u dashka, xhanëm, ky lavazh i stomakut me vajguri?!

— Ah, moj Lolë e gjorë, — nuk ia përtoi Zhavelloja, — megjithëse ke pasur fatin e Penellopës, asnjëherë s'të ka vajtur mendja se yt shoq është një Uliks. Bidoni nuk ka vajguri, po raki njëzet-etrigradëshe. Nuk ka tru njeriu që të mos mpihet prej saj. Dhe e di për kë e mbaj?

Nxora paketën që më kishte dhënë Çonda dhe i thashë:

— E ke nga daja i nuses.

— Kondo, — iu kthye të birit doktori, — e përsëris se shoqërues të dhëndrit nuk kemi zgjedhur ndonjë batall, po një njeri me mend! Po, Baltazar, — më tha mua, — këtë narkozë për dajën e nuses e kam bërë gati. Dhe asaj që nuk e përballon as një elefant i Indisë, nuk mund t'i bëjë ballë as Çonda i Vitorisë! — qeshi.

E lamë Lolën që të piqte bukën dhe u tërhoqëm në treme. Atje doktori i dha një të shkundur hamakut të tij, sikur po kërkonte të zinte dikë në rrjetë.

— Çonda duhet sulmuar në pikën më të fortë, — tha. — dhe pika më e fortë është koka e tij. Le të vijë po deshi, le të bëjë sipas kokës së tij.

Po edhe unë kam kokën time! Do t'ia paralizoj trurin brenda orës dhe, pastaj, të bëhet gazi i botës duke dremitur në tryezë.

Ç'ishte ai shqetësim dhe ajo parapërgatitje e doktorit? Kishte ndonjë parandjenjë apo, thjesht, nuk donte të shkelej zakoni? Mosdashja e tjetrit më shtyu të besoja se pikërisht «pushteti i kokës» mund ta bënte Çondën të dukshëm në dasmën e Kondos. Ndërsa vetë Kondoja e qetësoi doktorin me këto fjalë:

— Baba, ai do të trokasë tek e motra, edhe pse nuk flasin me gojë prej vitesh, por këtu, te ne, nuk vjen. E për kur e lamë të gozhdojmë baxhën e tavanit?

— Ah, ç'po më dëgjojnë veshët, Baltazar! — qeshi doktori. — Kondoja, ndryshe nga ime shoqe, nuk është vënë të provojë fatin e të birit të Uliksit, po prapëseprapë beson se i ati është një Uliks. Po dyshove se mund të bëj ndonjë dredhi me ty, gozhdoje që nesër, Kondo!

Kondoja nuk foli.

— Do ta gozhdosh që tani?

— Është shpejt, — tha Kondoja, — të shtunën, baba.

Doktori i dha një rrotullim me gisht helikës së ventilatorit dhe i thirri së shoqes:

— Lola, furra duhet të jetë nxehur tani. E fute tepsinë?

Kur u poq buka e ëmbël, pandeha se do ta hanim për drekë. Si shoqërues të dhëndrit më kishin instruktuar përsëri, po bukën e ëmbël s'ma kishin përmendur. Buka e dasmës, që gatuhej të

enjen, pothuaj ishte harruar në fshatin tonë. Atëhere mendova se do ta shtronin për darkë. Po bukën e ëmbël përsëri nuk e pashë. Unë e Kondoja e hëngrëm darkën të veçuar, në dhomën e dhëndrit. Aty s'mund të fuste këmbën tjetër njëri. Ishim vetëm, ai dhe unë. Dhe dy kandila të ndezur që bënë dritë. Hanim pa këmbyer asnjë fjalë dhe mua, nga trishtimi i ditës, s'di pse më dukej sikur na kishin mbyllur për të na vrarë aty.

Matanë kishin filluar të vinin burra për vizitën e pasdarkës. Oda e pritjes ishte shtruar rreth e qark me jastëkë të vegjël e të rrastë. Anët nuk mjaftonin dhe jastëkë ishin hedhur edhe në mes të odës. Mua dhe Kondon doktori na mori pranë vetes. Ai ishte ulur në qoshen që shihte nga dera dhe, posa hynte ndonjë fshatar, çonte gishtërinjtë në strehën e borsalinës, por ashtu si dikur nuk e hiqte nga koka. Ngaqë shumicës ia kishte harruar emrat apo nga frika mos ua ngatërronte, të gjithëve u drejtohej me një respekt të përgjithshëm dhe askujt s'ia zinte emrin në gojë: «Nderimet e mia, jeni i mirëpritur në shtëpinë time!»

Se për cilën shtëpi bëhej fjalë, zor ta thuash. Shtëpia e vjetër e Zhavellove i kishte mbetur togerit. Doktori banonte në qytet prej dy vjetësh. Vetëm disa muaj pasi ishte kthyer nga India, ne e morëm vesh se nuk ishte mjek me diplomë, por infermier me dëshmi. Megjithatë, në fshat asgjë nuk ndryshoi: të gjithë vazhduan ta thërrisnin doktor, si më parë. Dhe ai thoshte se edhe atje, në qytet, e kishin marrë për nevoja të medicinës. Por unë e dija se prindërit i kishte tërhequr Kondoja në qytet. Kondoja kishte mbaruar një kurs

për llogaritar dhe, meqë kishte dalë i pari, e emëruan drejtor të muzeut. Atje u njoh edhe me Anën, mbesën e Çondës. Kështu që Kondoja doli dy herë i fituar. Po edhe Zhavelloja nuk humbi gjë prej gjëje, sepse edhe në qytet shumëkush e përshëndeste njëlloj: «Tungjatjeta, doktor!» Natyrisht, Zhavelloja i Bardhgolemit nuk harronte të zinte me gishtërinj strehën e borsalinës dhe t'ia kthente njerëzisë respektin me respekt: «Nderimet e mia, jeni i mirëpritur për një kontroll mjekësor. Tek unë do të gjeni shpëtim edhe sikur t'ju ketë kafshuar kobra e Bangladeshit.» Por meqë kobra nga të Bangladeshit nuk kishte në qytet, ishin të paktë ata që binin në duart e Zhavellos.

Nga dera e odës dikush njoftoi se po më kërkonin në oborr dhe dola me mendjen te Çonda. Jo, nuk ishte Çonda. Ishte kthyer togeri.

— Shët, — ia bëri ai, — nuk dua ta marrë vesh ime shoqe!

— Ajo s'e dinte, — e sigurova, — e pyeta, por të fshehtëm që më premtove ajo nuk e dinte.

— S'të thirra për të fshehtëm tënde, po për timen, — tha togeri. Pastaj, duke e parandier se do të më gëzonte, s'më la as mua fare pezull: — Jotja ka të bëjë me futbollin. Po ti duhet të heqësh dorë nga zakoni yt i poshtër: ta lexosh gazetën edhe të martën. Ah, Baltazar, sa njeri i ndershëm që je! Ma jep dorën.

S'dija përse ma kërkonte, por, sapo i dhashë dorën, më tërhoqi thujse zharg deri në plevicë. Atje ngriti fenerin me bateri dhe ndriçoi kokën e vet.

— Tani, Baltazar, si njeri i ndershëm që je, më thuaj të vërtetën: dukem i shëmtuar kështu?

— Ke ca gërricje në fytyrë që ta prishin bukurinë, — thashë. — I kapët?

— Tre të vdekur dhe një i gjallë, — tha për diversantët. — Ishte një dërdëng që më vuri poshtë dhe gati më zuri frymën me peshën e trupit. A mund të dal me këtë fytyrë në odën e burrave?

U rrotullua në thembrat e opingave dhe më tregoi edhe pjesën e prapme të kokës. Për të qenë më i sigurt, ma dha mua fenerin.

— E sheh ç'ka pësuar pylli im? — pyeti.

— E shoh, — thashë, — i paskan bërë një krasitje.

— Lirishtë, — tha ai.

Prapa kokës, mes flokëve të bërë fërtele, zbardhte një pullë mishi e zbuluar.

— Flokët m'i shkuli ai derdimeni, — tha togeri. — Megjithëse i plagosur dhe shkonte zhdrangër-zhdrungër, nuk m'i shqiti thonjtë pa ia zbrazur koburen në gojë. Si t'ia bëj, Baltazar?

C'ti thosha togerit? Gjithëherë sa futej për të zgjidhur hallet e të tjerëve, më dukej se ai njeri binte vetë në hall. M'u kujtua kutia me atë cullufen e flokëve, por s'mund të bëhej fjalë për t'ia ngjitur me qiriç. Le që ai pylli i togerit ishte sterre i zi.

— Mjafton një banjë, — thashë. — Flokët e qullur krihen nga të duash e mbulojnë ç'të duash.

— Të kripsha mendjen, Baltazar, — kërcëu togeri, — sa njeri i ndershëm që je! — Dyshova se edhe në të dy rastet e mëparshme togeri kishte dashur të më thoshte «sa njeri naiv që je», po s'i kishte ardhur fjala. — Epo, meqë uji qenka ilaçi i vetëm, banjë do të bëj. Të lutem më siguro edhe

pak kolonjë që t'ia hedh shparcës kur të fërkohe. Erën e vdekjes s'e duroj dot.

I çova një shishe me kolonjë si dhe rrobat civile që kërkoi. Së shoqes, siç më porositi, ia ndalova hyrjen në plevicë derisa të përfundonte togeri.

E prita në treme, duke pirë duhan. Kishte dalë hëna dhe në oborr dukej sikur kishin shirë grurë. Nëpër pllloçat prej guri lëvrinte një lëmashk drite që vinte më e verdhëlleme në të mëngjër, në pjesën ku oborri ngrihej me tarracë deri në lartësinë e avllisë. Andej një hendek e ndante avllinë nga xhadeja dhe të gjithë sa ngjiteshin në të përpjetën e rrugës, e shihnin oborrin si në pëllëmbë të dorës. Dikush më pa dhe mua në treme e më foli në emër:

— Baltazar, të pres nesër të kalosh edhe nga unë me Kondon. Dua të jem në këtë dasmë.

— S'po të dalloj cili je, më ka rënë hëna në sy.

— Prandaj je zverdhur aq shumë?!

— Kristo! — i thirra.

— Mos e merr Krishtin për Kriston, — u përgjigj tjetri dhe iku pa e njohur.

— Aman, o Baltazar, ç'zakon të poshtër që ke! — tha togeri duke dalë nga plevica. — Për disa, nganjëherë, nuk ka nevojë të dish kush janë, po çfarë u bën mirë: atij që iku do t'i bënte mirë një bombë me të shara. Tani ma hidh bombën mua, kam qullepsur gjë?

— Një mut, — thashë.

— Ashtu, — s'e prishi terezinë ai, — erën e rëndë të vdekjes s'e duroj dot, po fjalët e rënda s'i kam dhe aq zët kur duhen.

Dhe, si të mos isha shoqëruesi i dhëndrit, po ordianca e tij, togeri ma lëshoi krehrin në dorë që t'ia krijha flokët në pjesën e mbrapme të kokës.

— Do të të paguaj, — bëri shaka, — do të të jap tri monedha nga ato të doktorit. Dhjetë monedha ari solli Zhavelloja nga mërgimi dhe që të gjitha dolën kallpe. Kallp doktor është dhe im vëlla!

Fillova ta krijha, duke ia marrë flokët andej-këndej që t'i mbulohej cullaku.

— Të gjallët e kanë këtë privilegj.

— Ç'privilegj, toger?

— Po ja, — tha ai, — mund të lyhen me kolonjë dhe ta ndiejnë erën e shurupit. Kurse të vdekurit, edhe pse u hedhin parfum, nuk marrin vesh. Çudi është, Baltazar, cdo gjë që ndalon lëvizjen, ka inercinë e vet. Thua ta kenë edhe të vdekurit inercinë e jetës: të ndiejnë diçka në fillim?

— Nuk besoj, — thashë.

— As unë. — tha ai, — por mos u ngut. Ka ndodhur që edhe pula, pasi ia kanë prerë kokën, ka kakarisur. Kurse njeriu është qenie më e lartë se pula.

U ktheva në odën e burrave dhe e lashë togerin në treme me të shoqen.

Kondoja më dha shenjë dhe u ula pranë tij. Më pyeti përse isha vonuar dhe ç'kishte togeri. I thashë se kishte bërë banjë, se e kisha lënë në treme me Katerinën dhe ajo do t'ia thante flokët me dritën e fenerit. Po, tha ai, drita çliron ngrohtësi. Më duk se të gjithë po thoshim ca broçkulla absurde, ngaqë ishim të zënë me mendime të tjera.

— Mbaj erë, Kondo? — e pyeta.

— Ç'erë?

— Kolonjë, — i thashë.

— Jo, — tha ai.

Pata përshtypjen se edhe oda kishte marrë erë. Dhe ishte verë, stina kur edhe të vdekurit që i shtrijnë nëpër dhoma për t'i qarë i spërkasin me kolonjë. Nuk ia thashë Kondos çfarë më vinte në mendje, se nuk ma zinte goja. Ndoshta edhe në mendje më kanë ardhur më vonë, pasi u kryen vrasjet dhe varrosëm të vdekurit.

— Nesër, — tha ai, — nesër në mëngjes do të lyhemi të dy me kolonjë. Sa punë na presin nesër!

Të nesërmen, puna e parë që bëmë ishte brisku i faqes. I hoqëm brisk njëri-tjetrit dhe nëna e Kondos na shtiu ujë me ibrik. Nuk qe ujë i zakonshëm, por i parfumuar me farëza.

Me të pirë kafën e mëngjesit, na e mbështollën bukën e ëmbël në një *strukë*¹ të re dhe dolëm për të ftuar njerëzinë në dasmë. Sipas zakonit, duhej ta nisnim nga shtëpia më e afërt të shtëpia më e largët e fshatit. Po Kondoja tha se do ta zinim nga mëma ime dhe vajtëm tek ajo. Ime ëmë doli të na priste në oborr me djalin tim të vogël hopa. Ajo e përqafoi Kondon dhe ia lëshoi foshnjën në dorë, që mot edhe dhëndri i ri të bëhej me çun. Pastaj na qerasi me dardha uji. Tha se sapo i kishte nxjerrë nga sheka dhe i ki-

1) Dialekt — shami e madhe.

1 py → 100 →
4 x → 350 ←

350
100

shte ruajtur që nga dimri. Lëngun na e nxori me shishe, sheqerin ia kishte hedhur brenda dhe ne duhej ta tresnim duke tundur shurupin aromatik. Në qoshen e murit ishte qeni i lidhur, kurse në dritare kishin dalë gruaja ime dhe Meropi, motra. Meqë isha gdhirë te Zhavellot, nuk e dija si kishin bërë mbrëmë natën për ta zgjidhur qenin. Mendova se e kishte zgjidhur gruaja, po ajo më tha se, me të ikur *i shikuari i Meropit*, në oborr kishte dalë mëma për qenin. Ende pa pyetur, vetëm nga pozicioni i shkallës që ishte shtrirë ndanë murit në krahun tjetër, kuptova se *i shikuari i kishte bërë edhe mbrëmë motrës vizitën e zakonshme*. Ai kishte filluar të vinte që nga Dita e Luleve, më tre maj. Pikërisht atë ditë mbaj mend se ime motër më pyeti: «A kanë nevojë për ndonjë meremetim shkallët, Baltazar?» U ndërrova nja dy ndërfitëse që ishin kalbur dhe i vura shkallët në një vend të dukshëm në oborr. Për të tjerat, domethënë për dhomën ku flinte Meropi, kuptohet se ata ishin marrë vesh mes tyre. Në mbrëmje, kur ne të tjerët kishim rënë për të fjetur, erdhi vërtet *i shikuari*. Ai u ngjit me shkallë deri te dritarja e motrës sime dhe ata të dy u shikuan një copë herë. Vetëm pasi iku ai, dola të zgjidhja qenin dhe, tani e prapa, do të më duhej gjithnjë që qenin ta zgjidhja vetëm pasi të ikte *i shikuari i Meropit*. Tri ditë më vonë, në mëngjesin e Ditës së Shëngjergjit, gjetëm shëlgun te dera e shtëpisë. Atë mëngjes të gjithë djemtë u zgjuan herët, kush e kush të priste shëlgun më të madh dhe t'ia vinte së dashurës te dera e shtëpisë. Ime motër e pa e para. Ajo doli në oborr dhe e dëgjova të këndonte: «More shëlgu i Shëngjergjit, / ç'm'i ke hapur kra-

hët.» I këndonte të dashurit. Por në fshatin Bardhgolem nuk përdroreshin fjalët «i dashur» ose «e dashur», thuhej: *i shikuari* ose *e shikuara*. Dhe nuk thuhej se «bënë dashuri», por *u shikuan*. Natyrisht, të gjithë e dinin se ku i vinte shkallët njëri e ku tjetri. *Shikimi* ishte legal. Si kalonte ca kohë pas këtij afrimi të shpirtrave, të rinjtë do të martoheshin patjetër. Ajo çfarë i ndalohej me rreptësi vajzës ishte zhvirgjërimi. (Edhe shumica e djemve në fshatin tonë ashtu martoheshin, të virgjër.) Prandaj ajo nuk mund të zbriste natën e të mbyllej me të *shikuarin*, ta zëmë, në plevicë. O'kishin për të bërë, duhej ta bënë në dritare: ajo nga brenda, tjetri nga jashtë. Unë nuk e ruaja motrën time, ajo ruhej vetë. Në fund të fundit, të gjitha çupat e fshatit nuk mund t'i shpëtonin provës publike të çarçafëve, gjakut të rritës së parë të martesës.

Nuk di pse m'u dhimbs motra dhe i buzëqesha. Ajo ma tundi dorën mua dhe Kondos. Atij i thirri:

— Ke marrë vajzën më të bukur të fshatit, Kondo. Nuk mund të thuash se Ana s'është si yll!

— Gëzofsh, — e përshëndeti edhe Kondoja dhe ia dorëzoi nënës shishen me ujën e dardhëve.

Në kopsht, kur po shkonim të ftonim për dasmë Qejvan Qejvanin, më pyeti:

— E ka Meropi të shikuarin e saj?

— E ka, — thashë.

— Punë që duket, — tha Kondoja duke vështuar lehen e vogël të luleve.

I kisha lënë sime motre pesë pëllëmbë vend në kopsht. Asaj i duheshin lule për të dashurin. Karafilat ishin mbaruar, por edhe çahma nuk ki-

shte më. Kondoja më ndaloi të këpusja një trëndafil për të.

— Doktorin nuk do ta shihte për shenjë të mirë, — qeshi për të atin. — Qejvan, — i thirri plakut matanë gardhit, — jam i biri i Zhavellos dhe kam ardhur të të ftoj në dasmë. Të dielën mbrëma për darkë.

Plaku u afrua për t'u përshëndosur, por s'u përshëndosh. Kishte dëgjuar vetëm fjalën Zhavello dhe pyeti:

— I cilit Zhavello je?

— I doktorit, — tha Kondoja, — xhaxhai është i ri dhe fëmijët ende i ka nëpër këmbë.

— Zhavello do të bëhen edhe ata, njëllorj si gjithë Zhavello. Ah, kodoshi, — psherëtiu plaku, duke m'u kthyer mua. — Të kujtohet, Baltazar, si ma hoqi togeri floririn nga dora?

S'e kishte harruar i ngrati dhe as që kishte për ta harruar kurrë. Ma kishte përmendur disa herë dhe, gjithmonë, në vend të bënte fajtor doktorin, ia hidhte gjithë fajin Zhavellos tjetër, togerit. Togerit ishte ai që, sipas fjalëve të plakut, e kishte përmbysur kandarin. Në të vërtetë, togeri vetëm një fjalë kishte thënë. Unë isha ndodhur rastësisht te Zhavello, kur erdhi Qejvan Qejvani. Erdhi të vizitohej te *heqimi* i Indisë. Doktor Zhavelloja pak muaj kishte në Bardhgolem dhe meqë në fshatin tonë mungonin sëmundjet veneriane, që ai i quante po aq të rrezikshme sa kobrat e Bangladeshit, për të tjerat klientela as që kishte përse të pyeste, mjaft të binte në duart e tij. Qejvan Qejvani, herë pas here, ndiente ca si therje të thella në syrin e djathtë. Në të vërtetë, i tha doktorin, ti ke të sëmurë të majtin. Pa lëviz

qepallat! Ai dyshonte se ndonjë nga ata zuzarët e fshatit e kishte dërguar plakun për t'u tallur e për t'ia nxjerrë të palarat e medicinës në shesh. Qejvani u mundua, por syri i majtë s'ia bëri fërk. E kam të vënë të majtin, tha, e kam prej xhami. Ashtu?!, i fryu doktori duke hungëruar nën dhëmbë dhe u largua menjëherë nga tremja. Pande-ha se vajti për të marrë «çantën e kirurgjisë», kur, papritur, u kthye me një peshore që e vuri gjithë tërsëllëm mbi tryezë. Ndoshta, sipas tij, ata që kishin dashur të talleshin me të, kishin rënë vetë keq brenda dhe tani Zhavelloja do t'u punonte një reng që «t'u bënte bum rradakja». I nxehur siç ishte, zbrazti një kuletë me dhjetë monedha ari në tryezë dhe e sfidoi Qejvanin: «Zotëri, mua kërkoni të ma hidhni?! Po të jetë se syri juaj është prej xhami, atëherë vëreni në balancë dhe do t'jua peshoj me flori!» Më habiti edhe joshja, edhe mirësjellja e doktorit. Me siguri, ai i fliste Qejvanit në shumës, duke pasur ndër mend ata që fshiheshin prapa tij. Plaku, të thuash të drejtën, nuk e zgjati; u kthye në ije, mbuloi fytyrën me pëllëmbë dhe, pas një grime, vuri syrin në peshore. Natyrisht, e kishte radhën rradakja e doktorit të bënte bum. Por me kokën në vend a pa kokën në vend, edhe ai nuk e zgjati: hodhi në anën tjetër të peshores një monedhë ari. E ku ta dija unë atëherë se ari i doktorit ishte kallp! Megjithatë, krahu i balancës nga syri nuk u ngrit dhe Zhavelloja u detyrua të hidhte monedhën e dytë. Pastaj hodhi të tretën, të katërtën... të dhjetën, e prapë peshorja nuk u ngrit. Plaku thujse ishte shushatur nga mahnitja, nga ajo pasuri që zoti vetë po ia hidhte nga qielli. Ai kishte

mbuluar gropën e të majtit me shuplakë, ndërsa në syrin tjetër i dridhej një dritë e verdhë floriri. Ma hodhe, ronxho, u dorëzua doktori, po mone-dha të tjera s'kam, si të bëj tani? Mua më pyet si të bësh, ia mblodhi Qejvani, në fshatin tonë nuk mbahet mend që dikush të ketë vënë bast dhe të mos e ketë mbajtur fjalën. The se syrin do të ma peshoje me flori? Peshoje tani!

Pikërisht në këtë çast hyri në lojë togeri. Ai po lustronte këpucët në oborr, ulur në një karrige portative dhe, kur dëgjoji gërnjën, foli prej atje: Jepi, Zhavello!

Doktori thujse u marros. E ndjeu të vëllanë që po afrohej dhe shkoi kokën prapa nga marazi: A ç'më çan veshët edhe ti! Pastaj hoqi nga gishti unazën dhe, duke dashur të bënte hile në peshë, e shoqëroi në peshore me një mëshuarje me gisht. Krahu nga ishte syri lëvizi, po ra përsëri dhe nuk u ngrit më. Lola, i thirri së shoqes, m'i sill lugët e çajit! Doktori e flaku borsalinën në hamak dhe u kuptua sheshit se koka po i plaste së brendshmi. Do të të mund, ronxho!, iu kërcënua plakut dhe tundi bishtat e lugëve të kromuara, si të ishin një dyzinë kamash floriri. Një!, e paralajmëroi. Dy, tri... Kur hodhi lugën e gjashtë dhe, më në fund, krahu i peshores nga ishte syri filloi të lëvizte, doktori mori zemër dhe i lëshoi të katër lugët e tjera njëherësh. Por peshorja, sado që premtoi, nuk u vu në drejtpeshim. Atëherë doktori as që pyeti më: hoqi nga jeleku orën e xhepit dhe e lëshoi në peshore me zinxhirin bashkë. Befas, kur u kthye nga e shoqja dhe e urdhëroi t'i jepte varësen e qafës, togeri u zgjat në tryezë dhe e mbuloi peshoren me trupin e tij. Noksan njeri ja.

o Zhavello, i foli të vëllait, jo varësen, po sikur gjithë arin e botës të vësh në këtë peshore, me syrin nuk ia del dot: akoma s'e di që syri i njeriut është tamahqar?!... E rrëmbeu peshoren dhe vajt ta zbrazte në kuzhinë. U kthye prej andej, gjithë-gjithë, me një lugë dhe një gotë ujë. Kujdes mos e gëlltisësh, i tha plakut, kishte nevojë për një banjë. Nga fundi i gotës na shihte syri i çuditshëm prej xhami, që dukej si një shpirt fsheharak djallëzor. Si e përcolli Qejvanin me të vetmen trofe në brez, lugën e kromuar, togeri i tha të vëllait: E ku ta dish, Zhavello, mundet që edhe shpirtrat kanë nevojë vërtet për banjë. Me atë peshore, para ca ditësh, u ke shitur të sëmureve me cermë bimë mjekësore dhe në krahun tënd, në atë të peshave, kishe harruar nën pjatë një pllakë hekuri!...

— Ah, kodoshi, — mërmëriti plaku në anën tjetër të gardhit. — I cilit Zhavello është ky djalë, Baltazar?

— I doktorit, pra, — s'iu durua Kondos, — të thashë një herë. Të dielën mbrëma je i ftuar në dasmë.

— Të dielën mbrëma, — i thashë Qejvanit, — do të të vijë këtu pjata me mish dhe shishja me raki. Ndoshta s'të bëjnë më këmbët për dasmë.

E tërhoqa Kondon nga gardhi dhe dolëm në rrugicë nëpërmjet deriçkës me trinë të kopshtit.

— Nuk e pyetëm nënën tënde, — tha, — në mund të hamë ndonjë kafshatë nga buka e ëmbël.

— Nuk mundemi, — thashë, — ajo u kujtua të më porosiste vetë.

— Është shumë e hidhur ajo që i ka ndodhur

Qejvanit në shtëpinë tonë, — vazhdoi Kondoja.
— Makar, t'ia kishim ëmbëlsuar gojën.

Bukën e mbaja unë. Fjalë të tjera nuk i thashë, po *strukën* s'm'u duk e udhës ta zgjidhnim. Lola e kishte lidhur katërsh, me një nyjë që ma zinte dora mirë.

Sapo dolëm në xhade, Kondos i vajti mendja të trokisnim te Kovaçët. Po të vazhdonim drejt, Kubatët i kishim më pranë, po ai kishte frikë se, më vonë, Kovaç Kovaçin s'e gjenim në shtëpi, pasi vente në këshill.

— Ti e di kë do të takojmë atje, — tha.

— Kë do të takojmë?

— Çondën, — tha ai. — Mos u hiq sikur dje s'keni ecur bashkë një copë rrugë.

Më tërhoqi në rrugicën e Kovaçëve dhe më la mua ta shtyja portën i pari. Çonda po rrinte në stol, mbështetur në rrethin e pusit, ndërsa Kovaç Kovaçi merrej me armaturën e një solete që do t'i hidhte derës së hajatit. As që u habita. Në fshatin tonë thuhej se gjithë burrat, prej së hershmi, bënin nga shtatë zanate: nallbani dinte edhe mistrinë, opingari bënte edhe punën e avokatit dhe avokatit, po ta kishim në fshat, do t'i duhej të mësonte zanatin e samarxhiut.

— Ejani, more, — tha Kovaç Kovaçi, — kam një orë që ju pres dhe më latë pa dalë në zyrë.

Në faqen e jashtme të murit të shtëpisë ishte shkruar me bojë të freskët: **LËMIN E PARË SHTETIT.**

— Ç'e ke atë parullë aty? — i thashë.

— Provuam bojën, Baltazar. Do ta fshij, — qeshi, — se ka rrezik që njerëzia të ngatërrojnë depot e shtetit me koçekët e mi. Është fort i ri

pushteti dhe deri tani të gjithëve sikur u vjen gjynah ta vjedhin. Prit të kalojnë ca vjet e do shohësh si do të rriten duart. Bozë apo qumësht?

I thashë se do të dëshironim kafe dhe ai na nxori karrige që të rrinim pranë Çondës. Çonda u ngrit e pështyu tutje. Akoma i sëmbonte dhëmba-lla dhe po i bënte gargarë tjetër me raki. Na kërkoi të falur me «ju kam si djemtë e mi!». S'di pse i tha këto fjalë, kotsëkoti. Ai kishte folur me sytë nga unë.

Kovaçi i thirri së shoqes për kafet, por ajo solli edhe qumësht të ftohtë.

— Baltazar, — tha Çonda, — dje, aty nga dreka, të çova një lajmërim, po nuk m'u përgjigje.

— Të kam mashtruar, — tha Kovaçi, — Baltazarit nuk ia çova fjalën tënde. Është shoqërues i dhëndrit dhe nuk desha ta ngarkoja.

— Kujt i paske çuar fjalë? — pyeta Çondën.

— Miqve, — tha, — atyre që i kam ose kujtoj se i kam miq. Afër drekës u çova fjalë me Kovaçin: «Ejani, Çonda ka bërë një gjak dhe ju pret sa më parë.» Tani dëgjo çfarë i thanë Kovaçit. Xhemë Kurti: «Si t'ia bëj, kam vënë kusinë e qumështit në zjarr dhe kam frikë se më derdhet.» Gurba i Norës, ai që dikur e pata marrë me rrogë në burg si gardian: «Më ke gjetur ngushtë, se m'i ka larë gruaja pantallonat, ja ku janë në tel!» Opingari: «I thuaj Çondës se erdha, sa të mbaroj perin që kam në gjilpërë.» Po s'erdhi as njëri e as tjetri në drekë. Më duket se u trembën, kujtuan se kushedi çfarë gjaku kisha bërë dhe u desh të prisnim darkën. Deri në mbrëmje opingari e mbaroi perin e gjilpërës, Gurbës iu thanë pantallonat në tel dhe Xhemë Kurti, më në fund, e hoqi nga

zjarri kusinë e qumështit. Kovaçi u vuri përpara mishin e pjekur dhe u tha: «Hani e pini tani, ky është gjaku që ka bërë Çonda.» Ishte delja e the-rur, Baltazar. Atë mish që desha t'ua hidhja qen-ve, e hëngra me ata që i kam miq ose kujtoj se i kam miq.

Më kishte mbetur filxhani i kafes në dorë dhe u ngrita për ta vënë mbi rrasën e pusit. Kondoja e kishte pirë më parë. Kafen gjithnjë e pinte të nxehtë.

— Do duhan tani? — pyeti Çonda.

Ai më pyeti mua, po cigare i dha edhe Kon-dos. Kondoja e ndezi, megjithëse nuk e pinte du-hanin. Dukej se në prani të njëri-tjetrit të dy ndiheshin ngushtë. Çonda e la paketën sheshit, kurse nga xhepi i setrës nxori kutinë e aspirinave.

— Kam dëgjuar se doktori e ka zgjidhur qesen mirë, — tha Kovaçi, — do të bëni dasmë të madhe.

— Fshatçe, — tha Kondoja.

— Fëmija që i vdes nëna mbetet jetim. Ana nuk është jetime, se ka Shushullën, — tha Ko-vaçi. — Po ajo s'ka baba dhe fëmija që i vdes i ati mbetet i varfër. Në shtëpinë e Shushullës dasma do të jetë tjetër.

Çonda rrotulloi kokën përgjysmë, si për ta hequr nga pamja Kovaçin. S'i kishte pëlqyer ajo që kishte thënë i zoti i shtëpisë. E pashë që vuri aspirinën në gjuhë dhe vetulla, përmbi syrin që e mbante mbyllur, iu rrëzua edhe më poshtë. Sesi m'u mbush mendja se nuk kishte për ta hapur gojën më, sado të rrinim aty.

— Të dielën mbrëma, për darkë, — i thashë Kovaçit.

— Atje më keni, — tha ai dhe doli të na përcillte.

— Kondo! — u bë i gjallë Çonda, sapo arritëm te porta e oborrit. Ishte ngritur në këmbë dhe po na vështronte me një sy, sikur të na kishte vënë në shënjestër. Pastaj e hapi edhe syrin e rrëzuar dhe ngriti zërin: — Mos harro si e kemi lënë me fjalë, dhëndër!

Kondos iu zhubravitën cepat e gojës, se po matej të fliste. Por nuk foli menjëherë. Pastaj tha:

— Ndoshta s'ka më nevojë. Punë fjalësh, dajë!

— Si e paskeni lënë me Çondën? — e pyeta në rrugë.

Nuk m'u përgjigj. Mendova se ose nuk kishte rëndësi ajo që kishte lënë me Çondën, ose tani ishte penduar dhe nuk dëshironte ta kujtonte më. Ai e kaloi fjalën te Kovaçi; kishte harruar ta pyeste në kishte rënë në gjurmët e këmishës së hekurt. Po ta futja në dorë atë këmishë, tha, do të siguroja për muzeun një objekt unikal.

Për këmishën e hekurt unë kisha dëgjuar qysh në fëmijëri. Disa thoshin se ishte e kohës së Bizantit, të tjerë se i takonte një pashai osman që kishte ardhur në anët tona me një ekspeditë ndëshkimore. Të tjerë e lidhnin me një stërgjysh të Zhavellove, emigrantin e parë të fshatit tonë që, qysh më 1803, kishte hapur një dyqan armësh në Damask të Sirisë. Sipas një varianti më të besueshëm, këmisha lidhej me Kovaçët. Atyre iu dhimbs një djalë i Kurtëve, mashkulli i vetëm që kishte mbetur në atë fis të vogël për shkak të gjakmarrjes. Për ta shpëtuar fisin nga shuarja, kovaçi i Bardhgolemit farkëtoi për djalin një këmishë të hekurt, që të mos e shponte plumbi.

Thuhej se në fshat kishte njerëz që e kishin parë me sy këmishën. Por ajo herë dukej e herë zhdukej. Madje, tani që po shkonim te Kubatët, më dukej sikur do ta gjenim atje. Gjatë luftës së fundit, sa herë dëgjohej ndonjë trimëri e re e Kubat Kubatit, kishte njerëz që besonin se atë nuk mund ta zinte plumbi pikërisht për punë të këmishës. Po në fshatin tonë kishte dhe të tjerë burra trima, burra të kamur, ose burra me gra të bukura, për të cilët thuhej se *kishin lindur me këmishë*.

— Sikur të hynim brenda te Kubatët, — i thashë Kondos, — dua të takoj Timon.

— Hyjmë, — tha ai. Dhe, siç po matej t'u fliste nga dritarja, trokiti në portën e shtëpisë që binte drejt e në xhade.

Plaka na ngjiti në katin e dytë dhe na futi në kuzhinën ku rrinin njerëzit e shtëpisë. Aty vinte erë gjalpi të djegur dhe dukej se amvisa kishte përvëlur kaçamak, në mos dikujt sapo i kishte skuqur vezë. Doli se kishte përvëlur kaçamak të hollë, gati si një lloj supe të ujshme, sepse u ndie e kënaqur të na gostiste përpara glikosë. Pastaj, ende pa e pyetur, u shpjegua vetë:

— Kubati ka rënë mbrëmë vonë dhe nuk është zgjuar nga gjumi. Po shkoj t'i them për ju.

— Nënë, për ty njëlloj duhet të jetë, — qeshi dikush që po vinte në kuzhinë, — një Kubat për një Kubat, mjaft që ky i dyti të mos jetë kurbat.

Erdhi të përshëndoshej Kristo Kubati që, për nga mosha, binte djali i dytë i shtëpisë. Ishte veshur me një këmishë të verdhë shafran, kopsat ende s'i kishte mbërthyer dhe, kur më përqafoi,

AB - Ashi

m'u duk sikur do të më pudroste me squfur. Por, në të vërtetë, ai mbante erë sapun e kolonjë. Në fshatin tonë zor të kishte beqar tjetër që, duke qenë në moshën e burrit, të ishte aq i pashëm sa Kristoja.

— Ç'thotë doktori, — iu drejtua Kondos, — e ka marrë me vete helikopterin apo e ka lënë në qytet?

Ai njeri seç kishte diçka prej fëmije: i pëlqente të luante me gjithçka e kurdo. Njëherë kisha dëgjuar Qejvan Qejvanin të më thoshte: «Kristo Kubati është e zeza e mendjes së vet: atij edhe një pulë po t'i falësh, s'e merr për ta ngrënë, po për t'ia numëruar puplat!» Mirëpo me namin për të luajtur e tepronte dhe shpesh bëhej ngacmues.

— Ç'helikopter? — u habit Kondoja.

— Atë pra, ventilatorin me helikë. Mbjaj mend se po ta ktheje horizontal, ventilatori i doktorit dukej si helikopter dhe, kur e shihje në këmbë, dukej si mulli me erë. Ne jemi mësuar gjithmonë që erën ta lëmë të shkojë dëm, Kondo. Po të kishim pasur mullinjtë me erë në fshatin tonë, s'do të bija në burg atëherë.

Po fuste këmishën në pantallona dhe, pranë togëzës së rripit, vura re se kishte bërë një ngjitje me nastroizolant. Me helikë apo pa helikë, ai e kishte mbaruar fluturimin: kishte gjetur mënyrën për të na kujtuar, shpejt e shpejt, se faji i tij kishte qenë i rastit. Po se mos e kisha mendjen te faji i tij! Mua më duhej Kubati i tretë, Timoja, që luante mirë futboll, dhe pyeta për të:

— Ta kisha ditur, — tha Kristoja, — nuk e lija të dilte nga shtëpia. Ai doli shumë herët dhe

tha se do të shkonte në qytet t'i bënte një radiografi gjurit.

Isha i sigurt se Timoja nuk ankohej prej kohësh nga gjuri, po ndonjë dyshim nuk shfaqta aty. Kurse ai u habit me mua: ç'më paskësh shkrepur për ndeshje futbollit kur të dielave, në raste dasmash, në fshatin tonë bëheshin gara të tjera sportive?!

— Ti si gjithnjë në rolin e trajnerit, — më tha. — Timos do t'ia ketë mbushur mendjen doktor Zhavelloja. Dje pasdite kanë pirë bashkë në dyqanin e shitblerjes dhe ai e ka kandisur për grafinë. Mjekëve u pëlqen të dinë çfarë ka nën lëkurën e njeriut, po se çfarë ka mbi lëkurë, nuk e shohin, — bëri aluzion për sëmundjen e tij.

E kishte futur këmishën në pantallona dhe sipër kishte veshur një jelek pa mëngë, në ngjyrën e bukës së djegur. Ajo farfurima e shafranit nuk bëlbitej më në fytyrën e tij. Po edhe ngjyrën natyrore, prapëseprapë, e kishte të zbehtë. Ndoshta ishte kruar pak më parë, sepse në ballë dhe përreth mjekrës kishte një pluhur të imët prej lëkure të prishur. Vetëm në faqe kishte ca ngjyrë trëndafili të hapët dhe bulat e lëkurës së re ishin fare të freskëta, si thonjtë e foshnjave.

— Baltazar, — m'u drejtua, — më jep një premtim?

Nuk m'u duk se donte të bënte ndonjë fluturim të dytë, edhe pse përgjigjja ime, për vetë mënyrën si ishte bërë pyetja, mbeti një grimë herë në hava. Përkundrazi, Kristoja u ul pranë meje, sikur të donte të më prekte me dorë.

— Mua kështu më erdhi jeta, — vazhdoi, — tani që mund të isha baba me fëmijë, jam ende

beqar. Më premtan se më vjen shoqërues në dasmën time?

— Shoqëruesi zgjidhet, — thashë, — por shpallet vetëm tri ditë para dasmës. Ndërsa ti ende s'ke ke gjetur as nusen.

— Do ta gjej, — tha. — Të gjesh një nuse të mirë nuk është aq e lehtë sa të gjesh një pelë shale. Por pela shale dhe nuse të mira nuk ka vetëm fshati ynë. Unë as që çaj kokën për ata që më kthejnë shpinën. Fati i burrit është si uji i lumit: ndonjëherë edhe haprron e bën dëme, por pastaj hyn prapë në shtrat dhe bëhet ai që ka qenë, lumë. Vetëm në fshatin tonë njeriu ndihet i burgosur edhe pasi e kanë liruar nga burgu.

— Çfarë ke, mor bir?! — e mbajti e ëma.

— S'kam gjë, — tha ai, — po nuk duroj askënd të më vërë këmbën.

Plakës iu mbushën sytë me lot. Erdhi te minderi me duart e zgjatura. Mendova se do të përqafonte të birin, po u ndal te Kondoja. Ne për dasmën e Kondos kishim vajtur. Ajo tha:

— Që kur ikët nga fshati e vajtët në qytet, na u bëtë si mysafirë. Edhe për Lolën më ka marrë malli. S'ke ç'thua, Baltazar, Lola e ka bërë këtë djalë me yll në ballë!

Në fshatin tonë vinte hera që të gjithë djemtë e të gjitha vajzat i arrinin yjet. I arrinin pikërisht në ditën e dasmës, kur njerëzia sikur e korigjonte syrin për bukurinë dhe askush s'ia kursente dhëndrit apo nuses fjalët e mira.

Me ato fjalë të mira, zbritëm shkallët që binin pa asnjë bërryl nga kati i dytë në të parin. Kristoja na përcolli deri para portës, në rrugë.

Në

— Një për shtëpi, — i thashë, — të dielën mbrëma.

— Kubati ka për të ardhur, — tha ai, — është më i madhi.

Më zgjati strukën me bukën dhe u vonua duke më dhënë dorën. Në xhade po kalonin Çonda e Kovaç Kovaçi.

— Mrëmë jam gdhirë te Zhavellot, — thashë, — dhe dikush që kaloi pranë rrugës më hodhi një fjalë që nuk më pëlqeu.

— Mbrëmë edhe unë kam kaluar andej, — tha ai. — Kam vajtur në varreza, aty nga njëmbëdhjeta e natës.

— Ka qenë më shpejt kur më folën. Po ti ç'doje natën në varreza? — pyeta i habitur.

Ai u çapit një grimë dhe u kthye me fytyrë nga dritarja e katit të dytë. Atje kishte dalë plakka.

— Nënë, — i thirri, — dëgjon çfarë thotë Baltazari? Më pyet se ç'paskam dashur natën në varreza. Ai ka harruar se im atë natën vdiq dhe e pësoi nga kafshimet e qenve. Po vinte i pirë nga kunati i Borjes dhe, në të hyrë të fshatit, iu vërsulën qentë. Babai kujtonte se, po të shtrihesh, qentë vetëm të marrin erë dhe ikin. Mëkat që, gjithë ai burrë, s'e ka ditur të vërtetën: jo vetëm qentë, por edhe njerëzit fërtele të bëjnë, po ta ulësh kokën para tyre. Apo jo, Kovaç? — qeshi me tjetrin në rrugë. — Dje im atë mbushi katër vjet të vdekjes, — më tha mua. — Shoqërova nënën në varreza, se nuk po i flihej: kishte harruar t'i ndizte të vdekurit kandilën të varri.

E arrita Kondon, që ishte shkëputur e më priste më tutje.

— Po mua ç'm'u desh që e pyeta! — thashë.
— Kovacit ia hodhi atë thumbin e qenve?

— Çondës, — tha Kondoja. — I ra pragut të dëgjonte dera, por ajo derë sikur është mbyllur për Kriston. Çonda gjithnjë e bën një vesh të shurdhër ndaj tij. Jo se nuk shkojnë fare, po i rrinë me hundë njëri-tjetrit, sepse ka diçka mes tyre që nuk shkon.

— Po në luftë kanë qenë bashkë, në një batalion.

— Pse kanë qenë bashkë, edhe ndihen larg, — tha ai. — Janë ftohur. Ku ta dish tamam se ç'kanë! — Kondoja shpejtoi hapin. — Siç e kemi nisur, do të na zërë dreka pa mbaruar punë.

Nuk hymë më brenda asgjekundi tjetër. Po prapë punën e sosëm vonë.

Dreka na zuri në Lagjen e Epërme dhe hëngrëm në shtëpinë e Gurbës. Kondoja kishte marrë mbesën e Çondës dhe, meqë Çonda ishte mik i të zotit të shtëpisë, njerëzit e tij therën një gjel për ne. Na shtruan në çardak dhe vetë u morën me punë në oborr. Kishin aty një lëmë të vogël dhe po shinin grurë me kalin që vinte rrotull. Ishte gruri i parë në fshat. Nga çardaku dukej ara e Gurbës në brinjë të malit. Të gjithë sa e shihnin, me grurë ose pa grurë, thoshin se ajo arë ndriste si tepsi e kallajisur, sepse gjithë ditën i binte dielli.

Mua m'u duk se dielli kishte filluar të prishej dhe Kondoja më dha të drejtë, tha se moti kishte kith. E pikasi kur po ecnim monopatin. Shtrati i përroit poshtë shkante përmes sukave me

dhera të shembura. Brigjet sipër zallit ishin mbjellë me snelgje dhe, gjinkallat torolisnin andej prej mëngjesit e deri pas perëndimit të diellit.

— Si nuk pëlcasin, — i thashë Kondos.

— Inati i madh, — tha ai, — e bën njeriun të pëlcasë. A nuk t'u duk se la një shteg sikur do të vinte në dasmë?

Kushedi ku e kishte mendjen.

— Flas për gjinkallat, — thashë.

— Gjinkallat?! — qeshi. — Lëri gjinkallat. atyre u pëlcasin daullet e zërit që i kanë në bark. Po Kristo Kubati ç'ka në bark, daullen e djallit? Çondës nuk ia fshin nga defteri.

— Çfarë nuk i fshin? — pyeta.

— Inatin e madh, — tha. — Nuk ia fal se, sipas tij, Çonda e paditi atëherë kur ra në burg. Dhe e paditi duke menduar se në birucë do të nxirrte edhe ca të kallme të tjera.

— Ç'të kallme, Kondo? — u rrëqetha.

Ka qenë një kohë kur në fshat pëshpëritej, por askush s'e dinte përse ishte fjala. Dhe unë, domos, nuk e dija.

— As sot askush nuk e di, — tha Kondoja. — Çondën s'e kam dëgjuar kurrë të hapë gojën. Po ka të tjerë që e kanë dëgjuar Gurbën e Norës. Në një darkë tek opingari Gurba paskësh thënë: Në kanë ndonjë të kallme midis tyre, e dinë vetëm ata të dy dhe zoti. Po të kallmet, kishte vazhduar Gurba, nganjëherë është mirë t'i lësh të fllenë si të kallurit. Hë, nuk t'u duk se la një shteg për në dasmë?

— Po kush pra, Çonda?

— Jo, Çonda s'ka për të ardhur, mbaje mend

prej meje. Kristoja, që të kërkoi për shoqërues të ardhshëm.

Të dielën mbrëma doli ndryshe: Çonda erdhi në dasmë.

Po binte zhegu dhe sheshi i fshatit ishte plot me njerëz. Kovaç Kovaçi kishte dalë në ballkonin e zyrave të këshillit dhe mbante fjalim. Dy çuna, prapa tij, kishin shpalosur një pllakat të lidhur me kallama të trashë. Pankartën ata e mbanin lart dhe, mbi kokën e kryetarit të këshillit, lexohej: KËRKOHEN VULLNETARË PËR NË CENTRALIN HIDROELEKTRIK «LENIN». Boja ishte po ajo me të cilën ishte shkruar parulla e lëmit të parë. Kur mbaroi mitingu, parullën e lëmit e gjeta gjithandej të shkruar në mure. Pashë se, atë ditë, bojë kishte pasur me shumicë, përdërisa edhe opingari s'i kishte lënë gjë mangut. Po e kishte tepruar, malukati, dhe sesi të dukej! Në gjithë vijën e murit, sipër dritares e deri në fund të derës së dyqanit, ishte shkruar me ca shkronja të gjera e shumë të forta: O P I N G A. Më vonë kam gjetur diçka për epërsinë e rrojtove në një libër që fillonte me berberët. Dhe ashtu dukej, sikur që nga ajo ditë e mbrapa në fshatin tonë njerëzit s'kishin punë tjetër veçse të lindnin, të mbathnin opinga dhe pastaj të vdisnin të kënaqur, duke salutuar me kokë njerëzinë.

— Hajde Muço, hajde! Jepi! — i thirri opingarit togeri.

Kishte filluar shëtitja e pasdites, që te ne bëhet si në qytet. Po vetëm djemtë bënin varavin-

go në xhadenë kryesore dhe, herë-herë, edhe në rrugica. Vajzat rrinin me grupe në pikëtakimet e tyre. Kur qeshnin duke vrapuar për të kaluar në një pikëtakimi tjetër, dukeshin si një tufë patash që gagarisnin dhe dikush do t'i qëllonte në flur. Ç'është e vërteta, djemtë e rinj u hidhnin romuze dhe për saçma të tilla në Bardhgolemin tonë nuk paguante kush.

— Jot motër, — më bëri me dije Kondoja duke më prekur me bërryl.

Meropi kishte një trëndafil në dorë. Ajo u shkëput nga vajzat e erdhi drejt nesh. Pastaj iu var dhëndrit në qafë dhe e puthi në faqe. Ishte shtatëmbëdhjetë vjeçe vajzë dhe skuqej shpejt.

— Ta kam falur, — i zgjati trëndafilin. — Po ju asnjë nuk kishit këputur në kopsht: njëmbëdhjetë kanë çelur dhe njëmbëdhjetë gjeta. Për Anën kam të tjera, — i tha dhëndrit prapë.

— Kush është *i shikuari* i saj? — më pyeti Kondoja udhës.

— Një zullap, — thashë, — një djalë i Kishajve. Unë nuk i flas me gojë.

— Natyrisht, — tha ai, — njeriu bie në zor me të *shikuarin* e motrës. Po ti s'e thua për së vërteti që ai është një zullap. Spiro, — i thirri Kondoja, — këtë trëndafil e ke nga Meropi.

Gjatë ditës, për t'u afruar me njëri-tjetrin, në vend të shkallëve të *shikuarit* duhej të përdorin të tretët. Vajza nuk mund t'ia jepte djalit lulen vetë, po nëpërmjet një të treti.

Djali po vinte dhe Kondoja ia hodhi trëndafilin që ra në tokë. Tjetri u step, sepse e shke-li padashur.

— Zullapi, — thashë, — është fort i ri, ende s'ka vajtur ushtar.

— Kthehemi, — tha Kondoja. — Sesi është kështu, Baltazar: nuk të duket, nganjëherë, se gjithë jetën njeriu ecën si mbi një varrezë?

— Pse mbi varrezë?

— Nuk vdesin vetëm njerëzit, — tha Kondoja. — E shkuara vetë është një varrezë e madhe. Dhe në këtë varrezë i gjalli gjithnjë ecën me merakun se mos shkel diçka që përbën një mëkat. Ah dhe doktori, ç'i tha mendja ta bëjmë dasmën në fshat?! Më ka futur xixat edhe mua. Ndoshta është tepër shpejt, po njeriu gjithnjë e ka të vështirë të ndahet nga e shkuara, Baltazar, ashtu siç është e vështirë të ndahesh nga të vdekurit. Kush po qëllon?

Te sheshi po qëllonte togeri me patllake. Priti qeshte. Po qëllonin dhe burra të tjerë që kishin armë. Kovaçi kishte përvjelë mëngët e gjata të këmishës, sikur do të bënte ndonjë punë fizike, dhe hiqte valle me të tjerë. Opingari, si qejfli i marrë, e kishte lënë bizën dhe i binte curles. Pankartën e kishin kthyer së prapthi dhe e kishin lidhur në parmakët e ballkonit. Në atë anë ishte shkruar: U REGJISTRUAN 23 VULLNETARË PËR NË CENTRALIN HIDROELEKTRIK. A thua të gjithë, para se të venin në kantier, do të blinin opinga të reja?!

— Ta zuri kund syri Timon? — pyeta Kondon.

— Nuk e pashë, — tha ai, — po nuk po shoh as Xhemë Kurtin. Mora vesh se ka rënë në gjurmë të këmishës së hekurt. Dhuratë më të çmuar për dasmë nuk mund të më bënte.

Çondës i dhimbte dhëmballa, po edhe mua në dhëmb më vajti gjuha. Ç'mendonte Kondoja: kishte armë me vete gjenerali? Zakonisht, nuk mbar armë me vete, tha Kondoja. Por edhe duke i mbajtur në shtëpi, nuk pranon të ndahet prej tyre. I kujtova se Çonda mbante dhe «Beretën» e dëshmorit të parë të qarkut tonë. S'ia ke kërkuar për muzeun?, e pyeta. Ia kam kërkuar që ç'ke me të, tha Kondoja, po s'ma ka dhënë. Me atentatorin dëshmor kanë qenë miq të ngushtë, në një njësit, dhe nga Çonda e kam atë fjalën se njeriu e ka të vështirë të ndahet nga të vdekurit. Po për dasmën time një dhuratë si ajo do të ishte e paharrueshme.

Të dy dhuratat nuk do t'i mungonin të dielën mbrëma.

— Eja të shkojmë, — më tha papritur, — në shtëpi do të jemi më të qetë, Baltazar.

Pranë nesh dikush po këndonte këngën e të Paemrit, po të gjithë e dinin se ajo këngë e vjetër këndohej për Vogël Hetën, sado që nuk përmendej emri i tij. Po as emri i lëneshës, nuses që kishte shkuar te burri me bark të zënë, nuk përmendej. Kënga vetëm thoshte se lënësja u kthye në shtëpi të prindërve dhe atje, pas disa muajsh, lindi dy binjakë. Natyrisht, nuk ishte për t'u besuar, po në këngë lehona i thoshte së ëmës:

*Digji dy mandila, digji dy mandila,
ah, sa të bukur, moj nënë, qenkan këta kopila!*

Atë kohë, në fshatrat rreth e qark *kopil* nuk do të thoshte dobiç, por *djalë* dhe *kopile* do të thoshte *vajzë*. Kjo dihet me siguri, siç dihet se shtëpia e lëneshës u detyrua t'i kthente Vogël Hetës dy të tretat e shpenzimeve të pajës, ndërsa kopilat mbetën në sisë të lopës, sepse lehona mbyti veten në Puset e të Pajjesit.

— Eja pra, ç'e zgjat?! — tha Kondoja.

— Më vjen keq që Timon nuk e gjeta, — thashë. — Nesër nisen edhe vullnetarët. Ka mundësi që në dasmë të mungojnë ca njerëz.

— E di, e di, — ma preu shkurt ai. — Po eja të shkojmë dhe ma jep *strukën* mua. Të mbeti gjithë ditën në dorë.

— Nuk mundem, — thashë, — nuk është zakon që bukën e ëmbël ta mbajë dhëndri.

— Ç'të pyesim më për zakon! — u zymtua ai dhe ma hoqi mbështjellësen nga dora.

M'u bë se e kishte shpirtin të trishtuar dhe plot kundërshti që nuk i zotëronte dot. Megjithëse fliste me mua, më dukej sikur ndihej vetëm dhe veç sa mendonte me zë.

— Nuk deshe të ma jepje, — tha kur po ngjithnim të përpjetën. — Edhe ty, padashur, të mbajti merakun se mos duke kaluar nëpër varrezë shkel diçka që na e kanë lënë të vdekurit dhe që përbën mëkat. Baltazar, si është kështu ky brumi i njeriut?!

Pasi heshti pak, filloi përsëri të mendonte me zë. Do të të tregoj një hollësi, tha, se m'u kujtua nga ai zullapi yt. Çilin, vëllanë e madh të Spiros, e kam pasur në shkollën fillore. Dhe kemi qenë në klasën e parë, ende pa mësuar gji-

thë shkronjat e alfabetit, kur e pyeta njëherë se si shkruhej germa R. Çili i urtë e kishte mësuar më përpara dhe më tregoi. Ç'e do?, më pyeti. Më duhet, i thashë. Dhe e di pse më duhej? Kisha vendosur, qysh atëherë, t'i bëja një letër së zgjedhurës sime, që besoja se më vonë do të bëhej e shikuara ime. Rina ishte një vit më e madhe nga unë, në klasën e dytë. Do të ma tregonte Çili shkronjën R, po ta dinte se më duhej për motrën e tij? Mundet që do të qeshte dhe do të ma tregonte. Fshati ynë kështu ka qenë gjithmonë, edhe Dardhaliu, edhe Borja, edhe dy-tre fshatra rreth e qark: pa Kanunin e Lekës, po me kanunin tonë. Varreza jonë është e përbashkët, sepse është e përbashkët e shkuara jonë. Dhe a nuk të duket shumë e çuditshme që ne jemi rritur aq të lirë dhe aq të lidhur?! Është njëlloj si të thuash: gjysmë të gjallë e gjysmë të vdekur. Ne jemi lënë të lirë të zgjedhim, të shohim, po deri në natën e parë të martesës na është ndaluar gjithmonë të prekim. Kush ka guxuar, ka qenë i nëmur dhe për ata që dyshohej, janë kurdisur edhe kurthe në natën e parë... Hë, Baltazar?!

S'iu durua dhe, s'di pse, futi dorën në *strukë*. U përpoqa ta mbaja, po kur ia hoqa dorën, buka ishte thyer. Në gishtërinj kishte miellin e koreve. Doja t'i thosha që tani t'i ndalonte fjalët e të mos na trishtonte më, pasi kishte mbaruar punë: i kishte futur duart vetë në brumin e njeriut. Dhe ky brumi i fshatit tonë i atillë ishte, me kripë e me sheqer. Por Kondos i shpëtoi nga goja:

— I mjeri unë sikur të mos e gjej Anën të virgjër!

M'u duk sikur më ra qielli në kokë. Kishte

qenë një pandehmë e kotë, sepse atë çast po pë-
rëndonte dielli.

Në oborr, doktori u kënaq me të birin.

— Të gjitha sa të kam thënë, i paske mbajtur
mend, Kondo. Zakoni kështu e do, në kthim bukën
e mban dhëndri.

U pamë me Kondon sy më sy dhe vështrimi
im, ndoshta, shprehte njëfarë mosbesimi ndaj tij.
Prandaj ma kishte marrë rrugës strukën?!

— E kur më paske thënë? — pyeti të atin
ai.

— Mbrëmë, — shpjegoi doktori.

— Qysh mbrëmë kanë kaluar njëzet e katër
orë, — tha Kondoja, — edhe bota ka ardhur një
herë rrotull. Ti kujton se kjo mendja ime nuk vjen
aspak rrotull?!

— Kjo do të thotë se qypin s'e ke bosh, mor
bir, — qeshi doktori. — Eh, Baltazar, — më shkoi
krahun mua, duke më ndarë nga Kondoja, që hy-
ri brenda, — sot ka pasur kith dhe ka rrezik të
na priset moti. I ke vërejtur dallëndyshet?

Nuk doja, nuk doja të më fliste për dallën-
dyshtet. Na kishte ngopur mjaft ata muajt e parë,
kur ishte kthyer nga mërgimi. Ai nuk thoshte si
të gjithë: «Do të bjerë shi, se dallëndyshet flu-
turojnë poshtë», po: «Do të bjerë shi, se kandrat
po fluturojnë poshtë.» Dhe kur e pyesnin: «Ku i
sheh ti kandrat?», ai përgjigjej: «I shohin dallën-
dyshtet.» Pas kësaj, mbante llogo meteorologjike
duke shpjeguar se kandrat nuk fluturonin posh-
të për ndonjë trill të mistershëm, po pikërisht nga
lagështira e ajrit që atyre u rëndonte krahët.

Për fat, na hyri në mes Lola. Ajo më pyeti ku kishim ngrënë drekë dhe pse ishim vonuar. Lola po pastronte me kunatën gypat prej qelqi dhe po mbushte kandilet me vajguri. Sigurisht, ishin për ne dhe për njerëzit që do të vinin vizitë pas buke. M'u kujtua Kristo Kubati, që kish-te vajtur natën në varreza për t'i shtënë vaj kandiles së të vdekurit.

— Baltazar, — nuk më lëshoi Zhavelloja, — kështu si e ka zënë im bir, një ditë ka për ta pësuar si Buda.

S'kisha dijëni nga budizmi dhe nuk m'u duk se mund të kapesha në bisedë.

— Ti sikur nuk je këtu, — tha ai, — po unë e di ku e ke mendjen. Te kandilet? — pyeti.

— Po, — thashë pakëz i habitur.

— E kuptova që po i numëroje. Sa të dolën, shtatë apo tetë?

— Nuk i numërova, — thashë.

— Ah, të kishte tetë yje edhe Arusha e Madhe! — filloi një ekskursion të vogël astronomik Zhavelloja. — Atëherë po, do të ishte njëfarë simboli.

— Për ç'punë? — pyeta jo pa habi.

— Bota sot ka vetëm tetë vende socialiste, Baltazar, — tha doktori me gojën plot. — Po nesër Arushën e Madhe mund ta shohim me pesëdhjetë apo me shtatëdhjetë e kusur yje. Edhe në qiell, si këtu, rrotà vërtitet.

— Po pse the për Kondon se mund ta pësojë si Buda? — e zbrita në tokë.

— Për punë të rrotës, pra, — më ndenji gati ai. — Ka gjithfarë rrotash që vërtiten, siç ka dhe Rrotë të Sansarës. Sipas besimit indian, nje-

riu vdes, po shpirti i tij përsëritet te një tjetër, që nuk mban mend asgjë nga e kaluara e tij. Pastaj vdes prapë dhe prapë diku del, e kështu pa fund. Po, nëse një ditë arrin ta kuptojë se është përsëritur, mundësia për t'u ringjallur nuk ekziston më: ai bëhet Budë dhe kalon në botën tjetër, duke i shpëtuar Rrotës së Sansarës. Këtë rrotë, e duan apo nuk e duan, indianët le ta mbajnë për vete. Ndërsa mua më pëlqen të mbajmë rrotën tonë, atë të Zhavellove. Ah, Baltazar, — psherëtiu përsëri, — unë e di ç'kam hequr për t'ia mbushur mendjen Kondos që dasmën ta bëjmë në fshat!

— S'po të kuptoj, — thashë.

— E nga të më kuptosh, — s'u mbajt doktori, — edhe ti gjysmë Bude je!

Bëmë një prapakthehu dhe vazhduam shëtitjen në oborr, pa ma hequr krahun. Prita ku do të dilte dhe doktori që, me sa duket, prandaj më kishte mbajtur, nuk vonoi. Po e kishte të vështirë të shpjegohej dhe bënte ndalesa.

— I rashë botës në të katër anët, Baltazar, po në fund të fundit Zhavello mbeta.

— Kondoja, — thashë. — ç'hyn Kondoja këtu?

— Kur e mori vesh se dasma do të bëhej në fshat, më kundërshtoi e më batërdisi me fjalë. Ai e dinte se, duke u bërë dasma këtu, do t'u nënshtrohej të gjitha zakoneve! Ne këtu kemi gjithë gjindjen tonë dhe rrotën tonë. Në varrezat e këtij fshati ka shumë më tepër Zhavello nga Zhavelot që janë gjallë. Mirëpo Kondoja e ka kuptuar që është një Zhavello dhe nuk dëshiron të jetë. Ai

s'e pranon përsëritjen, kërkon të jetë një tjetër.
— Baltazar! — më thirrën nga tremja.

Doktori nxitoi të më afronte nga vetja dhe mërmëriti:

— Unë s'mund ta ndal të jetë një tjetër, po ia ndaloj të shkëputet nga rrota jonë. Një Zha-vello, për shembull, s'ka pranuar kurrë të marrë për nuse një vajzë të prishur.

— Baltazar! — më thirri Kondoja përsëri. Kishte dalë në treme me sqeparin dhe kutinë e gozhdëve.

U shkëputa nga doktori, por më ndoqi zëri i tij:

— Dëgjo, Pehlivan, mos bëj pehlivanllëqe me fjalët e mia. Këto që t'i thashë në fund, ishin vetëm një shaka.

— Eja, — më tha Kondoja mua. — Baba, — i foli doktorit, — baxhën e tavanit po e gozhdjmë.

Doktori u çapit me duart në xhepa. U ndal, i fryu pantallonat duke hapur duart anash dhe tha:

— Sikur e lamë për të shtunën dhe e shtunë është nesër.

— Sonte më mirë, — tha Kondoja.

— Si të duash, mor bir, për mua akoma s'i ke vënë gozhdë dymbëdhjetëshe!

Kondoja e kishte bërë shkallën gati dhe u ngjit vetë me sqepar.

— Nuk dua ta rëndoju babanë, — më tha pas-taj, — po kështu është më mirë: ai nuk ka më kohë për ngasje, as mua s'më rri mendja ngrehur. Tani do të jemi të qetë të dy.

Sidomos doktori mund të ishte vërtet i qetë,

sepse, siç doli më vonë, ai e kishte futur përgjuesin në tavan që paradite.

Në darkë Kondoja kërkoi raki, po gruaja e togerit na solli verë dhe tha se ajo shishe ishte, të paktën, pesë vjeçe. E mora në arkën e togerit, tha Katerina, atje ka vetëm bomba dhe ca shishe. Sapunin me erë e keni në oborr, mbi kapakun e musllukut.

Po kur dolëm në oborr për të larë duart pas të ngrënit, musllukun nuk e gjetëm në vend. Ishte kthyer togeri dhe po i jepte kokës një shkumë në plevicë. Ne mbaruam punë në sqollin e kuzhinës. Kafe nuk desha dhe, derisa e piu Kondoja, shfletova gazetën e ditës. Pastaj erdhi doktori për të na marrë. Në odën e ndenjjes kishin ardhur burra për vizitë. Kur pa që po lexoja, i ra gazetës me pëllëmbë në faqe të dytë dhe faqes së parë i ra me trinën e dorës, se ashtu i vinte më mbarë.

— Im vëlla është hero, — tha, — ja me kë i duhet të luftojë!

Në faqen e parë të «Zërit të popullit» lexohej që në tituj: «Fashistët e Beogradit vazhdojnë provokacionet e tyre kundër Republikës Popullore të Shqipërisë» (flitej për aeroplanë jugosllavë që kishin shkelur hapësirën ajrore) si dhe: «Fashistët e Beogradit futin diversantë në tokën tonë.» Në faqen e dytë: «Qeveria monarkofashiste e Athinës vazhdon të organizojë dhe të kryejë provokacione kundër RP të Shqipërisë» dhe «Ministria e Punëve të Jashtme e RP të Shqipërisë proteston për shkeljen e integritetit të kufijve të Republikës sonë nga ana e aeroplanëve italianë.»

— Kushedi ç'thotë bota diplomatike për ne, — tha doktori. — Mundet që hallin tonë na e marrin për profanizëm: brenda një dite bëjmë luftë diplomatike me tri shtete fqinje njëherësh. Kurse me luftën e diversantëve merret im vëlla me shokët e tij.

Togeri po vonohej në plevicë. Ndoshta ishte i kënaqur që asaj lirishtës së flokëve të shkukur, të cilën ia kishte bërë diversanti dërdëng, ia kishte gjetur ilaçin me banjë. Im vëlla është një Zhavello i vërtetë, tha doktori kur erdhi të na thërriste për së dyti, sepse Zhavelot s'kanë pranuar kurrë tjetër mbi kokë përveç kësulës së tyre. Ai zuri me gishtërinj strehën rrethore të borsalinës së tij dhe m'u duk sikur do të shtonte: «Dhe tani mos e qelbni, zotëria juaj, ngrihuni, se matanë na presin burrat. Kjo dasmë s'është më pak se një betejë.»

— Unë do të rri një copë herë me Baltazarin, — i tha Kondoja, kur i ati nxori për së treti kokën te dera e kuzhinës.

Më tërhoqi në *qyler*, si të donte të më zbulonte diçka të veçantë. Por atje nuk tha ndonjë gjë të veçantë dhe unë nuk e dija në kishte vërtet për të thënë diçka të tillë. Me atë bisedën për Kondon, doktori më kishte lëshuar një grusht grezëza. Natyrisht, jo çdo gumëzhimë e tyre ishte një pickim. Por ndonjë thimth që më kishte mbetur më fuste në ca dyshime, për të cilat s'dihej në kisha të drejtë të kërkoja ndonjë sqarim. Çfarë kishte ndodhur më parë dhe që unë nuk e dija, mes Kondos e doktorit, Anës e Kondos, Kondos dhe Çondës, Çondës dhe doktorit? Atë mendimin se të gjallët ndahen me vështirësi nga ata që fle-

në nën tokë Kondoja e kishte nga Çonda. Po të kujt ishin fjalët se e shkuara është si një varrezë, ku njerëzit tërë jetën ecin në majë të gishtërinjve nga frika se mos shkelin diçka që përbën mëkat? Në ia kishte thënë doktori, atëherë përse njëri kërkonte të shkelte qoftë dhe këmbëzbathur e duke i hyrë gjemba, ndërsa tjetri frikësohej se ç'mund të sillte mëkati dhe, për të fshehur kërcitjen e për të siguruar rrotullimin e njohur, i hidhte vaj Rrotës së Zhavellove?!

— Kot që nuk e pimë verën, — tha Kondoja.

— E pimë, — thashë.

Vajti përsëri në kuzhinë e solli shishen me dy gota. Dera e *qylerit* ishte e kuqerremtë, perdet të kuqerremta, vera e kuqe. Dalëngadalë, u skuq në fytyrë edhe Kondoja.

— Ç'bëhemi të marrë, — tha. — Njeriu një herë martohet, ndërsa unë e ti po merremi me gjithfarë kleçkash që nuk na lënë të gëzojmë.

S'm'u duk se tha atë që donte të më thoshte. Por edhe ky dyshim më rëndoi; isha shoqërues i tij dhe nuk më shkonte t'i hidhja hije gëzimit të dhëndrit, sidomos në dhomën e tij.

— Jam skuqur në fytyrë? — e pyeta.

— Posi, — tha ai. — Interesant, mua vera nuk më jep ndonjë efekt tonik.

S'e shihte veten. Tha se do t'i kërkonte xhaxheshës edhe një shishe tjetër. I foli nga dera e *qylerit* dhe Katerina e solli.

— Në arkën e togerit ka prapë, — tha ajo. — Atje vetëm bomba dhe shishe ka.

— Po të ishin shishe benzine, edhe këto do të quheshin bomba, — qeshi Kondoja. — I thuaj

Anna

xhaxhait të vijë të pimë bashkë. Po të mos e shohë njeri, se nuk lejohet hyrja këtu.

— Togerit ka kartabjanka, — tha xhaxhesha, — atij i lejohet të hyjë kudo.

— Mos u mërzit, — më tha Kondoja mua. — Babai mbetet baba dhe xhaxhai xhaxha, po togerin e dua veçmas. Ndoshta se babai iku shpejt në mërgim dhe xhaxhai më ka rritur.

Togerit i kishte ende flokët të lagur. Na tregoi vijën që i kishte lënë helika e ventilatorit në gisht. Ai nuk është ventilator, tha, po sharrë disk. Po mundohesha ta vërtisja me gisht dhe mendoja sikur të kishte një aparat që, në vend të bënte fresk, të lëshonte nxehtësi për t'i tharë flokët shpejt. Kur nuk e ke elektrikun në shtëpi, Kondo, bëju mutin të gjitha hallateve me spinë.

— Ulu, — thashë, — vera çenka e mirë.

— Se mos është kabuni, — ia bëri togerit. — Baltazar, meqë Shushullës, krushkës sonë, i dhashë gjelin e egër, ty që je shoqëruar i dhëndrit po të jap një palë krahë të tjerë. Ti tërë jetën mund të mbeteshe fatkeq, qyqar, vetëm pse nuk e lexon gazetën ditën e martë, — më kujtoi. — Mos më shih mua, se ne bëjmë informacion politik çdo ditë dhe na e thonë të tjerët se ç'shkruan gazeta.

— Në ka të bëjë vërtet me futbollin, do të më gëzosh, — nuhata diçka.

— Në fshat të gjithëve ua njoh dobësitë, — tha togerit. — Dhe sa kam vërejtur unë, dobësia më e madhe e njerëzve është që, para se të vdesin, duan të gëzojnë. Le të gëzojnë, mor Baltazar! Edhe ty, pas dasmës, s'të mbetet tjetër veçse të mbathësh opingat dhe drejt e në kur-

in e trajnerëve në qytet: atje është jeta dhe vdekja jote. Po Muçoja, teveqeli, — u ndal një çast, — ç'ma kishte mbushur murin me ato shkronja të hatashme për opingat! — I kishte bërë përshtypje edhe atij.

~~Shpreh~~ «OPINGAT» e Muços mua më dukeshin tani vetëm një vepër e mirë. Kur kanë përse të gëzojnë, ndoshta njerëzit nuk i pengon ta shijojnë gëzimin epërsia boshe e opingarëve dhe berberëve. I kërkova togerit menjëherë hollësi plotësuese. Kursi do të hapej në kryeqytet, me një konkurs të thjeshtë dhe do të drejtohej nga trajneri sovjetik, mjeshtri i merituar i futbollit, Apuhitin Boris.

— S'të ka kush, toger! — i thashë. — Sikur të betoheshe se kjo nuk është një shaka?

— Të betohem?! — u habit ai. — Jepi, Baltazar, jepi! — më përvëloi me prushin që isha mësuar t'ia hidhte tjetërkujt. Pastaj zëri i tij u bë disi nostalgjik. — Mos më detyro të betohem, të lutem!

Natyrisht as që e kisha pasur ndër mend ta detyroja dhe isha i gatshëm t'i kërkoja të falur në e kisha tepruar pa dashje. Ia lashë ta nënkuptonte këtë edhe Kondos, i cili duhej t'ia njihte mirë huqet xhaxhait. Por edhe ai, si unë, u tregua hutaq para huqeve të togerit. Ndoshta s'e kishte njohur deri në fund.

— E mirë, Baltazar, — e kapi gjendjen togeri, — meqë është fjala për prikën tënde të jetës, nuk është mirë t'i var turinjtë. Njerëz jemi, djalli e mori, dhe unë s'ka pse të sillem ndaj teje si Vëllai i Shiut!

Vuri dorën në xhepin e bluzës, shkopsiti pu-

llën dhe kur po prisja të më rrate në dorë ndonjë copë të prerë nga gazetat, nxori atë kutinë me cullufen e flokëve. Si e vuri në njëren shuplakë, e mbuloi me tjetrën e tha:

— U bëfsh një Boris Apuhtin, Baltazar, mjeshtër sporti! Ndërsa mua më vraftë kujtimi i asaj, në gënjej!

Tani po kuptoja se edhe ato shprehjet që më kishin prekur e që ishin disi të reja në fshatin tonë — «për prikën tënde të jetës», «të sillem ndaj teje si Vëllai i Shiut»; — ndoshta m'i kishte falur pikërisht bujaria e «kujtimit të saj». Po cila ishte ajo?

— Të kujtohet Kristina, Kondo? — iu drejtua nipit. — Mos thuaj po, unë këtu nuk e solla ndonjëherë. Ti vetëm në fotografi e ke parë. Ah, Kristina, ç'ishte Kristina!

Togeri u ul në gjunjë për të ndenjtur me ne, po mua m'u duk se u gjunjëzua ashtu siç gjunjëzohen njerëzit kur e çojnë mendjen te zoti.

— Këta flokë të Kristinës janë, — tha ai. — Atë e gjeta nga fundi i jetës. Kishte ndodhur e sëmurë nga oftika, po oftikës ata i thoshin tuberkuloz. Babanë e kishte argjendar dhe ai ia kishte bërë kutinë. Flokët i kishte futur aty Kristina. Donte t'ua linte atyre të shtëpisë. Një marrëzi me brirë! U martuam bashkë e ma dha mua. Një marrëzi me thes! Sidoqoftë, gjithkush ka punën e vet. Ndërsa për të gjithë nuk mjafton që vetëm të japësh, duhet të dish edhe kujt t'i japësh. Po t'ua kishte dhënë njerëzve të shtëpisë, ata do të qanin nganjëherë para kësaj kutie, siç dëshironte Kristina. Unë nuk kam qarë. As këmbët s'm'i lidhi përgjithmonë ai thes, u mar-

tova prapë. Sa rrojti Kristina, Kondo, tre apo katër muaj?... Rrojti aq sa rrojti, mrekulli ishte. Marrëzinë më të madhe e bëri që vdiq. Nuk them pse u martuam, po pse u njohëm. Po të ishte për të vdekur, më mirë të mos e kisha njohur. Më çuan të strehohesha për pak ditë në shtëpinë e tyre. Ajo rrojti vetëm tre-katër muaj, pasi u martuam. Dhe janë të çuditshme disa gra: më ishte mirënjohëse, qenia! Marrëzinë më të madhe bëri që vdiq, ishim fare mrekulli. Po mrekullitë gjithmonë zgjasin pak dhe unë s'pata kohë t'i tregoja mirënjohjen time. Kjo është e para. E dyta është se nuk kam qarë ndonjëherë për të. Qenia, i kishte qejf lotët! Jam Motra e Shiut, më thoshte. Nuk ishte aq e re, po ishte e ditur. Dhe njerëzit e ditur ndoshta dinë edhe pse qajnë. Ah, Kristina, ç'ishte Kristina!

— Ç'paskësh qenë, xhaxha?

— Për mua ka qenë baras me tërë fshatin tonë. — Togeri s'di pse brofi, por u duk sikur po i thoshte Kondos se kujtimi i asaj gruaje meritonte të nderohej në këmbë. Ai filloi të bënte ecejake në dhomën e ngushtë. U afrua te dera dhe atje qëndroi me shpinë, sikur mua dhe Kondon të na shihte tani përmes asaj pasqyrës plot damarë të kuqerremtë që krijonte lustra e bojës.

— Baltazar, i thuaj Kondos të mos më detyrojë të flas!

Pata frikë se po përsëritej po ajo gjëndje lëndimi që i ngjalla kur i kërkova të betohej dhe preka Kondon me dorë. Kurse ai:

— Fol, xhaxha, ne s'jemi fëmijë.

— Një pjesë të mirë të jetës, — tha togერი, — në fshatin tonë njeriu trajtohet si fëmijë. Ti

ndoshta s'ke nevojë, Kondo, po prapëseprapë ke për shoqërues një burrë të martuar. Dhëndri gjithmonë ka pasur burrë të martuar dhe nusja, doemos, grua të martuar. Dhe dihet përse: veç të tjerave, shoqëruesit i mësojnë ata të dy se si të flenë me njëri-tjetrin natën e parë. Për të mësuar kaq gjë, vajzës i duhen njëzet ose njëzet e pesë vjet, djalit njëzet e pesë ose tridhjetë vjet. Tani më mendoni mua kur shkova te Kristina tridhjetë e pesë vjeç. Ajo m'i mësoi të gjitha brenda një nate. Nuk është fjala si flihet me një grua, po se ç'bukuri dhe ç'vlera ka trupi i njeriut. Pak të duket kjo, Baltazar?

— Jo, — thashë, — ta paska hequr fëmijërinë dhe të paska plakur brenda natës.

— Tamam ashtu, — tha togeri, — më dha mend sa për tridhjetë e pesë vjet në fshatin tonë. Ah, Kristina, ç'ka qenë Kristina! — Futi në xhep kutinë me cullufen e flokëve dhe, duke mbërthyer kopsën e xhepit, shtoi: — Kjo është kartabjanka ime, më lejon të futem në botën e grave apo të kthehem te Kristina sa herë dua. Nuk kam qarë ndonjëherë për të dhe ia kam frikën vetes: mbase ajo akoma s'ka vdekur tek unë. E pra, varri i vërtetë i gruas gjendet në shpirtin e burrit... Dola, doktor! — iu përgjigj protestave të forta prapa derës.

Doli pa na përshëndetur, sikur do të kthehej prapë. Por nuk u kthye. Ne heshtëm gjatë se s'na punonte goja.

— Baltazar, dalim matanë?

— Do të doja të shihja nënën, — i thashë Kondos. — Po shkoj dhe nuk vonohem.

Mora rrugën e shkurtër përmes shtratit të

përroit. Në atë vend shtrati hapej shumë dhe aty-këtu kishte ca të ngritura si ishuj aluvionalë. Prej një sopi pashë Kondon në dritare. Ishte gjithnjë në dhomën e tij. Ngjyrat, edhe e kuqerremta e perdes, kishin humbur prej natës. Atij i valavitej perdja prapa kurrizit dhe kjo ia shtonte hijen. Ç'po mendonte? Besova se ia kishte zili atë intimitet togerit. E kishte ditur më parë historinë e dashurisë së xhaxhait? Nuk e kishte ditur. Por ishin të tjera ato që po mendonte Kondoja e që mua m'i mbante në kije. Ose i vinte rëndë të më zbulonte atë pjesë të marrëdhënieve të tij me të tjerët, ose nuk kishte arritur në përfundime të sigurta. Vallë, mos kishte marrë përsipër gjithçka vetë dhe shpresonte se, sido të ndodhte, do të mundte t'i zotëronte rrethanat?

Kishin kaluar disa vjet që kur i kishim varrosur ata që u vranë në dasmë dhe, një ditë, u takuam me Kondon në zallishtë, mu tek ishujt e vegjël aluvionalë.

— Më në fund, u bëre njëfarë trajneri, Baltazar, — më kujtoi. — Tani më thuaj: në fushë mjafton vetëm të vraposh apo duhet që, njëkohësisht, të shohësh edhe lojën?

E ndjeva se po fliste për sensin e hapësirës e të kohës dhe më vajti mendja te Çonda.

— Çonda harronte ose njërën ose tjetrën, — tha Kondoja. — Atë njeri sikur e mundonin eks-tremet.

E kisha më të lehtë të flisja me Kondon, sepse tani i dinim të dy ngjarjet që kishin ndodhur para dasmës. U ngjitëm përroit përpjetë deri te

gryka që vinte duke u ngushtuar dhe që quhej Gryka e të Papjesit. Atje i thashë: Eja vëre në hesap se ç'ka qenë Çonda tamam!

Çonda kishte vajtur në qytet qysh para luftës dhe atje kishte zënë punë në një fabrikë. Nganjëherë kthehej në fshatin e tij, në Dardhali, po vinte për ta takuar në qytet edhe e ëma, Vitoria vinte edhe kur Çonda u bashkua me njësitet guerile, njëlloj donte ta takonte edhe pse ishte ilegal. Ajo hynte kafe më kafe, atje ku ishte mësuar ta gjente të birin duke pirë, pyeste për të dhe trish-tohej që shihte të tjerë në tryezë. Për Çondën tim nuk e ditkeni, u thoshte atyre, kurse për shishen tuaj të gjitha i ditkeni! Dhe, nga inati, u derdhte gotat me pije. Pak nga pak, ajo u bë aq e frikshme nëpër lokale, sa edhe të birin, kush e njihte e kush nuk e njihte, filluan ta quanin Çonda i Vitorisë. Kjo ia shtoi namin Çondës edhe pasi doli në mal partizan. Kur u çlirua qyteti, atë e pritën krahëhapur.

Kohët e para, Çondën e thirrën për ta bërë përgjegjës të stabilimentit të sharrave. E adresuan ku ndodhej dhe e porositën: Se merr me vete ndonjë kafshatë bukë e një shishe ujë, nuk bën keq! Çonda u paraqit në punë që të nesërmen, me bukën e shishen e ujit në torbë, po stabiliment sharrash atje nuk gjeti. Gjeti vetëm ca stiva dërrasash në një vend të shkretë, të rrethuar me tela. Tjetër frymë njeriu nuk kishte në atë farë stabilimenti dhe ai bëri punën e rojtarit. Por, pas tri javësh, i thanë të shkante në burg. Me të vënë këmbën atje, disa nga të burgosurit iu hodhën në

qafë për ta përçafuar. Ata donin të dinin se ç'kishte bërë Çonda i Vitorisë që e kishin rrasur brenda. Nuk jam i burgosur, u tha Çonda, jam drejtor i burgut.

Nga Dardhaliu, Vitoria shkante përsëri për ta takuar. Ajo rronte gjithnjë në fshatin e dardhëve, me fëmijët dhe gruan e të birit. Çondën vetëm Shushulla, motra e martuar në Bardhgolemin tonë, nuk shkante për ta takuar. Vdekja e Kanisë i mbante të ndarë motër e vëlla. Dukej sikur edhe Çonda vetë, pas asaj vdekjeje, ishte ndarë përgjithmonë nga një pjesë e vetvetes. Në mal e kishin nxjerrë para batalionit dhe i kishin thënë se koka e koha duhet të pajtohen me njëra-tjetrën, se në kohë të reja njeriu ndërton marrëdhënie të reja me njerëzit. Pas luftës, ai mendoi se koha e re kishte ardhur dhe u mundua të tregohet sa më i matur me të burgosurit. Nuk vonoi dhe Çondës së Vitorisë iu hap nami prapë.

Njëherë iu paraqit një i burgosur që i kërkoi një natë leje, sepse në shtëpi kishte një të sëmurë. Çfarë e ke të sëmurin?, pyeti drejtori i burgut. E kam nusen e djalit, tha tjetri, është e re dhe sapo ka lindur fëmijën e parë. Kania, mbesa e Çondës, kurrë nuk do të bëhej nuse. Ajo kishte vdekur me barrën në bark dhe Çondës, që e kishte kërcënuar atëherë për ta vvarë, tani i rëndonte shumë. Shko, i tha të burgosurit, po nesër që pa gdhirë të jesh këtu! Dhe të nesërmen, që pa gdhirë, i burgosuri u kthye. Pastaj atij filluan t'i vardiseshin të burgosur të tjerë, secili me ndonjë hall. Çonda, herë pas here, jepte leje dhe për asnjërin nuk harronte urdhrin e rreptë: «Nesër, që pa gdhirë, të jesh këtu!» Ç'është e vër-

teta, ata ktheheshin, megjithëse ndodhte që ndonjëri të vonohej në mëngjes dhe kush e shihte të burgosurin në rrugë, çapërente sytë nga habia. Sidoqoftë, Çonda tashmë ishte i kënaqur dhe, një ditë, në një mbledhje me personelin e burgut sesi iu kujtua ajo përvoja e hidhur në batalion dhe tha me bindje: «Po, koka dhe koha shkojnë bashkë, në kohë të reja njeriu duhet të dijë të sillet ndryshe me njerëzit!»

Atje, në burg, ishte dhe zoti Gjika, një tregtar i njohur që nuk kishte paguar tatimet e luftës. Drejtori e lejonte të pinte çdo ditë nga dy gota «Metaksa». Sekush e këshilloi që tregtarit t'i lejonte të pinte edhe tri apo katër gota, pasi vetëm ashtu mund t'i zgjidhej gjuha e t'i shpëtonte ndonjë fjalë për florinj të fshehur. Çonda e vizitonte të burgosurin ngandonjëherë, «Metaksaja» e tij ia bënte me sy, por ai e përballonte joshjen e konjakut.

Një ditë prej ditësh, zoti Gjika i kërkoi leje. Drejtori s'e mori vesh në kishte ditëlindjen vetë, i biri apo e shoqja. Megjithatë, u kandis dhe i dha leje për një natë, duke mos harruar atë urdhrin e rreptë: «Nesër, që pa gdhirë, të jesh këtu!». Tjetri premtoi se të nesërmen, pa zbardhur drita, do të ndodhej në burg.

Mirëpo të nesërmen në mëngjes, Çonda i hipi «Mileçentos» dhe u nis në kryeqytet për mbledhje. Në mbrëmje u kthye vonë dhe s'i ra në mend për zotin Gjika. Të pasnesërmen u kujtua, por nuk e pa në burg. Nisi me urgjencë një ushtar të armatosur për ta marrë. Pasi kaloi gjithë paraditja dhe ushtari me të burgosurin s'po dukeshin, pa ç'pa, vajti vetë në shtëpinë e zotit Gjika. Aty e

gjete, në tryezë, duke ngrënë e duke pirë. Në një krah kishte të shoqen, Kiton, dhe në krahun tjetër Klean, djalin. Përballë tij ishte ulur ushtari që, gjithashtu, hante e pinte.

— Zoti Gjika! — thirri Çonda.

— Urdhëroni, zoti drejtor! — i foli tjetri, si në burg, dhe menjëherë u ngrit në këmbë.

— Si e kishim lënë për t'u kthyer? Nuk e mbajte fjalën!

— Si urdhëroni, zoti drejtor, e drejta është me ju, unë kam gabuar. — Dhe ai zuri të shpjegonte pse kishte ndenjtur e si ishte mallëngjyer pas së shoqes e të birit. Por e siguroi se sapo kishin dashur të ngriheshin me ushtarin.

U ngrit Kitoja dhe, meqë Çonda nuk pranoi të ulej në tryezë, e qerasi në këmbë me tabaka. Kitoja ishte grua e bukur dhe nuk i kishte për zakon fjalët e tepërta. Ia mbushi gotën përsëri dhe tha se mund ta pinte pa merak, pasi nuk festonin as ditëlindjen e zotit Gjika dhe as të sajën, po ditëlindjen e djalit. Çonda kundërshtoi për gotën e tretë, po ç't'i bënte të burgosurit të tij! Zoti Gjika i tha se, për të qenë të singertë, ata festonin ditëlindjen e Kitos, kurse ajo kishte qenë e detyruar ta fshihte vetëm e vetëm për të mikpritur mysafirin e lartë. Dhe kështu e piu edhe të tretën. Pastaj Kitoja iu lut të ulej në tryezë, sa t'i përgatiste një pako ushqimore të shoqit. Dhe filloi ta përgatiste para syve të tij. Po ndërkaq, drejtori i burgut kishte filluar të pinte dhe Kitoja i thoshte: «Zoti Çonda, nuk do të merrni dhe një biftek?... E provuat merlucin me salcë, zoti Çonda?» S'dihet sa piu aty dhe në e provoi peshkun me salcë. Po kur u ngrit, kishte filluar

të errësohej dhe njerëzia kishin dalë në rrugë për shëtitjen e mbrëmjes. Çondën e vunë në mes ushtari e zoti Gjika: përgjatë bulevardit ata u nisën për në burg.

Eja e vëre në hesap tani se ç'ishte tamam Çonda dhe sa u zhgënjye, kur mori vesh se koha dhe koka e tij përsëri nuk ishin pajtuar me njëra-tjetrën. Jo se e hoqën me bujë, por e kritikuan për liberalizëm dhe e transferuan në vendin e mëparshëm. Atje, në stabiliment, po ngrihej kantieri i sharrave dhe kishin filluar të vinin punëtorët. Po Çonda nuk deshi më, u kthye përgjithmonë në fshatin e tij. Dardhaliu është plot me dardhë dhe, për këtë shkak, edhe sot e kësaj dite besohet se pikërisht andej ka dalë fjala: *dardha e ka bishtin prapa.*

Ja ç'më tregoi Kondoja vetë, kur u ngjitëm përpjetë përroit, deri te Gryka e të Papjesit.

Zhavelot e kishin pasur gjithmonë prapa kurrizit shtëpinë e Shushullës dhe, në erdhi dita që njëri prej tyre i ktheu sytë andej, kjo ndodhi kur u rrit Ana. Nuk u desh shumë që të afroheshim, tha Kondoja. Ana erdhi nga fshati në qytet për të ndjekur kursin e arsimitarëve dhe unë, megjithëse punoja në muze, u jepja kursantëve lëndën e matematikës. Kursi filloi nga mesi i tetorit. Doktor Zhavelloja me të shoqen e kishin mbushur vitin që banonin në qytet. Me sa duket, doktori s'e kishte pasur të vështirë që, duke iu përkushtuar vetë infermierisë ambulatory, të rregullonte edhe të shoqen si sanitare në poliklinikë. Nganjëherë, tha Kondoja, ata më nxitnin që të fejojesh

dhe, kur binte fjala për bukurinë e vajzave, nëna ime përmendte gjithnjë emrin e Kanisë. I kishte sytë me bisht, thoshte për të, dhe ishte e bukur si yll. Çfarë ylli, Lola?, pyeste me kërshtëri doktori, i cili nuk e kishte njohur Kaninë. Yll vjeshte, thoshte Lola. Po edhe Lola nuk kishte shkelur më në shtëpinë e Shushullës nga dita kur ishte varrosur Kania. Atëherë vajza e dytë e Shushullës, Ana, kishte qenë vetëm njëmbëdhjetë vjeçe.

Me rastin e Vitit të Ri, më tregoi Kondoja, e mora Anën vizitë në shtëpinë tonë. Kur pa se prindërit nuk po e njihnin, atij sesi i erdhi dhe u tha se ishte motra e Kanisë. Kjo është Ana, u kujtua Lola, sa qenka rritur! E mbajtën për darkë dhe, vonë, Kondoja e përcolli në konvikt. Pastaj filloi ta merrte në shtëpi dhe herë tjetër, për drekë ose për darkë. Të pëlqen?, e pyeti doktori të birin një ditë. Kondoja nuk foli. Ç'sy me bisht që ka, tha Lola, dhe e bukur është si yll. Çfarë ylli?, pyeti doktori. Yll vjeshte, tha Lola njëlloj. Ti sikur sheh atë tjetrën tek Ana, tha Zhavelloja, se kështu më pate thënë edhe për Kaninë. Dhe, meqë Ana ia kishte këputur kokën së motrës, ata i zuri frika se mos i ngjiste në të gjitha, më tregoi Kondoja. Për herë të parë, ndonëse im atë e kishte dëgjuar në fshat historinë e Kanisë, e vuri nënën time që t'ia rrëfente me gojën e saj. Për ta lehtësuar të birin apo kushedi përse, doktori tha: Po flasim për Kaninë, jo për Anën! Dhe ata vazhduan të flisnin, duke thënë se «Kanisë dikush ia kishte bërë fshehurazi atë punë» dhe se «mëkatarja, duke qenë vajzë, kishte vdekur grua».

Dola i rënduar nga shtëpia dhe bëra varavingo në qytet, më tha Kondoja. Te Dy Trumat shoh

vëllanë e gjeneral Kubatit, Kriston. E futa në tavernë dhe e pyeta në e kishte njohur mirë Kaininë. Ta kisha ditur, kush ia hidhte fjalën! Nga të mos e njihja, tha ai, bashkë kemi qenë në një batalion. Më ka dashur si vëlla dhe ka qenë vërtet e bukur, kështu si Ana sot. Në fshat janë hapur fjalë se Ana të ka rënë në kokë. Kovaçi e pyeti një ditë togerin dhe ky ngriti duart: «Përpara asaj që duan, burrat dorëzohen!», tha togeri. Në të ka rënë në kokë, merre Anën dhe hiç mos vrit trutë. I shikuari i saj tani ndodhet ushtar por, me sa kam dëgjuar, i ka marrë me kohë *nortat*¹⁾ ngjyrë rozë... E pyeta Kristo Kubatin ç'e kishte sjellë në qytet. Hakmarrja, tha. Dikush kërkon të hakmerret me mua dhe po më hedhin në gjyq për ato katër-pesë ditë që u bëra me bashibuzukët nga zori. Le të kruajë brirët ai që do, veçse thika e hakmarrjes gjithmonë ka dy presa. Unë po të jap Anën e fshatit tonë dhe ti më jep rakinë e qytetit tënd, më ngacmoi Kristoja, duke ngritur përpjetë flokët vërdhashë. Ishte mashkull i hijshëm dhe m'u përshkua nëpër mend se në të gjithë fshatin tonë, ndoshta, ai dhe Ana ishin më bukuroshët.

Filluam të largoheshim nga Gryka e të Pajjesit dhe, ndërsa zbrisnim përroit, Kondoja më tha:

— Ana nuk m'u hoq asnjëherë nga zemra, po në kokën time u ngul një gozhdë: Sa herë ishte takuar dhe deri ku kishte arritur ajo *me të shikuarin* e saj? Të duket i çuditshëm qëndrimi im, Baltazar? Të mos të duket i çuditshëm. Unë vetë

1) dialekt — lidhësa për opinga. Nortat ngjyrë rozë ishin shenjë për prishjen e marrëdhënieve.

nuk kam ardhur në qytet aq i pastër sa ç'pati vajtur atëherë xhaxhai im në kryeqytet.

Më pas e kishte pyetur Anën për të shikuarin e saj. Por nuk e dija në kishte mundur ta pyeste për çfarë i dhimbte. Ç'do të thuash me «çfarë më dhimbte?!», më ndërpreu Kondoja. Për të gjitha më dhimbte, bile edhe vetëm pse Ana ishte shikuar me një tjetër para meje. Njeriu i tillë qenka, Baltazar, çdo e mirë që i bie në pjesë atij i duket se i ka takuar t'i bjerë, ndërsa ajo që i bie tjetërkujt i duket e dyshimtë si pjesa e të Papjesit. Ana më tha se i shikuari i saj nuk i kishte pëlqyer Shushullës. Nuk tregoi në i kishte pëlqyer apo jo vetë asaj. Ndoshta Shushulla ishte trembur për fatin e së bijës dhe kishte shpejtuar t'i dërgonte norfat rozë.

Edhe Kondoja filloi të shëtiste rrallë e më rrallë me Anën. Ata që i nxirrte puna në qytet sillnin gjithfarë fjalësh në Bardhgolem. Mbjaj mend se edhe togeri, kur ia hidhte fjalën ndokush, nuk i ngrinte më duart si më parë. «Kartabianka ime nuk pi ujë për të gjitha», qeshte, «Kondoja e di vetë se ç'bën!» Po kur mori vesh se, që nga Dardhaliu, Çonda i çoi fjalë së motrës që «t'ia mblidhte rripat asaj zuskës në qytet», togeri u alarmua: ç'do të bënte Kondoja me Anën?

— E ç'do të bësh me të? — e ndali Kondon një njeri mu te shkallët e muzeut. E kishte pritur aty dhe i foli kur po afrohej.

— Me kë? — pyeti Kondoja.

— Vjet më ke dërguar një shkresë me vulë, — tha tjetri, — për atë revolverin e mikut tim. «Bereta» italiane ka marrë më qafë disa njerëz. Ajo ngecte dhe, nganjëherë, ngecte se tregoheshin ta-

mahqarë: e mbushnin rrasur, me një fishek më tepër me atë që kishte në gojë. Mikut tim i ngeci revolveri dhe e vranë... Ç'do të bësh me të?

— E marr për muzeun, — tha Kondoja.

— Ç'do të bësh me Anën, — tha tjetri, — për Anën kam ardhur.

E mora me mend se ishte *gjeneral* Çonda, më tregoi Kondoja, për të cilin dikur thuhej se *kishte lindur me këmishë*. S'e kisha parë qysh përpara luftës, kur e kishte mirë me Shushullën dhe vinte nganjëherë tek e motra. Ai ka ardhur të të vrasë, më tha im atë në shtëpi. M'u duk e pabesueshme. Nuk kisha ndier kërcënim në zërin e tij, më kishte thënë të mendohesha edhe një herë se ç'do të bëja me Anën dhe se për këtë donte një përgjigje nga unë. Përgjigjen do t'ia jepte të nesërmen, në takimin që lanë te Dy Trumat. Nëna u frikësua shumë. Ka ardhur të të vrasë, tha si babai, Çonda e vrau atëherë edhe Kainin. Më porositi të mos dilja nga shtëpia dhe sidomos të mos i veja të nesërmen në takim. Po babai më tha se do të bëja mirë të martohesha me Anën. Përderisa është e bukur, pse të mos martohesh, Kondo?! Çonda ka të drejtë të shqetësohet: njerëzia të kanë parë me Anën dhe ç'mund të thonë ata për mbesën e tij? Martohu, bir. Ne Zhavello jemi dhe ata, ashtu si ne, në fshat janë rritur: zakonet i kemi njëlloj. Në të daltë ndryshe, atij dardhaliut i tregojmë bishtin e dardhës prapa... Këto fjalët e fundit të babait u bënë gozhda ime e dytë, Baltazar.

Kondoja vajti në takim dhe e gjeti Condën te Trumat. Por Trumat kishin ujë, raki kishte taverna. Hynë në tavernë dhe Kondoja i tha Çondës

se do të marotohej me Anën. Nuk kam frikë prej askujt, Anën e dua. Ta duash, tha Çonda, po edhe frikën ta kesh. Njeriu gjithmonë ka frikë nga njerëzit që do. Atyre që nuk i do, nuk ua ka as frikën. Çonda piu dhe kujtoi Shushullën. Ana i ka mbetur, tha, atë tjetrën ia mora unë atëherë dhe nuk ia ktheva më. Njeriu nuk di t'i ruajë njerëzit që do. Kurse gjithçka që vritet, nxjerr gjak. Tani kemi një gjak tjetër përpara. Piu prapë dhe, duke u kthyer tek unë, sikur u bë krejt esëll.

Baltazar, m'u drejtua Kondoja kur arritëm pranë ishujve aluvionalë, të kujtohet ajo e premtë në shtëpinë e Kovaçit? Kishim vajtur ta ftonim në dasmën time dhe, ndërsa largoheshim nëpër oborr, Çonda më thirri: «Mos harro si e kemi lënë bashkë, dhëndër!» Ti më pyete në rrugë se si e kishim lënë: kishim përpara një gjak tjetër dhe atë gjak Ana ma kishte borxh mua, ajo duhej të dëshmonte natën e parë të martesës se ishte e virgjër. Këtu do të të pres, më tha Çonda, në tavernë. E dua shumë, prandaj kam frikë për Anën. Por, po të doli ndryshe, ti ke të drejtë ta lëshosh si bush-tër... Kjo ishte gozhda e tretë që ngulej në kokën time, Baltazar. Ah, u ankua Kondoja, më duket se im atë s'e ka keq: një Zhavello jam dhe unë. Nuk e sheh që po flas me gjuhën e xhaxhait? Togeri e ka zakon t'i numërojë argumentat me gishta!

U ndamë mes zallishtës. Kondoja mori përpjetë, për në shtëpinë e vjetër të Zhavellove, unë ngjita sopin që të nxirrte në xhade.

Atë rrugë ndoqa edhe mbrëmjen e së premtes, kur e shihja Kondon në dritare. Perden e ki-

shte kaluar prapa kurrizit dhe ajo ia shtonte hijen. Po paskësh pasur edhe hije të tjera që i vërtiteshin përçark dhe që unë atëherë nuk i dija.

Sapo dola në xhade, dëgjova zëra grash që këndonin. Në shtëpinë e Shushullës ishte ngrehur dasma. Deri atë çast në dasmë kisha qenë, po martesat e vajzave janë gjithmonë më përmalluese dhe mua m'u kujtua Meropi. Te ne kishte burra që qanin në dasmat e vajzave, unë isha i sigurt se do të qaja në dasmën e motrës. Pas disa ditësh, kur Ana e martuar do të vinte për herë të parë si mysafire tek e ëma, thuajse të gjitha shtëpitë që kishin vajza të rritura e që ndodheshin rreth e çark shtëpisë së Shushullës, do ta ndienin *shkakun e nuses*. Me këtë shkak, prindërit e djemve të cilët i donin ato vajza, do t'u çonin në shtëpi, përmes një të treti, mëndafshra për qëndisje dhe pogaçe. Pas disa ditësh, në shtëpinë tonë do të vinte pogaça dhe penjërat për Meropin.

Shtyva portën e oborrit dhe i fola qenit që s'po i pushonte gamgamet. Një qen i lidhur është si një shpirt purgatori. Si shpirt purgatori u ndjeva dhe unë, sepse nuk isha në gjendje as të bëja një të mirë, as një të keqe.

— Sonte jo, — i fola atij zullapit të motrës, — të paktën jo sonte!

Ishte stepur afër murit dhe nuk e di në shihte qenin apo mua. Ai kishte ardhur për t'u parë në dritare me Meropin. E uli shkallën që i kishte mbetur në dorë, pastaj uli edhe kokën e vërshoi përmes oborrit pa thënë gjysmë fjalë.

— Nënë!

Nëna ishte shtrirë dhe më foli pa prituri që ta hapja derën.

— Ato u kthyen, — më tha, — edhe nusja edhe Meropi. Ishin për dajre tek Ana e Shushullës.

— Kam një lajm, — thashë. Fola prapë nga çardaku, pasi prej aty më dëgjonin të tria.

— A të gëzon ty? — pyeti nëna.

— Më gëzon, — thashë, — por më largon nga shtëpia disa kohë. Pas dasmës së Kondos, do të vete në qytet në kursin e trajnerëve të futbollit.

— Të gjitha ndërresat i ke të lara, mor bir. Kur të mbarojë dasma, bisedo vetë me tët shoqe. Edhe po nuk vajte, mos harro t'i çosh një shishe atij që ta solli lajmin.

Kisha pirë dy shishe me verë me Kondon dhe na kishte qerasur vetë togeri që më dha lajmin. Bisedën me time shoqe do ta bëja që atë natë. E kisha kërkuar shansin e trajnerit dhe nuk e lija të më ikte nga dora. Në mëngjes, pasi të takoja dhëndrin e nusen, do të mbathja opingat e reja dhe... As që më shkante në mend se të hënën do të venim me nënën në Dardhali për të varrosur Çondën.

Përpara se të hyja në dhomën time, u ktheva të shihja time motër. I kishte ngritur lart fitilat e llambave dhe, nën derë, dilte një rrip drite si një shtresë dylli. Në parvazin e dritares pashë një pjatë me dy hoje mjalti. Ngrita supet.

— I dëgjova, — tha ajo.

— Të gjitha?

— Lajmin tënd, — tha Meropi.

— Kur të sjellin pogaçen, unë s'do të jem këtu. Ma ruani pjesën time, — thashë.

U skuq në fytyrë, po nuk e hoqi perin nga qafa. Po thurte norta. Pashë se fija e perit ishte

e bardhë dhe mendova se kishte biseduar me nënën. Nga unë nuk priste ndonjë kundërshtim, prindryshe duhej t'ia kisha thënë nëpërmjet nënës. Po përgatitej për vazhdimin e *shkakut të nuses*. Pasi Ana të rrinte mysafire te Shushulla, me t'u kthyer përsëri në shtëpinë e burrit, prindërit e vajzave që u kishin ardhur pogaçe e mëndafshra, do të çonin në shtëpinë e djemve *norta* e *pogaçe*. Meropi po thurte *norta* të bardha dhe shtëpia e djalit do të merrte vesh se ne nuk ishim kundër asaj krushqie të ardhshme. Me një palë *norta* ngjyrë rozë, Shushulla ia kishte vënë kufirin te thana të *shikuarit* të dikurshëm të Anës.

— Fli tani, — i thashë Meropit, — qenin e zgjidha.

— Dëgjova, pra.

— Të gjitha?

— S'kishte aq shumë për të dëgjuar, — tha ajo.

Në Bardhgolem nuk e puthnim motrën sa ishte ende pa u martuar. Iu afrova Meropit dhe e putha. Të paktën, t'i rrinte mendja tek unë dhe jo te qeni. Kur zgjidhej qeni, i *shikuari* nuk kishte si të kthehej më.

U vonova ca në dhomën time, por, ndërsa dilja, zëri i nënës më mbajti përsëri në çardak.

— Baltazar, more shishe për atë që të solli lajmin?

— S'e gjeta bidonin, — thashë.

— As mos e kërko. Sot na erdhi KOMISIONI I NDIHMAVE. S'm'u ndodh tjetër dhe u dhashë bidonin me raki, tri kile djathë dhe ca qepë. E pinë rakinë atje ku po bëhet lufta, Baltazar?

— Ç'të thanë ata të KOMISIONIT?

— E pranuan, — tha nëna.

— E po, domethënë se e pinë. Kurse qepët, derisa të arrijnë atje, kam frikë mos prishen. Kореja është shumë larg.

— Më erdhi turp, — tha nëna, — dhe dhashë njëmbëdhjetë kile qepë. Më mirë të kisha dhënë gjysmë kile gjak. Kam dëgjuar se në qytet japin edhe gjak. Po deshe raki, merr nga damixhani i ahurit.

Nuk mora. Të hënën, përpara se të niseshim në Dardhali, mbushëm nga ai damixhan dy shishe për t'i çuar në vakinë e të ndjerit.

Te Zhavelloja shtëpia ishte plot dhe u shtrimë për të fjetur shumë vonë. Togeri u zu një grimë herë me të vëllanë. I kërkoi të flinte në hamakun e tij, por doktori nuk e lëshoi dhe fjeti vetë në treme. Në fillim u ankua, sepse e sulmuan mushkonjat dhe e dëgjova që më thirri: «Baltazar, më grinë kamikaxet!» Dritarja e dhomës ngjitur ishte e hapur dhe ai pati qejf të më fliste për kamikaxet japoneze, por duket se kisha zënë të gërhija dhe tjetrit, bashkë me kamikaxet, i mbeti edhe fjala në erë.

Gjithë natën fjetëm me dritaret hapur. Në atë dhomë ishte pirë shumë duhan. Dallëndyshet s'na kishin gabuar: natën ra një rigë shi, po unë s'mbaja mend ndonjëherë që shiu të mbante erë bajge. Me atë erë bajge të freskët sikur ishte mbushur dhoma, kur hapa sytë në mëngjes. Isha i fundit që po zgjohesha dhe, me t'u zgjatur te parvazi, pashë se jashtë ishte bërë kërdia. Ndonëse gratë hidhnin ujë me kova, plloçat e oborrit

nuk po laheshin nga gjaku. Më këmbë, mbështetur te shtyllat e tremes, doktori po hante ça mëlçi të ngrohta, të shkuara në tel.

— Kësaj i thonë çohu i vdekur të hash mish të pjekur, — po i thoshte dikujt. — Tani të vinte Çonda! Paska therur dje dhe pandeh se me një bisht deleje mund të marrë erë gjithë fshati. Kështu po, — u kujtua për diçka të çuditshme, — kështu mund t'i presësh si mysafirë e t'i kënaqësh edhe të gjithë ata që janë në varreza. Kësaj i thonë çohu i vdekur të hash mish të pjekur, Baltazar, — më pikasi në dritare.

Dy kasapë po merreshin me një viç të rrëzuar, ndërsa një duzinë bagëtish të imëta ishin rrjepur dhe varur rresht e rresht. E dija se doktori vetëm për viçin kishte paguar, bagëtitë që ishin therur dhe të tjera që do të thereshin, ishin darovitje nga farefisi.

— Kam dhe për ty ca shpretka, Baltazar, — m'u afrua doktori, — po t'i hash të gjalla, siç u ka hije djemve të fshatit.

Më zgjati një pjatë me shpretka keci e qengji. Që në fëmijëri isha mësuar t'i haja të gjalla. Po doktori vazhdonte të fliste. Ai përmendte vazhdimisht emra njerëzish dhe i ngatërronte emrat e atyre që rronin me të atyre që kishin vdekur. Gratë gjithnjë hidhnin ujë e fshinin me fshesa për të pastruar gjakun. Nuk e di pse m'u rënduan ato shpretka dhe nuk munda t'i vija në gojë, sikur të ishin mish njeriu.

— As Kondoja nuk i hëngri, — më tha Zhavelloja. — Do t'ua fal kasapëve. Për dhëndrin e shoqëruesin mëngjesi është bërë me tigan: kanë fërguar mushkëri për ju.

— Do të shkojnë shumë petkmbajtës te kru-
shka? — pyeta.

— Pesëmbëdhjetë dhe asnjë më pak, — tha
ai. — Jam marrë vesh me Shushullën dhe nuk
pranoj asnjë ndryshim. Togeri ka vajtur të më
zgjedhë kalin. Harrova të të thosha, erdhi Timoja
i Kubatëve e pyeti për ty. Mund të vijë prapë
më vonë.

Edhe sikur të mos vinte, nuk kishte më rën-
dësi. Kisha hequr dorë nga ndeshja e futbollit për
të dielën: do të shkoja në kursin e trajnerëve. Por
u qetësova, sepse të djeshmen më kishte hipur
një dyshim absurd. Kisha dyshuar se ajo zhduk-
ja e papritur e Timos (kinse, për radiografi në
qytet), ishte vetëm alibi. Në ato raste kur dikujt
i kishin vënë përgjues për natën e parë të marte-
sës, gjithmonë ishte përdorur një reng. Natyrisht,
Timoja ishte mjaft i ri për rolin e përgjuesit dhe
qoftë vetëm mosha e një përgjuesi të tillë do ta
rëndonte dhëndrin shumë. Po ku mund t'i besoj
djallëzisë së doktorit! Të gjithë u habitëm kur, tri
javë para dasmës që pritej të bëhej në qytet, dok-
tori erdhi tek i vëllai dhe hapi fjalë se dasmën e të
birit do ta bënte në fshat. Koha nuk premtoi për
të përfunduar një dhomë shtesë krejt të re. Po
ai vuri marangozë për të meremetuar një dhomë
tjetër dhe pyeti pleqtë për ritualin. Martesa e
Kondos, hapi fjalë, do të bëhet sipas të gjitha za-
koneve.

Më vonë e kuptove se ky kishte qenë kurthi i
vërtetë. Pas fejesës së të birit, kishte dëgjuar
gjithfarë fjalësh për Anën. Ai vetë s'kishte thënë
asnjë fjalë të keqe. Por i dukej se Kondoja po je-
pej shumë pas atij yllit të vjeshtës, Anës së bukur.

Dhe bukuria të verbon, thoshte doktori, madje në qytet të verbon edhe natën e parë. Në Bardh-golem, burrat që janë burra nuk pranojnë të mbajnë ndërresa të pista dhe gra të përdorura. Njëlloj do ta lija Anën, kudo të bëhej dasma, po të mos e gjeja të virgjër, më tha Kondoja njëherë. Në qytet kisha pak të njohur, edhe për mua ishte më mirë që dasma të bëhej në fshat. Po e kundërshtova tim atë: nuk e duroja zakonin e çarçafit dhe më tmerronte mendimi se, duke u bërë dasma sipas ritualit të fshatit tonë, ai kishte të drejtën që, si në çdo rast të dyshimtë, të më vinte përgjues. Kundërshtimet e mia ia ndezën xixat më keq. Pikërisht ato ditë më tha, për herë të parë, se unë po kërkoja të bëhesha një tjetër dhe se nuk isha më një Zhavello. Kot ta zgjasim, më tha, krushkës i kam çuar fjalë se dasma do të bëhet në fshat. Meqë ai kishte njoftuar Shushullën, e ndjeva për detyrë që unë të njoftoja Çondën. Me sa duket, fjala ime e vuri Çondën në alarm. Do të ketë menduar se, duke e ndërruar papritur vendin e dasmës, unë kisha zbuluar ndonjë të fshehtë që atje, në fshat, do të isha i detyruar ta nxirrja sheshit patjetër nëpërmjet çarçafit të natës së parë. Pra, gjakun e Anës tani nuk ia kërkoja vetëm unë, po ia kërkonte gjithë fshati.

— Baltazar, — më thirri doktori, — nuk po vishesh? Zëre se ia mbërritën daulltarët. I thuaj edhe Kondos të dalë në oborr!

Oborri ishte pastruar, kur doli Kondoja.

— Hajt tani, të gëzojmë, — më tha.

— Të gëzojmë, — i thashë.

Instrumentistët me daulle e curle ia behën shpejt. Ishin dy palë. U doli përpara doktori dhe që aty, te porta e oborrit, ata i bënë një *nibet*¹ të zotit të shtëpisë.

Pastaj u mblodhën gjithë petkmbajtësit, të cilët do të dërgonin te nusja disa petka dhe duvakun. Ishin veshur me rroba të reja dhe mua më dukej se shumica sapo kishin dalë nga dyqani i veshmbathjes. Edhe togeri mbante rroba civile. Por Katerina, e shoqja, ishte e pakënaqur sidomos nga pantallonat që kishin mjaft zhubra, sikur togeri të kishte fjetur me to. Ajo e thirri dy-tri herë nga shkallët e tremes: e kërkonte të ndërrohej. Togeris kishte qejf edhe vetë të ndërrohej dhe doli pastaj i veshur shik. Katerina harroi se me ato pantallona kisha vajtur të zgjidhja kalin, më tha kalimthi togeri. Dhe shtoi: Si thua, Baltazar, do të vdiste nga oftika Kristina atëherë, po të mund të më kishte parë kaq të pashëm? Sa qeshë i martuar me të, nuk pata kohë të rruhesha më shumë se tri-katër herë. Edhe im vëlla rruhet, por... Shihe, Baltazar, ç'trup për turp që më ka! — qeshi për doktorin.

Doktori e kishte hequr borsalinën, të cilën e mbante në dorë dhe e tundte herë pas here për të ndezur vallen. Nuk kishte fare nevojë: petkmbajtësit, si të kishin shpuzë nën këmbë, nuk rrinin një çast në qetësi. Ndërsa doktorin ajo dëshira e fshehtë për të mbetur gjithnjë korife e bënte pakëz qesharak. Ishte shtrënguar me kravatë e kostum të rëndë prej leshi, sepse nuk kishte tjetër, kështu që trupi i tij i lehtë dhe i imët humbte në

1) një lloj kabaje

stof. Ngaqë tundej vazhdimisht dhe kapakët e xhaketës i qenë hapur, dukej sikur do ta merrte era. Lola i rrinte në krah, e shihte në dritë të syrit dhe herë-herë ia fshinte fytyrën e djersitur me shaminë e saj.

— Kondoja, ku është Kondoja? — po thërriste dikush. — E kërkojnë te porta.

E mbajta Kondon nga dora.

— Ç'pate?! — tha ai.

— Jam shoqëruesi yt dhe më takon mua të dal, — thashë. — Ose dalim të dy.

Asgjë. Opingari kishte bërë një palë këpucë të reja dhe ia dërgonte Kondos dhuratë me një fëmijë.

— Sikur të më sillnin atë këmishën e hekurt, — u kujtua Kondoja, — Muzeu do të fitonte një eksponat të ri.

— Ndoshta e sjellin, — thashë. — Nesër mbrëma vijnë dhuratat.

— Xhemë Kurti m'i preu shpresat, tha se këmishës i ka humbur gjurma dhe nuk dihet më kush e ka. Çudi, si nuk e kam pyetur ndonjëherë gjeneral Kubatin!

U dëgjuan të shtëna revolveri. Po ktheheshim në oborr dhe pamë Kubat Kubatin që qëllonte në ajër. Petkmbajtësit kishin filluar të stoliseshin me degëza shelgu. U hap porta në dy kanatet dhe ata dolën njëri pas tjetrit. I fundit mbeti doktori Togerri e përfshiu në nënsqetullat dhe e ngriti majë kalit.

— Nuk e dimë ç'ke shaluar, zotrote, andej nga ke qenë, — i tha, — dhe mund të kesh harruar se si shalohen kuajt këtu!

— Turp për këto fjalë, — u turpërua doktori.

Pastaj ngriti fundin e xhaketës dhe, kur nuk e pritnim, ia dha me patllake për hava. Një mish i rjepur i varur në tendën e hardhisë, u këput e ra në tokë.

— Do ta djegim në dasmën tënde, Kondo, — i tha të birit. — Dhe atij mishi ia gjejmë vendin, Baltazar, — më tha mua. — Të piqet për ata që do të vijnë pa u ftuar në dasmë.

Togeri ia mori patllaken dhe e vuri në brez. Zuri kalin nga freri dhe u nis në këmbë të shoqëronte doktorin. Të gjithë petkmbajtësit duhej të ecnin më këmbë, përveç babait të dhëndrit.

— Doktorin kërkoi bombë, por im shoq nuk ia dha, — tha Katerina.

— Po ç'e donte bombën im atë? — pyeti Kondoja.

— Do ta hidhte në përrua, — tha ajo.

— Doktorin ka lajthitur, — tha Kondoja.

— Se mos kemi fëmijë tjetër për të martuar, Kondo, — iu var të birit në sup e ëma. — Ty të kemi të vetëm dhe yt atë e ka nga gëzimi.

— Lajeni atë gjak, — vërejti Kondoja i pezmatuar.

Mishin e therur, që ishte rrëzuar, e kishin ngritur. Po në gurët ku kishte rënë kishte mbetur një njollë e errët dhe e trashë. Ishte gjaku gjysmë i piksur i gabzherit.

— Po ti ç'pate, — më tha, — pse më mbajte qëparë nga dora?!

— Hajt, të gëzojmë tani, — thashë. — Unë kurrë s'kam për ta harruar se pikërisht në dasmën tënde mora lajmin për kursin e trajnerëve.

— Vetë e ke fajin, — u bashkua me gjykimin

e togerit, — herë tjetër lexoje gazetën edhe të martën. Kur hahet dreka te Shushulla?

Ia thashë orën për afërsisht.

Përpara se të mbaronte dreka e petkmbajtësve në shtëpinë e krushkës, unë e Kondoja dolëm nëpër fshat. Na duhej të trokisnim përsëri në ato shtëpi ku kishim trokitur për të ftuar njerëzit në dasmë. Por tani kishim me vete daullet e curlet dhe, ndryshe nga e enjtja, duhej ta fillonim nga larg afër. E filluam me Lagjen e Epërme, nga shtëpia e Gurbës së Norës. Vajzat dëgjonin muzikën dhe dilnin vetë nga shtëpia. Vetëm vajzat. Ato e dinin përse po i mbledhnim: do të shkonim në shtëpinë e dhëndrit për dafrungën e së shtunës. Rrugës u ndeshëm me priftin. Pastaj me një lajmës të krushkës. I kishin mbetur nja dy shtëpi të largëta pa lajmëruar. Unë e Kondoja e dinim se lajmësi nga shtëpia e nuses ftonte ndryshe. Ai nuk do të thoshte: «Sonte martohet vajza e Shushullës», po: «Sonte ka për të qarë e bija e Shushullës. Jeni të thirrur.» Kondoja tha se nuk do t'i pëlqente që Ana të dilte me lot nga shtëpia. Shushullën do ta marrim të jetojë me ne në qytet, më tha, nëse arrijmë t'ia mbushim mendjen me Anën. I thashë se shumica e vajzave zakonisht qajnë kur martohen, ndërsa vajzat e fshatit tonë qajnë edhe nga dashuria.

Time motër e gjetëm duke qarë, kur vajtëm për ta marrë me daulltarët. Natën kishte parë ëndërr sikur mua më kishte ngrënë qeni i shtëpisë. Më shkëputi nga daulltarët dhe ma tregoi ëndrrën ende e përlotur.

— Mbrëmë e zgjidha qenin para kohe, — i thashë Kondos, — dhe nuk e lashë atë zavallin e

saj të vinte për ta shikuar. Sesi ndodh nganjëherë me njeriun: shpirti i tij gjithmonë peshon më rëndë se trupi i tij dhe, prapëseprapë, nuk ia përton ta rëndojë edhe më. Mbrëmë e kam rënduar shpirtin me Meropin, sepse gjithë natën ajo e paska mbajtur mendjen te qeni.

— I frikësohesh mëkatit? — pyeti ai.

— I druhem, — thashë, — dhe ndëshkimin nuk e pres nga të tjerët, po nga vetja. Vuaj me veten për atë që s'e kam bërë mirë, dhe ky është ndëshkimi im.

— Edhe ky lloj ndëshkimi është një lloj mëkati, — tha Kondoja. — Ç'të paska përrallisur im atë?!

— Mbetëm prapa, — thashë.

Nxituam për të arritur grupin e vajzave para nesh dhe iu shmanga përgjigjes. Me të arritur vajzat, Kondoja u kthye nga unë:

— Baltazar, sa më i ndershëm të jetë njeriu, aq më i trashë është mëkati që bën. Ai nuk di ta këmbejë sëpatën me briskun që pret hollë siç bëjnë njerëzit dinakë. Ndoshta jam treguar dinak me tim atë, por nuk jam i penduar: unë ia hodha atij! Që kur i thashë se baxhën e tavanit do ta gozhdoja të shtunën, e dija se po ia hidhja dhe se do ta gozhdoja të premten. Ai kokën e tij, unë timen!

Megjithatë, kur u zbulua e vërteta, doli se doktori prapëseprapë na e kishte hedhur. Dhe të gjithëve na la pa mend me njeriun që kishte zgjedhur si përgjues. Kondos iu desh të saktësonte disi vlerësimin ndaj meje: «Ti je pak naiv, Baltazar!», më tha.

Një pushim i shkurtër

Një pushim i shkurtër

Treni gulçonte duke rendur.

Ai e ndërpreu tregimin. Ndoshta kishte nevojë për një pushim të shkurtër, një pushim me veten. I propozova për kafe në vagonin e shërbimit dhe Baltazari pranoi. Po kur u ngritëm, mori në skarë edhe çantën e dorës, që e kishte vënë pranë valixhes sime të udhëtimit.

— Ç'e do? — i thashë.

Nuk foli.

Në vagonin e shërbimit nuk kishte tryeza portative dhe ne i pimë kafet në banak. Ai e piu të nxehtë, ndonëse e dinte që kafja e nxehtë nuk bën mirë për stomakun. Truri i njeriut ë ka edhe më pisk, se bluan më shumë nga stomaku, qeshi. Domethënë, më paske vënë re?

Po, thashë, ti ishe ulur në radhën e parë

dhe salla nuk ishte aq e madhe. Por sot, kur më takove në tren, nuk po kujtohesha ku të kisha parë.

Ashtu është, qeshi përsëri, truri i njeriut bluan më tepër nga stomaku. Në murin e librarisë ku bleva librin, lexova edhe shpalljen për konferencën që do të mbaje. M'u duk temë interesante dhe erdha të të ndiqja në sallë. Meqë deri tani më ke dëgjuar mua, dëshiron të dëgjosh pak veten?

— Nuk kam ndonjë qejf, — thashë. — Për mua janë arsyetime të përsëritura që kanë filluar të më mërziten. Paske incizuar në sallë?

Ai nxori nga çanta një «Sony» sa një paketë cigaresh. Kam incizuar sa munda, tha. Shtypi butonin dhe dëgjova përmes rrapëllimës së shinave: «Ka raste që autori e thekson ose nuk e thekson formën. Ndërsa kritiku guxon të marrë në dorë edhe lavjerrësin dhe, duke e matur kohën siç di ai, por siç nuk matet koha artistike, shpall se në roman nuk mund të zhvillohen ngjarjet në kaq apo aq ditë, se një shekull gjithmonë është shumë, po një javë gjithmonë është pak. Ai harron se koha sikur ngec kur nuk ke diçka të thuash dhe se është pikërisht ritmi i mendimeve përcaktues i kohës në art. Natyrisht, koha s'mund të jetë e njëjtë për të gjithë, secili personazh ka lavjerrësin e vet...»

Baltazari e fiku magnetofonin dhe priti të mbaroja kafën. Pastaj më njoftoi:

— Të gjitha ato të tjerat që the, për mua nuk kanë ndonjë rëndësi. Për mua ka rëndësi kaq: çdo njeri ka lavjerrësin e vet. — Dhe më kujtoi: — E lashë atje, kur po bisedoja me Kondon dhe

Kondoja më tha: «Doktori ka kokën e tij, unë timen». Ky është lavjerrësi?

Futi magnetofonin në çantë, pastaj seç tha për futbollin dhe kaluam në vagonin tonë.

@.

WWW.COM.NEBELI.ARABI

Inoksidom Albomi



N → Nazipe
 d → dorolje
 A → Bide
 B → Batellxhek
 d → Naza
 R → Shaze
 M → Skluptura
 J → Mardheme
 T → Tejike,

I B
 /
 She
 B → Boshan
 E → Ejtiri
 M → Momushoqe
 G → Gogur
 M → Gole

Pjesa e dytë

Instrumentistët me daulle e curle e kaluan natën në shtëpinë e Zhavellove. Kur doktori trokiti në dhomën tonë për të na zgjuar, ata e kishin ngrënë përsheshin me qumësht. Pagjumësia është në zanatin e tyre.

— Shpejt, shpejt, — na nxiti doktori.

Kondoja u ngrit në këmbë shumë lehtë, sikur ta kishte marrë malli për Anën dhe tani që do të shkonim për ta takuar, të mos i durohej më. Në shpinën e një karrigeje ishte këmisha e re, që petkmbajtësit e kishin sjellë të djeshmen nga shtëpia e nuses për dhëndrin, bashkë me çorapet, shaminë e ca plaçkurina të tjera të vogla. Kondoja e veshi e më tha:

— Ti i ke provuar këto para meje, Baltazar, s'të bëjnë më përshtypje.

— Ta kam zili, — thashë.

— Pse, — qeshi ai, — dashke të martohesh prapë?

— S'e kam aty, por ka gëzime që njeriu do të donte të zgjasnin tërë jetën.

— I marrë, — tha Kondoja, — gëzimi që zgjat e vret njeriun, njëlloj si hidhërimi i gjatë. — E ngriti zërin dhe diç iu përgjigj të atit që na thirri në emër. — Mirë më rri këmisha? — më pyeti.

— Tamam dhëndër, — thashë.

— Mban erë kënjaje, — tha ai.

Nga dritarja pashë se ende nuk kishte filluar të fekste. Po yjet ishin zbardhur ca dhe errësira, sidoqoftë, ishte holluar. Dola në hajat.

— Zonjusha, — dëgjova një zë, — të na falni për shqetësimin! Keni arsye të ankoheni, por nuk keni shkak të trembeni: mishi juaj, makar, nuk hahet dhe askush nuk ju vret!

Ishte doktori që po u fliste në treme dallëndysheve.

— Baltazar, e di ti përse dallëndyset i kanë këmbët aq të shkurtra e të dobëta?

— Unë nuk di që i kanë të shkurtra e të dobëta.

— Ah, po këtë e di gjithë bota. I ke parë dallëndyset të ecin në tokë? Nuk i ke parë. Dhe s'i ka parë as bota. Ato qëndrojnë gjithë ditën në ajër dhe ajri do krahë, jo këmbë. Shumë keq, Baltazar!

— Pse shumë keq?! — më habiti serioziteti i tij.

— Se është njëlloj si të thuash që peshku ka këmbë. Këmbë kanë vetëm qeniet që ecin në tokë.

— Në tokë ecën edhe gjarpri, — thashë.

— Po edhe gjarpri ka këmbë, veçse i fsheh, — më zuri Zhavelloja. — Pehlivanllëqet e pehlivanëve nuk më pëlqejnë. Shumë keq, Baltazar, në më fshihni diçka me atë Pehlivanin tim!

Kondos, që po vinte në treme, i zuri veshi emrin e tij të dikurshëm dhe u përgjigj:

— Ka diçka që ta kemi mbajtur të fshehtë deri tani, baba.

— Çfarë? — pyeti disi ftohtë doktori, pa dashur ta jepte veten.

— Atë historinë tënde me Qejvan Qejvanin e kemi përfolur këto ditë me Kondon, — thashë unë. — Të kujtohet si e peshove syrin, atëherë, me ar? Syri i tij ishte i gënjeshtërt dhe ari yt i gënjeshtërt, kallp për kallp.

— Rron akoma ai malukatí? — më pyeti doktori.

— Rron, — thashë, — dhe si gjithnjë sheh vetëm me një sy.

— I mjafton, — tha. — Edhe sikur t'i kishte të dy sytë, ai nuk do të ishte në gjendje të dallonte arin e vërtetë nga kallpi. Tri drita të forta e verbojnë njeriun: drita e zjarrit, e arit dhe e bukurisë. Kështu që nuk mund të thoni se ia kam hedhur atij ronxhosh.

— Jo, doktor, — tha i biri, — ma hodhe mua.

— Kam dëshmitar Baltazarin, — tha Zhavelloja.

Më erdhi inat që u ndodha atë çast aty dhe që më drejtohej mua si dëshmitar. Zhavelloja gjithnjë kishte pasur frikë se mos i mbaja ndonjë të fshehtë, ndërsa po dilte përsëri se të fshehtat ata i kishin mes tyre.

Kondoja, që ishte ngritur i lehtë nga gjumi, u murrëtye në fytyrë dhe u vërtit i ngathët duke kërkuar këpucët e reja. Duke i mbathur, Lola ia krihte flokët prapa me një krehër perloni që e nxori nga xhepi i përparësës. Ai duroi që ta krihte e ëma. Pastaj u ngrit.

— Ke qejf të të kreh me duart e mia? — më pyeti.

— E kreh unë Baltazarin, — tha Lola dhe më krehu edhe mua.

— Aman, ta mbarojmë këtë dasmë mirë dhe kush është si ne pastaj! — tha doktori. — Nuk e shihni ç'xhins i butë që jemi! Jepuni këmbëve tani. Njeriu i ka edhe krahët, po qenka e thënë që ai të mos fluturojë.

U nisëm me Kondon shpejt, sa ishte ende errësirë dhe shpëtuam nga broçkullat e doktorit. Një çift me daulle dhe një çift me curle na ndiqnin pas. U thamë instrumentistëve të dilnin para nesh. Ende s'kishin filluar t'u binin veglave. Gjithandej kishte heshtje dhe qetësi gjumi.

Befas, shkurrja ndanë rrugës lëvizti. Kthyem kokën e nuk pamë njeri, po një gjëmim i përnjëhershëm u ngjit nga honi i përroit dhe ai shpërthim bombe na mbajti në vend. Pastaj gryka e tërhoqi gjëmimin përpjetë.

— Po t'i besohet doktorit, dallëndyshja dhe njeriu nuk gjuhen, sepse mishi i tyre nuk hahet. Por, megjithatë, njeriu gjuhet si derri i egër. Atë e gjuan edhe i Papjesi dhe unë e vrava të Papjesin, — qeshi togëri për Djallin.

I zgjati dorën dikujt dhe e tërhoqi nga e poshtmja e rrugës. Ishte e shoqja, Katerina.

— Ai Zhavelloja yt, Kondo, më ishte vënë për

një bombë, mirëpo nuk ia dhashë, — tha togeri, — Doktor mund të dijë ndonjë gjë për kamikaxet e ajrit, po as që ua ka haberin bombave të dorës.

— Ç'e paska dashur bombën babai? — pyeti Kondoja si herën e parë.

— Donte t'ju përcillte ju, — tha togeri, — dhe të largonte Djallin nga përroi, që të mos jua priste udhën. M'u vu shumë dhe, në vend t'ia be-soja bombën atij elifimatrakut, dola t'ju përcillja unë. Tani krihi, Kristinë!

— Na krehu Lola, — tha Kondoja.

— Po unë e kam marrë krehrin me vete, — ngeli gruaja.

— Krihe Baltazarin, Kristinë, — tha togeri.

Isha fort i bindur se të shoqen e togerit e quanin ndryshe dhe prita që, herën e dytë, Katerina t'ia përplaste Kristinën turinjve. Apo veshët më kishin gabuar? Nuk më kishin gabuar.

— Jemi marrë vesh, — e ngriti zërin togeri, — që kur dolëm në rrugë: tani Katerina është Kristinë. Kondoja po shkon te nusja, ai martohet për herë të parë dhe nuk mund të dilja ta përcillja me gruan time të dytë. Kushedi si ka qenë bomba në fillim. Bombat që janë bërë më pas mund të jenë bërë më mirë, por nuk kanë qenë diçka e re, ato kanë imituar atë të fillimit. Njeriu vetëm një herë mund ta ndiejë plotësisht gëzimin e dasmës: në martesën e parë. Krihe Baltazarin, Kristinë!

I thashë se nuk kishte nevojë, por ajo më krehu. Ti i ke flokët të lëpirë, më tha, si të togerit. Për këta lloj flokësh është shpikur krehri, kurse flokët e Kondos i ka krehur vetë zoti përderisa e bëri me kaçurrela.

Pastaj togeri më përfshiu nga mesi dhe më

ngrit lart, në shenjë për qafimi. Ishte alamet trupi dhe dukej sikur gjithnjë i tepronin energji. Kur e përfshiu Kondon dhe u rrotullua me të, mendova se Kondoja ishte më i rëndë nga unë, sepse togerit i shpëtuan ca ngecngucje të lehta. Nuk kishte dritë të mjaftueshme për ta parë; ai po ngashë-rehej.

— Ta duash fort mbesën e Çondës, Kondo! — thirri kur po largoheshim.

Ne ishim nisur për të zgjuar nusen nga gjumi.

— Pse nuk e përmendi Anën me emër? — më pyeti Kondoja.

— E përmendi, — thashë, — të gjitha gratë e para paskan një emër: Kristinë.

— Anën e dua aq shumë, — tha ai, — sa nuk e marr me mend ç'mund të ndodhte me mua po ta humbisja.

Kishim arritur pranë murit të shtëpisë. Kondoja u ndal dhe ngriti kokën. Atij i ra një yll në sy dhe mua m'u duk se kishte dalë Ana në dritare.

Ana doli vërtet, na e bëri me dorë dhe u zhduk.

— T'u biem curleve? — pyeti njëri nga instrumentistët.

— T'u bini, — i tha Kondoja, — duhet të zgjojmë nusen.

Ata filluan me plogëti, sepse panë që Ana ishte ngritur edhe pa muzikën e tyre. Derisa e mbaruan ata kabanë e nuses, Kondoja më foli për ndjenja të gëzueshme. Tha se të parët tanë nuk e kishin pasur keq që të dielën, pa zbardhur drita, dhëndri vjen me shoqëruesin e tij për ta zgjuar

të dashurën me serenatë. Po s'e kuptoj, thashë, përse nuk lejonin që nusja të dilte në dritare? Ai s'u kujtua për këtë, sepse Ana doli përsëri dhe na përshëndeti të dy.

Pastaj mbaroi kabaja dhe dolën të na merrnin njerëzit e shtëpisë. Shushullën e shoqëronin dy të kunetërit, vëllezërit e burrit të vdekur. Te porta e oborrit ishin edhe tre-katër burra të tjerë. Mbjaj mend se njëri prej tyre ishte Gurba i Norës. Karriget dhe një tryezë të lartë druri i kishin nxjerrë në oborr.

— Kondo, — tha Shushulla, — mos dëshiron që kafet t'jua sjellë Ana?

— Ana?! — ngeci Kondoja. Nuk e priste pyetjen, se nuk pritej që nusja të mundte të dilte në oborr. — Pse jo, — qeshi ai, — në duart e Anës edhe kafet bëhen më të ëmbla.

— Po të ishte për më të ëmbla, sillnim kutinë e sheqerit këtu, — e zgjati shakanë dikush.

Por duket se propozimi i Shushullës kishte qenë i atypëratyshëm dhe nuk kishin pasur ndonjë marrëveshje përpara. Gruaja që ishte caktuar për të sjellë kafet, po vinte drejt nesh me tabaka në dorë. Kthimi i kafeve dhe lëvizja e datës së martesës, te ne ishin thuajse të papërfytyrueshme.

Daulltarët filluan muzikën. Qielli po zbardhej. Një grup vajzash, shoqe të nuses, dolën për të kërcyer në oborr.

— Baltazar, — më foli Gurba, — e pe Çonden?

— Ku?

— Këtu, — tha Gurba. — E piva një kafe kur u zgjova, — i tha gruas që shërbente, duke shtyrë pakëz tabakanë me dorë. Po gruaja nuk lëvizi dhe

0/ Gurba mori filxhanin. — Qenka e ëmbël, Kondo, — u vonua duke gjerbur kafen, — njëlloj si ta kishte sjellë Ana.

— Ku, këtu?! — pyeti Shushulla.

Gurbën e kisha më pranë, Shushullën më larg dhe unë kisha pandehur se ajo s'i kishte dëgjuar fjalët tona për Çondën?

— Në fshat, — tha Gurba. — E ke takuar, Baltazar?

Nuk mund ta ktheja kokën prapa për të parë Shushullën. Ajo s'di pse u ngrit për një grimë. Kondos, që e kishte më të volitshme, nuk i ra në sy ndonjë shkak i jashtëm. Rrinte në këmbë, më tha ai, njërin kind të shamisë e kishte mbledhur në grusht dhe me atë grusht kishte mbuluar gjysmën e gojës.

Do ta shihja të nesërmen, kur po varrosnim Çondën, duke mbajtur me dorë çipin e buzës që i dridhej. Vetëm shamia nuk ishte më e përhime e me ojna, por e zezë dhe me thekë. Po ajo shami që njerëzit e burrit i dhanë kur varrosi të shoqin dhe që ajo e përdori edhe kur varrosi Kaninë. Binte shi, një turr vëre me shkrepitima. Uji sapo ishte hequr nga gropa e varrit me kova dhë, me të zbritur arkivolin, shpejtuam të hidhnim dhë. E kisha ende para syve Çondën ashtu siç e kishim gjetur të shtrirë në një pellg gjaku, dhe shiu që skuqej nga vetëtimat më dukej sikur po stërpikte gjithë varrezën me gjak. S'e kuptova përse pushuan lopatat, gjersa më thirri nëna: «Baltazar!» Atëherë pashë se rrethi i njerëzve u hap. Po vinte Shushulla me vëllezërit e burrit që e mbanin nga krahët. Kullonte ujë dhe deri lart në brez ishte përbaltur. M'u duk sikur, për të ardhur te varri i vëllait,

edhe krushka vetë sapo ishte ngritur prej një varri tjetër, i tha togeri Kondos më vonë.

Shushullën nuk e dëgjova të ulërinte, madje nuk kuptohej nëse përlotej. Shamia i kishte rënë skith në supin e djathtë dhe po në atë krah kishte mbuluar gjysmën e gojës me thekët e kindit. Gjysma tjetër i dridhej vetvetiu. Ajo brente kindin e shamisë me dhëmbë, por dorën e kishte ngjitur pas gojës dhe gishtërinjtë e saj, të zbardhur e të rrudhur nga uji, dukej sikur do t'i binin përtokë. Nuk arrite ta shohësh dajën, nënë!, iu afrua Ana. E kam parë, tha ajo, e kam parë atëherë kur erdhi të merrte Kaninë. Një varr më ndau nga Çonda e një varr po më bashkon prapë me të. Tani vetëm varri im e ndan tët emë nga Kania e Çonda. U përkul të shihte në gropë, po nuk e linte balta që kishte rënë mbi të vëllanë. Atëherë ne vazhduam ta mbulonim, sepse ujërat po shtoheshin. Dhe Shushulla e lëshoi veten, ngashërehej pa ilaç. Gratë e Dardhaliut, po atë ditë, përfituan të thoshin se ujërat u shtuan ngaqë qante motra për vëllanë. Këto fjalë nëna ime i solli si një të vërtetë edhe në fshatin tonë. Unë dëgjova njerëz që i përsërisnin në shtëpinë e Shushullës, kur ajo u kthye në Bardhgolem dhe ne i vajtëm për kryeshëndoshë. Dherat ende nuk ishin tharë dhe varri i Çondës nuk kishte zënë vend, por ajo nuk qante më. Vetëm se ngrihej herë pas here dhe, meqë shërbimet e pritjes i kryente tjetërkush, mbetej në këmbë pa ndonjë shkak. Pikërisht si mëngjesin e dasmës, kur na i kishin sjellë kafet në oborr dhe Shushulla u ngrit.

E kisha pas shpine, s'e shihja ç'po bënte. Ia

ka zënë vetes gojën me shami, më tha Gurba. Ndoshta është penduar dhe tani kafshon gjuhën: ka folur shumë kundër të vëllait! Unë pata një mendim të çuditshëm: po sikur Çonda të mos kishte dërguar njerëz (Kovaçin, Gurbën etj.) për t'u marrë vesh me të motrën, po të kishte ardhur vetë drejt e në dasmë, do të ishte thyer Shushulla? Gratë, nganjëherë, është më lehtë t'i thyesh me veprim sesa me fjalë.

Befas, një dorë prapa meje më zuri nga supi.

— Baltazar, meqë doktori kërkoi shoqërues për të birin, më vjen mirë që të zgjodhën ty. Ne jemi dhe tanët.

— Ma thuaj ndryshe, — iu luta.

— Si ndryshe?! — pyeti Shushulla.

— Si të duash, vetëm kështu jo, se kështu më ka thënë edhe Çonda.

Shushulla më rëndoi në sup duke u përkulur.

Më pëshpëriti:

— Baltazar, të paça vëlla!

— Ke ndonjë hall? — e pyeta.

— Kam, — tha ajo. — Hap sytë sonte!

E morën vajzat në valle dhe mbeta i pasqaruar. Pastaj lindi dielli dhe ne duhej të iknim. Shushulla nuk u nda te porta, eci me ne përgjatë murit të jashtëm të oborrit. Nën dritare i thirri së bijës:

— Ana, Kondoja dhe Baltazari po shkojnë. Dil t'i përshëndesësh!

— U përshëndetëm edhe kur erdhëm, — e zbuloi të fshehtëm Kondoja.

— Mirë bëtë, — tha Shushulla.

Erdhën vajzat pas nesh dhe, kur Ana doli në dritare, ato kënduan:

*Pikon kënjaja pika-pika,
mbrëmë ishe flamur ndër çika.
Pikon kënjaja me pika të mëdha,
sonje je flamur ndër gra.*

I këndonin nuses. Shushulla më pëshpëriti përsëri:

— Hap sytë, Baltazar, sonje atyre mund t'u vënë përgjues. Kam dëgjuar se dyshojnë në xhin-sin tonë dhe dikush paska zënë në gojë Kaninë. Të paça vëlla, nuk dua të ketë përgjues!

— S'do të ketë, — i thashë.

Nuk i tregova se e kishim gozhduar baxhën e tavanit, se m'u duk tradhti ndaj doktorit. Po rrugës, duke mbledhur të gjitha dyshimet e vogla të atyre ditëve, më fryu djalli në vesh edhe mua e pyeta veten nën zë: Mos vallë Ana është bërë grua më përpara?

— E shohim garën e kuajve?

— Si të duash, — i thashë Kondos.

— Vemi në shtëpi një herë, — tha ai.

Dhe morëm për në shtëpi, ndërsa daulltarët Kondoja i nisi në Livadh.

Çanta Një bisedë e çuditshme ishte bërë në Livadh. E mora vesh nga opingari, por pasi ishte tharë varri i Çondës.

— Të mos e kisha krushk të Anës, — kishte thënë Çonda, — doktorin do ta kisha rrahur.

Opingari s'e dinte me saktësi përse do të mundte ta rrihte, por, duke biseduar me Çondën, shprehu dyshimin që kishte vetë në mend:

— Nga e di ti se ai do të vërë përgjues?

— Në vë përgjues nuk e di, por nuk e di as përse i shkrepri ta bëjë dasmën në fshat. Ç'paska zbuluar doktori?! Kërkon të lidhë Anën apo mua? Mua m'i ka lidhur këmbët që tani: këtu unë nuk mund të shkoj në shtëpinë e krushkut për të parë Anën nuse, se do të më qeshte fshati. Në qytet do të kisha shkuar.

E kishte pikë që nuk do ta shihte Anën nuse, më tha Xhemë Kurti. Xhema e shoqëronte në Livadh me opingarin. Të tre e kishin kaluar natën në shtëpinë e Xhemë Kurtit. Aty ishte gdhirë edhe fotografi, që kishte ardhur të fotografonte vullnetarët e CENTRALIT HIDROELEKTRIK. Në mëngjes, më tregoi Xhema, fotografi iu afrua djepit ku po flinte një fëmijë qumështi. E shkrepri aparatit dhe iu kthye Çondës: Bukur? Hiç bukur, i tha Çonda, herë tjetër mos i trazo engjëjt. Si engjëjt?, u prek tjetri. Engjëjt pra, tha Çonda, nuk është mirë të fotografohet një foshnjë kur është duke fjetur! Ndërsa në oborr i shfryu opingarit: Ç'është ky zakon i poshtër për të përgjuar dhëndrin me nusen kur flenë bashkë natën e parë?!

Në Livadh Xhemë Kurti me opingarin e kishin vënë në mes Çondën. Ne i kishim përkundruall, ata në një anë dhe unë e Kondoja në tjetrën. Dhëndrit e shoqëruesit, natyrisht, u kishin lënë ballët e vendit, po ne nuk i vërejtëm që në fillim. Vetëm pasi mbaroi gara dhe filloi kabaja e kalit fitues, ata u afruan pakëz. Kali ishte një himç shtatlartë, me cirka në gjoks dhe te gjunjët. Atë kalë vrapimi Kristo Kubati e kishte zgjedhur në Borje, mes gjithë farefisit të tij nga e ëma. Doktor Zhavelloja lavdëroi me zë kalin dhe shau

Roland Tole

nën zë kalorësin. Por premtimin që kishte shpallur për fituesin — një qengj të gjallë — u detyrua ta mbante. Edhe i zoti i kalit, që kishte ardhur për të parë garat, ishte i mendimit se qengji i takonte kalorësit. Kristo Kubati hodhi qengjin në kurriz dhe u nis mes për mes fushës me atë kurorë leshi e mishi rreth qafës. M'u duk se atë mëngjes ishte zgjuar më i bukur dhe një përskuqje e lehtë ia kishte mbuluar pullat e rrjepura në fytyrë. Po e kishte pasur nga era. Ai vazhdoi mes për mes fushës pa e ndryshuar ecjen, sikur të ishte nisur drejt e te Çonda. Disa e morën për provokim, të tjerë thanë se i lëshoi edhe ca fjalë të hidhura Çondës: *Hakmarrja është thikë me dy presa* etj. Po të gjitha qenë vetëm hamendje. Kristo Kubatit andej i binte rruga më shkurt për të vajtur në shtëpinë e priftit, më tregoi Xhemë Kurti më vonë. Kishte vendosur që atë qengj t'ia falte priftit. Vetë nuk shkonte kurrë në kishë, po donte t'ia bënte qejfin së ëmës, që i kishte porositur priftit një përsheptje në fillim të javës për të shoqin e vdekur. Dhe ju nuk ju foli fare?, pyeta Xhemën. Na foli, pranoi Xhemë Kurti. Kur na u afrua shumë dhe iu desh të ndërronte pak drejtimin, sesi na buzëqeshi e tha vetëm kaq: «Ka edhe engjëj të zinj!» Ashtu e solli rasti, ai e kishte fjalën për qengjin që mbante në kurriz. Po neve s'na ra mirë në stomak, sidomos Çondës, sepse Çonda pak më parë na kishte folur për engjëj që flenë në djep dhe për engjëj që flenë bashkë natën e parë të martesës.

Gjatë së njëjtës bisedë, ndërsa ktheheshim nga Dardhaliu ku kishim vajtur për të varrosur Çondën, Xhemë Kurti më tha:

— Baltazar, po atë të enjte që ti dhe Kondoja hëngrët drekë në Lagjen e Epërme, e kam parë doktor Zhavellon duke hyrë në rrugicën tënde. Unë mendova se shkonte në shtëpinë e shoqëruesit të dhëndrit, po ai paskësh vajtur në shtëpinë e përgjuesit. Ta merrte mendja se do të zgjidhte përgjues Qejvan Qejvanin?!

Me të mbaruar gara e kuajve, dasmorët u mblodhën te Zhavelot. Në oborr ishte rrëmujë, por unë e Kondoja bisedonim në treme me priftin, që pinte me një shishe arançate. Ai e mbante shishen gjithnjë me ngjyrë dhe askush nuk e kuptonte sa i hiqte gurmazi. Kur erdhi doktori për ta përshëndetur, prifti nuk luajti nga vendi, si të mos kishte përpara babanë e dhëndrit.

— Hë, nuk të bie në mend kush jam? — u prek Zhavelloja.

Na kishte ndërprerë bisedën dhe priftit s'i erdhi mirë.

— E kam memorjen, — tha, — por s'e përdor, se nuk më duhet. Nganjëherë njeriut i vlen më shumë harresa se kujtesa. — I dha dorën Zhavellos dhe shtoi menjëherë: — Dhe, kështu, unë u çmenda atëherë. Por në çmendinë nuk më çoi marrëzia, më çoi mendimi. Doktor, ti ke qenë në Indi kur unë kam qenë në çmendinë. Në sy të disave, natyrisht, kjo ishte një njollë për mua. Po të shprehem me figurë, ata më thoshin: Ti s'je i ndershëm, ti vajte në bordello. Unë isha i bindur se nuk isha fundërrinë, pra nuk i përkisja periferisë së shoqërisë. prandaj këmbëngulja dhe dola në qendër. Në këtë mënyrë, dëshmoja se isha i

ndershëm. Por, në rast se unë dilja i ndershëm, ata të tjerët, trutharët, dilnin të pandershëm. Ua thosha këtë, po s'donin që s'donin ta merrnin vesh gjuhën time. Më thoshin se isha skizofren dhe se nuk e kuptoja kontradiktën. Unë vazhdova të punoja me durim. Nuk lakmoja emër, por puna më pëlqente dhe doja të dëshmoja patjetër se diçka vlejta. Prandaj shkrova tërë ata libra. Puna ka qenë terapia ime, doktor. A vlen kjo lloj terapie për medicinën tënde?

Zhavelloja nuk u përgjigj, se i foli togeri, i cili pyeste në duhej të niseshin krushqit për të marrë nusen: ora po kalonte nëntegjysmën. Togerit ishte me njërin nga kushërinjtë e Gurbës, drupunuesin që bënte rrota karrocash. Gishtërinjtë e këmbëve drupunuesi i kishte me një morth të hatashëm dhe gjithnjë e vrisnin opingat. Nuk e pashë të çalonte dhe thashë se diçka kishte ndryshuar: opingat ose këmbët e tij.

— Gjërat ndryshojnë që të korrespondojnë,
— tha urata, — pra të duhen, të arrihet harmonia.

— Na vdiqe me atë harmoninë tënde, uratë!
— ia bëri doktori.

— Të fillojnë daullet? — pyeti togeri.

— Të fillojnë, — tha doktori dhe iku nga tremja për të hyrë në turmë. Urata e ndoqi me një nënqeshje që na e ngjiti edhe neve.

— Sa gurmaze, aq avaze, — tha. Hoqi nga shishja një gllënjë dhe shtoi se uji me sheqer i bënte mirë për mëlcinë.

Pastaj dëgjua daullet dhe vërejtëm si po shtyhej rrethi i njerëzve. Po fillonte vallja. Tani dëshiroja që urata të fliste, por ai kishte qejf tjetër, po e shijonte dafrungën në heshtje. E kisha

dëgjuar njëherë të thoshte se, kur fshatarët tanë kërcejnë vallet e vjetra, nga shprehja e fytyrës dhe nga gjestet ata duken si perëndi, sepse duke kërcyer, në të vërtetë, ata krijojnë. Kush krijon, kishte thënë urata, është edhe më afër Krijuesit.

Kondoja po pinte duhan dhe sesi u kujtua me aq vonesë:

— S'i kam parë gjëkundi librat e tu, uratë.

— E ku do t'i shihje, — tha ai, — ti punon në morg, jo në bibliotekë. Muzeu është tempulli i të vdekurve. Më dil ndonjë ditë nga shtëpia që t'i shohësh dorëshkrimet në bibliotekën time. Unë nuk kam botuar prej tyre asnjë rresht.

— Po ata, uratë, — pyeta, — ç'mund të mendojnë ata që thoshin se je i pandershëm?

— Të mendojnë ç'të duan, nëse ekzistojnë ndopak. Po kam frikë se nuk ekzistojnë, — tha ai. — Për të kaluar atë krizë skizofrenie, unë kisha nevojë t'ia mbushja mendjen vetes se ata ekzistojnë. Njeriu, shpesh, i shpik armiqtë e miqtë e tij edhe kur s'i ka. Unë nuk u ula të shkruaja për të tjerët, por për veten time. Dhe meqë te vetja ime tani zotëron harmonia, do të thotë se ia arrita asaj që desha: i bëra gjërat të ndryshojnë dhe të korrespondojnë. Baltazar, në fshat teprohet me ushqimet pikante dhe të këshilloj ta përdorësh ujin me sheqer, sidomos në mëngjes esëll. Sa vajti ora?

Dukej se po i afrohej dhjetës, sepse kalit të bardhë po i lidhnin në njërin vesh shaminë. Kruhshqit po shkonin për të sjellë nusen. Mua dhe Kondon na kërkonin për t'u përçafuar. U ngrit me ne edhe urata. Të fundmet i përcollëm gratë, që shkonin pa u ndier pas burrave. Sapo krushqit

zbritën të përpjetën dhe rruga u bë e rrafshhtë,
Kondoja e mori me mend dhe më tha:

— Tani!

Mprehëm veshët dhe arritëm të kapnim zë-
rin e burrave. Ata, si në çdo dasmë që bëhej në
Bardhgolem, ia morën këngës së njohur të Ymer
Agos. Por në fshatin tonë këndohej disi ndryshe:

*Shalo kalin, Ymer Ago,
shalo kalin, eja n'shtëpi,
se ty djemtë, Ymer Ago,
një nga një t'i kanë grirë,
se ty gruan, Ymer Ago...*

Ktheva kokën për priftin, por u kujtova se
urata na kishte lënë me kohë uratën («Paçi ura-
tën!» kishte thënë kur u ndamë.) E pashë që ecte
shtegut, duke ngritur kindat e veladonit. Ndoshta
prandaj kishte pyetur për orën, po vente në kishë
t'u binte kambanave për meshën e së dielës.

— Pa shiko, Baltazar, — më zuri nga krahu
Kondoja, — trupi i saj më duket gjithë vrima-
-vrima, sikur ta kenë bërë shoshë me thika.

Po fliste për Anën dhe më kërcyen mornicat
deri në zverk. Të dy ishim në një mendje se disa
nga çastet e ritualit të dasmës ishin me të vërtetë
të këndshme për t'u provuar. Tani ai po e vësh-
tronte nusen nga dritarja nëpërmjet një site mie-
lli. Mirëpo po na dilte e pakëndshme.

Në fillim, nusen e pamë në atë pjesë të rru-
gës që ngjitej lart, mbi murin e oborrit. Ishte me
duvak, hipur në kalë të bardhë. Kafshës, të stër-

vitur posaçërisht për dasma, në shtëpinë e kru-
shkës i kishin lidhur shami edhe në veshin tjetër
dhe tani ngjante me kalë cirku. Prapa vinin bu-
rrat të heshtur dhe, pas tyre, gratë që këndonin.
Vetëm ato këndonin në kthim.

— Edhe krushqit ashtu më duken, — tha
Kondoja, — sikur janë grirë me thika.

— E ke nga rrjeta e sitës, — thashë, — mos
e ngjit te sytë.

— S'dihet kush e ka fajin, — tha ai, — sita
apo sytë. Po dallëndyshet ç'patën?

— Janë trembur nga daullet, Kondo.

Dallëndyshet e reja ishin rrëzuar nga foletë
qysh përpara se të niseshin krushqit dhe kishin
marrë shtëpinë. Disa nga ato, që kishin rënë në
treme dhe në oborr, kishin mundur të fluturonin
deri në dritare. Lola dhe gruaja e togerit i kishin
mbledhur. Po zogjtë nuk dihej sa ishin dhe tani
që daullet binin në oborr, na zuri frika se mos,
padashur, njerëzia i shkelte dallëndyshet me kë-
mbë.

Qyleri sapo ishte bërë gati: ishin hapur arkat
e nuses dhe ishin nxjerrë një pjesë e plaçkave.
Ata që i kishin sjellë arkat ishin vonuar për t'i
shkarkuar nga kali. Gjithë halli kishte qenë te
nyjat e pleksura tepër. Për të fituar kohë (arkat
duhej të shkarkoheshin dhe plaçkat të nxirreshin
në dhomën e dhëndrit përpara se të arrinte vetë
nusja), dikush kishte propozuar të pritëshin lita-
rët. Kondoja kishte pyetur përse ekzistonte bes-
tytnia e litarëve, domethënë përse njerëzit e nu-
ses i pleksnin dhe i shtrëngonin nyjat aq fort. Sa
më të pazgjidhshme nyjat, kishte thënë kafshari,
aq më të pazgjidhshme besohen edhe lidhjet e

çiftit. Kondoja, kushëdi përse, nuk kishte lejuar të priteshin litarët.

Por ne të dyve na duhej tani ta lironim dhomën për nusen. Atij i kishte mbetur sita në dorë, ndërsa mua sqepari. Në qilim ishte kutia e gozhdëve dhe një sharrë me trup metalik. U kisha vënë shpejt e shpejt ndonjë tako këmbëve të arkave, sepse dërrasat e dyshemesë nuk vinin mirë në nivel.

— Ç'ti bëjmë këto rraqe, t'i fshehim nën minder?

— Janë hekura, — tha Kondoja, — dhe hekurat janë të ftohtë, nuk dua t'i kem sonte në dhomë. Po i lëmë matanë.

Ai nxori çelësin dhe hapi derën e dhomës ngjitur, që komunikonte me *qylerin*. Ishte një dhomë shtesë, e ngritur me një xunglaturë muri jashtë truallit të oborrit. Dyshemeja ishte hedhur vetëm përgjysmë dhe suvatimet e brendshme ende nuk kishin përfunduar. E kisha pyetur Kondon dhe ai më kishte thënë se brava e saj kishte vetëm një çelës. Ashtu doli vërtet: kishte vetëm çelësin që mbante Kondoja.

— Dalim, — thashë, — kali i nuses ia mbërriti në oborr.

— Gati jam, Baltazar. — Kondoja u hodhi një krehër gishtërinjsh flokëve dhe pyeti: — Si dukem?

— I paqtë si një shenjt, — qesha.

— Tamam për Shën Anën, — qeshi dhe ai. — Ç'më vjen t'i dal përpara dhe ta puth, — shtoi gjithë seriozitet.

— Shko puthe, — thashë.

Oborri gjëmonte nga daullet dhe nuk e di në i dëgjoi këto fjalë. Por unë e dëgjova mirë kur më

foli përsëri, se po kalonim në kuzhinë që të mos na shihnin përcjellësit e nuses:

— Dil në oborr, Baltazar, të paktën ti të jesh atje. Do të më mbetet peng sikur kali i saj të shkelë ndonjë dallëndyshe.

Që kur kishin ardhur arkat me pajën e Anës dhe derisa erdhi edhe Ana vetë, m'u duk se Kondoja ishte më afër ëndrrës se realitetit.

Nuk dola në oborr, por as kali i nuses nuk shkeli ndonjë dallëndyshe.

Vrasja e dallëndysheve përbënte mëkat të madh në Bardhgolem, ndërsa njeriu, nganjëherë, vritej më lehtë se një zog.

Anën e pamë vetëm pasi ikën përcjellësit e saj. Ajo filloi të nusëronte dhe në dhomë hynë gratë e vajzat. Pastaj hymë edhe unë e Kondoja. Doktor Zhavellon dhe togerin i gjetëm aty. Dhoma mbante erë livandoje dhe uzoje. Doktorin kishte një shishe pa tapë në xhepin e xhaketës.

— Hajde bëj betimin, Kondo, — tha togeri, duke na shkelur syrin. — Shiko sa bukur ka dalë nuse Kristina!

— Ana, — e ndreqi doktori.

Togeri ia hoqi shishen nga xhepi dhe tha:

— Pi për Kristinën! — Mbylli sytë dhe rrëkëlleu një gurmaz të mirë. Pastaj tha: — Mua ma ndalon komanda, si ushtarak revolucionar, që të zë në gojë emrin e Krishtit, por askush s'mund të më ndalojë të zë në gojë emrin e Kristinës.

Ai nxori patllaken dhe u bë gati të qëllonte në tavan për Kristinën. Po doktori ia ndaloi rreptësisht.

— Trembet Ana, — tha ai.

— Pse, dallëndyshe është nusja që të trembet?! — e zuri togeri.

Ndiem turmën e dasmorëve në shpinë dhe doktor Zhavelloja iu kthye atyre i bezdisur:

— Ju lutem shumë, qetësi! Ju e dini se në Bardhgolem nuk ka elektrik për të vënë ventilatorin. Sa më tepër qetësi, aq më pak zagushi.

Ishte takimi i parë i dhëndrit me nusen. Në një çast të tillë, zagushinë nuk mund ta zbuste as ventilatori dhe as qetësia. Turma e dasmorëve prandaj qëndronte aty, e gatshme për shakara. E kisha provuar vetë dy vjet më parë. Isha afruar te nusja dhe e kisha goditur në ballë, tri herë, me gishtin tregues që e shtrëngoja pas bulës së gishtit të madh. Mirëpo me një goditje të tillë në fshat njerëzit provonin edhe bostanin. Paske zgjedhur shalqi të vërtetë, Baltazar, më kishte ngacmuar drupunuesi, i kuq si gjaku do të jetë përbrenda! Ishte një aludim i hapët për virgjërinë e nuses. Megjithëse ime shoqe më dhimbsej, me sa dukej s'e kisha kursyer goditjen dhe balli i saj kishte kërcitur. Po sikur atij tjetrit t'i kishte shkrepur të më thoshte ndryshe?! Për shembull: Paske zgjedhur kungull në vend të shalqirit, Baltazar! Shakatë e rënda... Fishkëllyen tre-katër plumba njëri pas tjetrit dhe pashë vrimat që lanë në tavan. Doktorin ulëriu dhe Kondoja nuk qëlloi më. M'u kujtuan fjalët e tij për Anën: «Trupi i saj më duket gjithë vrima-vrima, Baltazar, sikur ta kenë bërë shoshë me thika.» U gëzova që kishim marrë masa me kohë dhe në tavan nuk kishte përgjues, ndryshe trupi i tij mund të bëhej shoshë nga plumbat.

— Kondoja e ka nga gëzimi, — thashë, — duhet t'ia falësh, doktor.

— Unë e fal, mor bir, por a na fal ai tjetri atje lart?!

Të gjithë pandehëm se doktori po vinte në dyshim qëndrimin tonë para zotit. Po Kondoja, më në fund, e ngjeshi gishtin tregues pas bulës së të madhit dhe iu drejtua nuses:

— Ana, do të të vras!

— Kristinën e ka vrarë zoti një herë, — tha togeri, duke futur në brez revolverin që i dha Kondoja. — Kristinën askush nuk mund ta vrasë më. Kondoja preku ballin e Anës.

— Është e domosdoshme, Baltazar? — pyeti.

Desha ta tërhiqja në çast, po në sy të të tjerëve dhe sidomos të doktorit, që kishte kërkuar qetësi, e zbuta nxitimin:

— Nuk besoj, Kondo.

Kondoja u spraps pa goditur ballin e nuses.

— I hidhni, i hidhni kosit ujë, po dhallë keni për të pirë një ditë, — na mallkoi i pakënaqur doktori. — Lëshimet dihet ku fillojnë, po s'dihet ku të çojnë!

— Në tryezë, Zhavello, — tha togeri. — Dreken mund ta hamë pak përpara, se njerëzit presin *argëtimin e Livadhit*.

Doktori picërroi sytë dhe na pa shtrembër. E kuptova gjestin e tij: po guxonim si tepër!

Natyrisht, ai kishte guxuar më tepër duke vajtur te Qejvan Qejvani. Nuk ishte vetëm Xhemë Kurti që e kishte parë në rrugicën e shtëpisë sime. Edhe të tjerë, që dëshmuuan më vonë, kishin pande-

{M.....
{Sh.....

hur se doktori, për ta nderuar shoqëruesin e të birit, po shkonte t'i ftonte vetë në dasmë njerëzit e shtëpisë sime.

— Erdhe, kodosh?! — ishte habitur Qejvan Qejvani.

— Nuk qenke verbuar krejt, ronxho!

— Fytyrën tënde e shoh, — kishte thënë plaku, — ka ngjyrën e verdhë të vdekjes.

— Ngjyrat i dalluake, po më gëzon, — s'e kishte kursyer fjalën Zhavelloja. — Edhe floriri ka ngjyrë të verdhë, po është i pavdekshëm. Atëherë bëra një gabim me ty, ronxho, të vura në peshore syrin prej xhami, kur dihet se syri fals askujt s'i vlen një kacidhe. Tani jam gati të ta peshoj me flori syrin tjetër, atë të shëndoshin.

Unë e Kondoja ishim në Lagjen e Epërme, kur përgjuesi u ngjit në tavan. Zhavelloja ishte përkujdesur që atij të mos i mungonte asgjë dhe e kishte porositur që, deri të dielën mbrëma, të qëndronte matanë, në tavanin e dhomës së papërfunduar e që ishte ngjitur me atë të dhëndrit.

Askujt s'i kishte vajtur mendja te Qejvan Qejvani, por as nuk mund të thuhet se Zhavelloja s'kishte zgjedhur mirë. Qejvanin e kishte tunduar edhe më parë me monedhat e tij. Pastaj ishte i moshuar dhe përgjimi i një plaku e rëndonte më pak çiftin në sy të të tjerëve. Por ishte edhe qorr me një sy dhe do të mundte të shihte vetëm aq sa duhej.

Megjithatë, njëra nga hollësitë është për t'u vënë re: ndërsa kësaj radhe Zhavelloja po i peshonte syrin e vërtetë, verdhushkat qenë po ato të mëparshmet, të gënjeshtërtat. Dhe sesi më vjen kur mendoj që dëshmia e fundit për Çondën, ajo e

vdekjes së tij, na ka mbetur duke u paguar me para të rreme.

— Kush është ai që na e bën me dorë? — më pyeti Kondoja.

M'u duk se po jetonim përsëri orën e garës së kuajve. Po tani kishim dalë në livadh për argëtimet e pasdites, pasi kishim ngrënë drekën e së dielës.

— Çonda është? — pyeti Kondoja prapë.

— Çonda, — thashë.

— Po pse na e bën me dorë?

— Po përshëndet, — thashë. — Ndoshta do të kthehet në Dardhali. Dasma për të ka mbaruar.

— As ka mbaruar dhe as ka filluar, — tha Kondoja, — ai nuk e gëzoi dasmën e Anës. Por edhe Ana... E dëgjove tët motër?

Kur u kthyen krushqit, Meropi na kishte thënë se Ana kishte qarë me gëlltitje duke hipur në kalë. E kishin ndihmuar të hipte disa kushërinj të largët. Ndërsa në kalë të bardhë nusen duhet ta vinte daja.

— Ajo ka qarë për Çondën, — tha Kondoja. — Ç'na ka gjetur kështu, Baltazar, nuk të duket se asnjëri s'po gëzojmë tamam?! Shko e thuaji Çondës që të mos na e bëjë me dorë.

— Nuk do të ishte e hijshme, — thashë.

— Po nuk duroj dot, — tha Kondoja, — ai përshëndet në një mënyrë të tillë, sikur s'do të shihemi më kurrë.

Nuk luajta nga vendi. Kisha bindjen time se gëzimi i dasmës është i përzier me trishtim. Madje atëherë mendoja se vetëm në Bardhgolem qa-

het nëpër dasma, pasi derdheshin kaq lot, sa ishte njësoj sikur të qante gjysma e botës. Njëra gjysmë qante për shkak të gjysmës tjetër. Martesa bashkonte një palë njerëz e ndante një palë tjetër. Sot nuk e di sa qajnë bota nëpër dasma. Po më duket se të gjithë mendojmë se të mirat e kësaj bote shtohen vetëm nëpërmjet së qeshurës. Mirëpo kur gjithnjë të qeshim dhe kur të harrojmë si qahet, bota të gjitha të mirat do t'i ketë me përjashtim të qumështit. E kam nga nëna ime: një njeri që i thahet gjëndra e lotit, është si një lopë pa gjëndrën e qumështit.

Ana kishte qarë për Çondën, të cilit i ishte ndaluar të shkonte në dasmë për ta vënë mbi shalën e kalit të bardhë. E qara e Anës ishte një nga të mirat e kësaj bote, po kush e dinte e kush e llogariste këtë?! Shushulla që e dinte, kishte qarë edhe vetë. Kondoja, që e merrte me mend, mër-zitej e trishtëhej. Mua më dukej se rreth e qark dëgjoja një të qeshur. Nuk mund ta dëgjoja, sepse trishtimi është një e qeshur pa zë. Ndoshta ata do të qeshnin një ditë tjetër. Kondoja më kishte thënë se, pas dasmës, do të shkonin me Anën në Dardhali dhe do të kalonin disa ditë në shtëpinë e Çondës.

— Aty është akoma? — më pyeti Kondoja.

— Aty, — thashë.

Na kishin shtruar qilimin e ri në livadh, që nusja e kishte sjellë me pajën. Tepronte goxha vend, por asnjë tjetër nuk ishte ulur me dhëndrin e shoqëruesin e tij. Ne ishim shikuesit më të nderuar të atyre garave sportive. Kishte mbaruar trehapëshi, hedhja e gurit dhe vrapimi. Njerëzit e kishin mendjen të djelmohat që do të bënin

mundje dhe që, sipas dëshirës, po ndaheshin në tri duar.

— Pse nuk vete ta takosh dhe t'ia thuash Çondës vetë, — i kujtova Kondos.

— Ç't'i them? — nuk e kapi ai.

— Që do të shkosh në Dardhali me Anën. Ta dijë dhe të gëzojë.

— Po sikur... Baltazar, — pati një ngurrin ai, — shko thuaja ti më mirë.

Brenda një çasti, nganjëherë, njeriu e ndan veten në një mijë grima dhe brenda po atij çasti bëhet përsëri ai që ishte. Kondoja ma hodhi dorën në sup dhe i ndihmoi vetes për t'u ngritur, ndërsa mua për të më mbajtur ngulur në vend. E kuptova pse po ngrihej. Po nisej vetë drejt grupit të njerëzve prej nga Çonda na kishte përshëndetur në atë mënyrë, sikur s'do të shiheshim më kurrë.

— Më doli huq, — tha kur u kthye, — nuk kishte qenë Çonda, po Kristo Kubati. Ai ta bënte ty me dorë. Kam një fjalë me Baltazarin, më tha. Të pret.

— Këtu jemi, e takoj më vonë, — thashë.

Nuk po më dilte kurrkund në hesap përse më donte Kristo Kubati. Për të qenë më afër shtëpisë në kthim, ishim ulur në anën lindore të Livadhit, pa u kujtuar se sa më shumë ulej dielli në perëndim, aq më tepër na vriste sytë.

— E pyeta uratën, — tha Kondoja, — dhe pranoi se plaka e Kubatëve i ka porositur një përshtetje. Ajo nuk mund t'i zgjidhë hallet e kishës me gjeneral Kubatin, prandaj pëlqen më mirë Kriston.

— Përshtirtjen e kanë lënë për nesër në

mëngjes, — thashë, — nuk paskëshin qenë fjalë të kota.

— Edhe ty do të të përcjellim nesër, Baltazar?

Po flisnim për një të vdekur dhe ajo fjala «përcjellje» për mua, mund të mos ishte me vend. Po nuk më bëri ndonjë përshtypje të keqe, mjaft të shkoja në kursin e trajnerëve. Ndeshja e futbollit, që kisha dashur të organizoja atë pasdite, tani më dukej një trill amatorësh. Le që edhe Kubati i vogël, Timoja, ia kishte mbathur me vullnetarët e HIDROELEKTRIKUT.

— A duhet të pres në mëngjes derisa të mbarojnë të gjitha? — pyeta Kondon.

— Çfarë mbetet për në mëngjes?! — u hoq si i paditur ai. Nuk më la t'i përmendja çarçafin në oborr dhe ca zakone të tjera të vogla. — Deri në mëngjes për ty ka mbaruar gjithçka, — tha Kondoja. — Çfarë mbetet, është vetëm në dorën time.

Rrethi i njerëzve po ngushtohej gjithnjë për të vëzhguar mundësit e dorës së dytë. Këta ishin më të fortë nga ata që ishin ndeshur për dorën e tretë. Më të fortët fare ishin ata të dorës së parë. Po për këtë dorë vetëm katër veta kishin vënë kandidaturën.

Kur njëri nga mundësit ra me shpatulla në bar, Kondoja u mbush me frymë. E kishte mendjen ende te mëngjesi i së nesërmes dhe më duket se e kishte marrë vendimin: sido t'i dilte me Anën, çarçafin e natës së parë nuk do ta nxirrte në oborr.

— Takoje Kriston dhe të ikim prej këtu, Baltazar, — tha duke i dhënë kokës prapa. Diku prapa ishte shtëpia e Zhavellove. — Ti do të bëhesh trajner futbollit, io mundieje.

E gjeta Kriston dhe u habita kur e pashë me

një shishe arançate në dorë. Ishte krejt si ajo e uratës, por në ngjyrë tjetër. Ai e tundi dhe ma zgjati.

— Nuk vuaj nga mëlçia që të pi ujë me sheqer, — thashë.

— Është serum tjetër, — ma përmbysi paramendimin Kristoja. E tundi shishen përsëri dhe hodhi një hurbë në pëllëmbë të dorës. Ishte uzo e prerë me ujë. — Mos ma prish, — tha, — ti je shoqërues dhëndri dhe, po nuk pive nga shishja ime, mbetem tërë jetën beqar.

Piva nga shishja e Kristos duke vërejtur si i përndritnin flokët e butë në diellin e fundit. E kishte ndërruar veshjen. Mbante një këmishë fshati, pa jakë dhe vetëm me dy kopsa në gjoksore. Të dyja kopsat i kishte mbërthyer.

— Pse më deshe? — e pyeta.

— Dua të ta them copë, Baltazar. Kur bëhet dasmë në fshat dhe unë nuk jam aty, më duket se gjithë njerëzia më ka kthyer kurrizin. Njerëzit harrojnë se kam qenë më parë partizan dhe vetëm katër-pesë ditë me bashibozukët. . .

— Ka zakone, — thashë, — në dasmë ftohet një njeri për shtëpi.

— Ta vras vëllanë e madh, t'i jap një pas koksës gjeneralit që të vij vetë në dasmë?! . . . Ju po më vini para detyrimesh të rënda.

E ndjeu menjëherë se kishte bërë një shaka fare të palezetshme. Po ilaçin për plagën e tij, prapëseprapë, e kërkoi nga unë.

— C'të bëj, Baltazar?

— Ti mund të vish, — thashë.

— Po si të vij, *bythec*¹ pas tim vëllai?!

1) Ai që shkon mik pas një miku.

— Atë e di ti. Unë nuk mund të ftoj njerëz në dasmën e tjetërkujt.

— Hssss, — i fishkëlleu një mërmërimë mes buzëve, — ordianca nuk qenka në lartësinë e duhur. — Dhe shtoi për Zhavellon: — Nderimet e mia doktorit! I thuaj se pikërisht kur cinguni shtrëngon qesen, i Papjesi merr pjesën e vet.

Këto fjalë i përsëriti edhe në darkë. Po në darkë edhe qeshi shumë, aq sa këdo mund ta gënjente mendja se ai njeri ose nuk merrte asgjë seriozisht ose askush nuk i hynte në sy.

E kishte zakon të grindej duke qeshur, më tha gjeneral Kubati më vonë. Më dukej se, më tepër se me cilindo, im vëlla grindej me veten. Vriste ca si lart, mirëpo i kishte humbur shanset dhe nuk merrej vesh me ndërgegjen e tij se ç'vend duhej t'i jepte vetes në jetë. Ndërsa të tjerët, të tjerët i dukej se gjithmonë i jepnin më pak. Po të mos ua kishte nevojën dhe po të mos e përmbante mendimi se, në fund të fundit, shumë fije të tij vareshin nga ata të tjerët, mund të ishte treguar edhe më i nxituar dhe mund t'ia kishte ngrënë kokën vetes edhe më shpejt. Më duket se pushtetit të turmës i druhej, prandaj mjaftohej me një buzëqeshje qesëndisëse ndaj të tjerëve. Atë natë e prishi balancën dhe e humbi lojën përfundimisht.

Doja të çoja deri në fund bindjen time dhe e pyeta gjeneral Kubatin në mendonte se i vëllai, Kristoja, ia kishte bërë borxh Çondës. Kubati nuk e zuri në gojën emrin e gjeneralit tjetër, po tha vetëm kaq: «Nuk e kisha ditur se im vëlla mund t'i kishte borxh për të mbesën.» Bisedën e bëmë një natë dimri në shtëpinë e Gurbës së Norës. Ka qenë një natë e gjatë, aty kishte edhe burra të

tjerë dhe Nora nxori dy a tri tepsi me rriska kungulli të pjekur.

Në shtëpinë e Kubatëve kisha vajtur dy herë për kryeshëndoshë. Herën e dytë shoqërova doktor Zhavellon dhe Lolën. Gjëma kishte ndodhur në dasmën e djalit të tyre dhe, në këtë rast, ngushëllimi bëhet detyrimisht më i ngarkuar. Gjenerali pinte duhan. Lola nuk fliste. Në dhomë të gjithë heshtnin. Kishte filluar të ngrysej, kur foli doktor Zhavelloja:

— Gjeneral, durimi është ilaçi i ngushëllimit. Të gjithë sa jemi në këtë dhomë, jemi të dënuar me vdekje. Vetëm datën e ekzekutimit nuk e dimë. — Kishte dashur të thoshte se njeriu është i vdekshëm.

Sollën legenin dhe doktori filloi të lante duart. Do të shtrohej buka.

U ktheva te Kondoja që ishte ngritur më këmbë dhe po mblidhte qilimin për t'u larguar nga Livadhi. Në tapetin e barit po ndeshej njëri nga giftet e dorës së parë. Togeri i ndiqte nga afër, duke u përkulur herë në gjunjë e herë në ije. Njëherë, madje, u shtri barkazi për të hetuar në ishte e rregullt ura e mundësit, të cilin kundërshtari e kishte vënë poshtë.

— Është bërë arbitër, — më tha Kondoja. — Im atë ia la atij të përgjigjet edhe për çmimet.

— Togeri di t'u përgjigjet fituesve, — thashë.

— Ç'të deshë Kristoja?

— Hiç, — ia fsheha, — më lajmëroi për Timon, paska vajtur në CENTRALIN HIDROELEKTRIK me vullnetarët.

U afrua Kadri Biba nga Lagjja e Myslimanëve.

— Jam plak dhe s'vij në dasmë, — i tha Kondos, — po dhuratën ta solla. Ky bastun vlen më shumë se një pulë.

— I kujt është? — pyeti Kondoja.

— Ka qenë i Cen Bibës, — tha plaku. — Ke dëgjuar për Cenin e Bibajve?

— Kaçak më të famshëm s'kanë pasur anët tona, — i dha një shpërblim Kondoja. U kthye nga unë e më cyti: — Ti sikur parashikove dhurata për sonte?

— Të paktën, një vitrinë të re për muzeun, — thashë. Ai kishte blerë disa objekte muzeale gjatë gjithë atij viti në fshatrat rreth e qark dhe ndonjëri e thërriste me shaka K. Muzeumi.

Kondoja e mbajti bastunin horizontalisht dhe zuri ta kundronte. Pastaj, me bastunin në dorë, tha befas:

— Përmend qenin, bëj gati shkopin.

Po vinte Kristoja drejt nesh.

Kondos i mbetën peng këto fjalë dhe m'i kujtoi atë ditë kur u ngjitëm përroit deri te Gryka e të Papjesit. I vinte rëndë nga vetja, sepse i dukej që e kishte fyer tinëz tjetrin vetëm pak orë përpara se të vdiste. Dhe kanë qenë, në të gjallë të tij, fjalët e mia të fundit për të, më tha. Ai kishte thënë dhe fjalë të tjera po atë mbrëmje, gjatë darkës, po kishte harruar.

Kristoja s'e kishte me ne, u ndal te një grup aty afër që të fjalosej me nipin e uratës dhe ca moshatarë të tjerë të Timos. Përfshiva qilimin nën sqetull dhe Kondoja vuri bastunin, gjithashtu, nën sqetull.

— Shkojmë, — më tha.

— Në fshatrat tona ka xhevahire më të çmuara se ai bastun, — dëgjuam nga prapa zërin e Kristos.

Menduam përsëri se nuk e kishte me ne dhe u larguam pa kthyer kokën. Po me ne e kishte pasur.

— Pashë gjithandej, — tha Kondoja, — dhe Çondën nuk ma zunë sytë. Nuk di të shoh apo nuk e pe as ti?

— Çfarë nuk është, nuk ka si shihet, — thashë. — Ka të ngjarë të jetë kthyer në Dardhali.

Kondoja ngriti supet: nuk i besohej. Ndosh-ta, sipas tij, Çonda kishte shkak për të qëndruar ende në Bardhgolem.

Gjatë kohës që flisnim për të, Çonda kishte qenë duke pirë kafe në shtëpinë time. Donte të më takonte dhe kishte vajtur atje me shpresë se, pas garave sportive, do të kthehesha në shtëpi për të parë nënën. Nëna e kishte qerasur me raki nga ajo e damixhanit. Ai i kishte thënë se një raki aq e mirë ia vlente të pihej në dasmë, në festë ose në mort. Dhe kishte uruar të pihej në dasmën e Meropit. Pastaj e kishte pyetur nënën se ç'i thoshte mendja asaj, përse doktor Zhavelloja kishte vendosur papritur që dasmën e të birit ta bënte në fshat. A kishte dëgjuar ajo se ç'thoshin bota për këtë shkrepje? Për nënën time unë pas-kësha qenë tërë bota, prandaj ajo, pa ia bërë dy, i qe përgjigjur se biri i saj, Baltazari, nuk e kishte zënë me gojë në shtëpi këtë reng të doktorit. Ç'reng?, ishte ndalur Çonda. Atë të dasmës, pra, ishte vënë në zor nëna ime. A nuk kishte thënë doktori më parë se dasma do të bëhej në qytet,

pastaj e kishte ndërruar? Ndoshta doktori, qysh në fillim, në fshat e ka menduar dasmën, kishte thënë Çonda. Donte t'u ikte dyshimeve të tij dhe më dukej se ishte dreqnuar shumë, më tha nëna më vonë. Por Çonda dinte edhe atë që e ka harruar vetë dreqi dhe kishte ardhur ta bisedonte me ty. Herë-herë, kur fliste, thithte dhëmbë e dhëmballë, sikur halli i fortë t'i kishte hyrë për palcë. Vetëm njëra më dhemb, i kishte thënë sime ëme, por ato tërbojnë njëra-tjetrën. Mezi kishte pranuar të mbushte zgavrën e dhëmballës me një toph pam-buku të ngopur me kolonjë. Nëna i kishte thënë të shkonte te plaka e Kurtëve që t'i bënte barin e rrëshirës, por ai nuk kishte dashur. Është shumë plakë xerahja e Kurtëve që të kujtohet për barin e rrëshirës, kishte thënë. Ia kishte llogaritur vitet duke numëruar breznitë e Kurtëve dhe, me pak gabime, i kishin dhënë njëqind e njëmbëdhjetë vjet. Edhe ora diçka me njëmbëdhjetë ishte: e kishte kaluar gjashtedhjetën ose po i afrohej shtatëpadhjetës, më tha nëna. Ai u ngrit sikur ta kishte thirrur dikush përjashta. Mos u ngut, i thashë, ora e shtëpisë nuk na shkon mirë. Dielli u fik, më tha, dhe nuk ka nevojë për sahat. Nuk më la të dërgoja Meropin për ty. E gjej vetë Baltazarin, tha, tani do të kenë mbaruar garat në Livadh dhe do ta gjej rrugës.

Por ne u kthyem ende pa mbaruar garat. Kur po i afrohem shtëpisë së Zhavellove, Kondoja më tha:

- Nuk di të shoh apo s'e pe as ti?
- Unë e shoh, — thashë.
- Ku? — ktheu kokën ai.
- Në Dardhali, — nuk luajta nga imja.

Të nesërmen, nuk qeshë unë që arrita i pari në fshatin e Çondës. I pari nga të gjithë arriti Xhemë Kurti. Ai u nis natën, menjëherë pas mynxyrës. Gruaja e Çondës lidhi qenin, përpara se të hapte derën e oborrit.

Në të zbardhur të dritës arritën Gurba me opingarin. Gruaja i njihte miqtë e burrit dhe i ngjiti lart, në odën e ndenjjes. Aty gjetën Xhemën që pinte kafe dhe u lehtësuan duke menduar se, të paktën, kishte qenë një tjetër që ia kishte dhënë gruas mandatën. Po kur pinë kafe dhe vetë, u habitën që kafja nuk ishte e hidhur.

Unë u vonova për t'u nisur sa u bë nëna gati për udhë dhe rrugës u vonova prapë. Ajo ecte ngadalë në tatëpjeta, psherëtinte për të vdekurin dhe për veten e saj: i dukej se nuk kishte këmbëngulur për ta mbajtur dhe se Çonda kishte vajtur në gjëmë drejt e nga shtëpia jonë. «Qyqar, të iku nga dora!», më mundonin mua fjalët e doktor Zhavellos.

Kishte lindur dielli kur arritëm, po moti ishte në të prishur dhe, nga lagështia, drita merrte ngjyrën e hirit. Ia lashë torbën me dy shishet nënës dhe e luta të priste pas murit të jashtëm. Ndonëse porta ishte e hapur, në oborr nuk kishte shenja zie. S'e kanë sjellë ende trupin nga qyteti, i thashë nënës. Mirë, u habit ajo, po frymën dihet se nuk ia sjellin më: pse s'kanë filluar ta qajnë të vdekurin?!

Derisa ngjita shkallët, nuk doli njeri për të më pritur. Në çardak u dëgjuan hapat e mi dhe dikush u kollit për të më drejtuar andej. Nuk ishte e vështirë për ta gjetur odën e ndenjjes, nga dera dilte tym duhani.

Fshatarët vendës u shtynë edhe më nga dera, që të mundja të ulesha diku nga kreu. U bëmë gjashtë burra nga Bardhgolemi dhe shtatë a tetë të tjerë nga Dardhaliu. Kisha ndërprerë një bisedë, por nuk e dija cili prej tyre kishte qenë duke folur dhe për çfarë po flitej. Xhemë Kurti tha për mua:

— Baltazari, i biri... — dhe përmendi i biri i kujt isha në Bardhgolem.

Vendësit s'u ndien.

Te dera e odës u duk gruaja e Çondës dhe Xhemë Kurti i dha shenjë me kokë. Ajo m'u afrua me tabaka në dorë. Më erdhi mirë që nuk më njih-te dhe që nuk e dinte se kisha qenë shoqërues i dhëndrit. Derisa e piva kafen, burrat prapë s'u ndien. Pastaj foli njëri nga vendësit:

— Cjapit ia kishin vënë emrin Kalosh. Ishte i madh sa një kalë dhe i frikshëm si një djall.

— I kujt ishte cjapi? — pyeti drupunuesi, kushëriri i Gurbës që erdhi pas meje.

— A duhen më kafe, Xhemë?

— Po, — i tha Xhemë Kurti gruas së Çondës, — një filxhan. — Dhe i dha shenjë me kokë nga drupunuesi.

— Cjapi ka qenë i gjyshit tim, — tha vendësi që e kishin ndërprerë. — Dhe gjyshi im do ta çonte në një dasmë.

Nuk foli më, po priti t'i sillnin kafen mysafirrit të ri. Pastaj priti që edhe ta pinte.

— Ç'është kjo histori e cjapit? — më pyeti drupunuesi.

— Muhabet kot, — thashë. — Dardhalinjte ndihen të detyruar për të na mbajtur me muhabet.

— Unë mendova se do të kishin filluar ta qanin të vdekurin.

— Çondën nuk e kanë sjellë nga qyteti.

— E mirë, — tha drupunuesi, — se mos prit-
tet që atje t'ia sjellin frymën prapë?!

E mora me mend se kishte fjalosur me nënën
time përjashta.

— Kush ia tha i pari? — u interesua për ve-
jushën.

— S'ia ka zënë në gojë njeri akoma, — tha-
shë i tronditur.

— Megjithatë, gruaja e di, — nguli këmbë ai.
— Atë çast që vdes burri, kudo të ndodhet, trarët
e shtëpisë së tij rënkojnë dhe gruaja ka një pan-
dehmë sikur do t'i bjerë çatia mbi kokë.

— Që të shtyjme kohën, nuk ka nevojë për
bestytnitë e nënës sime — thashë, — na mjafton
cjapi.

— Cjapi i dasmës, — më pëshpëriti në vesh
drupunuesi. — Ne jemi tuhafë, Baltazar, në das-
më zakonisht bisedojmë për të vdekurit dhe në
vdekje për dasmat. Një zakon i vjetër fshatarësh.
Thonë se edhe nëpunësve tanë prej fshatrave u
ka mbetur ai zakoni i cuditshëm që në kafene të
merren me punët e zyrës dhe në zyrë me llafet e
kafenesë.

— A duhen më kafe, Xhemë?

Xhemë Kurti hodhi një vështrim rreth e
qark e tha:

— Këtu s'ka mbetur njeri pa kafe, veç teje.
Bëj një kafe për vete dhe hajde pije me ne.

— Piva, — tha gruaja e Çondës, sikur atë
çast të kishte pritur.

Ajo nuk doli më nga dhoma. U ul në zgrip të

karriges, pranë derës dhe mblodhi duart në prehër. Ai që e kishin ndërprerë, nuk provoi të fliste më. Askush nuk po fliste dhe në qetësinë gllabëruese që u vendos, kuptova se edhe loti ka tingullin e tij të veçantë. Gruaja po qante pa zë. Fytyrën e saj e kishte fshehur përgjysmë tymi i duhanit dhe ajo qante heshturazi. Pastaj, befas, pyeti:

— Më bëjnë veshët apo dikush ngashërehet, Xhemë!

Zemërlepuri i Lagjes së Epërme, Gurba i Norës, e kishte lëshuar veten e po qante.

— E dija se hidhëroheshit shumë, — tha gruaja, — prandaj jua mbajta të fshehtë. Por tani nuk mundem ta fsheh: Çonda ka vdekur... Ka vdekur, Xhemë?

Xhema nuk nxori pizgë zëri. Po nuk doli as ndonjë tjetër që t'i thoshte se nuk ishte e vërtetë, dhe ajo brofi e llahtarisur. Karrigia e vjetër kërkëlliti, kurse mua m'u duk se kërcitën eshtrat e saj. Pastaj besova se, vërtet, filluan të gjëmonin gjithë trarët e çatisë. Gruaja ia dha ulërimës në çardak dhe, që nga oborri, iu përgjigj vajtimi i Anës. Posa kishte mbërritur me Kondon, doktor Zhavellon dhe togerin. Nëna ime u ngjit lart me ata.

Të vdekurin e sollën aty nga dreka. Dola me Kondon që të ndihmoja për arkivolin. Binte një rigë shi dhe shkallët ishin bërë të rrëshqitshme. Kur po e ngjithnim nëpër shkallë, Kovaç Kovaçi, që kishte qenë një nga shoqëruesit e të vdekurit, më tha:

— Kujdes, shoqërues i dhëndrit, mos të të rrëshqasë këmba dhe na shpëton Çonda nga duart!

— Çonda na shpëtoi një herë, — tha Xhemë

Kurti, — dhe na shpëtoi të gjithëve. Ta thashë edhe mbrëmë, kur u nise me të vdekurit në qytet.

Bezja e kuqe, me të cilën ishte mbështjellë arkivoli, ishte njomur nga shiu. Bojë ishte, natyrisht, vetëm bojë, po Kondoja më hoqi mënjanë dhe, duke vështruar gishtërinjtë e tij të skuqur, më tha:

— Baltazar, më duket sikur i kam duart me gjak!

Për ta qetësuar sadopak, i tregova gishtërinjtë e mi. Po kur i pashë, u rrëqetha edhe vetë: i kisha gjithë pllanga të kuqe.

Vura Kondon përpara dhe zbritëm përsëri në oborr. Xhemë Kurti na kishte pikasur. Erdhi me një enë ujë dhe një peshqir të bardhë, që e kishte hedhur në njërin sup. Pas i vinin edhe tre e katër të tjerë që kishin nevojë, gjithashtu, të lanin duart. Pak më tej, në strehën e çatisë, po bisedonin dy vendës që, me sa duket, mua dhe Kondon nuk na njihnin. I pari po thoshte:

— Duhani është nëna e të gjitha të këqijave.

Tjetri iu përgjigj:

— Sidoqoftë, nëna nënë mbetet. — Pastaj e shkapërceu bisedën: — Ata të Bardhgolemit kërkuan gjakun e çarçafit dhe gjetën gjakun e arkivoleve. Akoma s'dihet kush e vrau Çondën.

— Doktor! — i thirri të atit Kondoja.

Doktor Zhavelloja doli menjëherë në dritare. Priti që t'i fliste ndokush, po meqë njeri i gjallë nuk i foli, më tha mua:

— Baltazar, të dija njeri me mend, po qenke firifiu! Ngjituni lart, mor bir, të rrimë një copë

herë me Çondën: ai ju ka dashur shumë ty dhe Kondon!

Kondoja nuk e ngriti kokën, u kthye nga Xhemë Kurti dhe i kërkoi duhan.

I lava i fundit duart dhe u afrova te Kondoja. Ai po kollitej, ndërsa sytë i nxirrnin lot. Nuk e pinte duhanin.

— Gratë dinë të qajnë, — tha.

Qanin gjithnjë bashkë gruaja e Çondës dhe Ana. Ai u ngjit lart për t'iu ndodhur Anës pranë.

— S'e pyeta Kovaçin, — i thashë Xhemë Kurtit, — e nisën trupin e Kristos në fshat?

— E pyeta unë, — tha ai. — Ekspertiza kishte mbaruar punë dhe trupat i nisën njëkohësisht.

— Xhemë, bie shi tani në fshatin tonë?

Ai nuk foli, vetëm ndjeva se më çiku me sup. Ishim futur nën strehë dhe qëndronim në këmbë, me kurrizin mbështetur pas murit.

— Po atë vërtet deshën ta pushkatonin atëherë?

— Fjalë kanë qenë. — tha Xhemë Kurti, — dhe s'dihet kush i përhap. Më vonë nuk u vërtetuan.

— Ç'u vërtetua më vonë?

— Ajo që ishte dhe aq sa ishte, — tha Xhemë Kurti.

E shmanga përsëri emrin e Kristos:

— Po si i ndodhi? S'më ka rastisur ta dëgjoj dy herë njëlloj historinë e tij.

— Unë isha në sallën e gjyqit, kur u dënua. Nuk bëri më shumë se një muaj dhe e nxorën nga burgu.

— Si ndodhi atëherë, kur e zunë bashibozukët? — ngulmova.

— E zunë në mulli, — tha Xhemë Kurti, — vajti me një mushkë të merrte miell. Bashibozukët e kishin pisk për vete dhe në Balur çeta e tyre ishte shpërndarë. Vetëm tri apo katër veta mbanin pushkë. Këta e zunë. E pyetën Kriston në ishte partizan dhe ai, për të shpëtuar lëkurën, gënjeu: Nuk jam partizan. Meqë nuk je partizan, i thanë, bëhu me ne. I dhanë një dru të shëndoshë kurrizit dhe e morën me vete. Pas katër-pesë ditëve, ia mbathi. Por kur u kthye, batalioni partizan kishte lëvizur. Ai qëndroi i fshehur në shtëpi dhe vetë e ëma ia mjekoi plagën e pulpës. E kishte marrë një plumb qorr natën, kur po ikte nga ata.

Xhemë Kurti zgjati dorën dhe shoi cigaren në currilin që pikonte nga streha.

— Unë e dija se kjo i kishte ndodhur përpara se të vdiste Kania dhe se, më pas, ai u bashkua përsëri me batalionin.

Xhemë Kurti ndezi cigare tjetër.

— Po ai, — pyeta, — pandehte se atë gjyq e kishte pasur peshqesh nga Çonda?

— Ashtu i thoshte mendja, se dikush e paditi si dezertor. Po Çonda nuk ka pasur gisht në atë gjyq. Çonda ia bëri gjyqin mbrëmë, në dasmë.

Ai më preku përsëri në sup dhe heshti. Nuk e di pse më preku, po ndjeva se nuk donte të shtyheshim më në bisedë. Megjithatë, ngulmova:

— Të kishte shkuar në mend ndonjëherë se Kristoja...

— Çudi është, — më ndërpreu ai, — tani do të gjykohen të vdekurit. Ne do të jemi të dety-

ruar të dëshmojmë përpara hetuesit për atë që ndodhi mbrëmë.

Në pjesën e prapme të oborrit, me sa dukej, kishin filluar përgatitjet për drekën e të vdekurit. Një grua, që doli prej andej duke mbajtur pas ijës një tepsi plot me të përbrendshme bagëtie, u step në shkallë. Dikush po zbriste rrëmbimthi dhe desh ia përmbysi tepsinë. Ne vetëm atë çast u bëmë të vetëdijshtëm dhe njohëm Kondon, i cili u përshkua para nesh i palosur në kryqe dhe me krahët nën bark, si ta kishte të keqen pikërisht në rropullitë e veta. Ai doli thujse kokakëmbëthi nga oborri. E gjetëm prapa murit, po ashtu të kërrusur, duke vjellë lëngjet e stomakut. Na largoi me dorë, se nuk mundte të na fliste dhe nuk donte as ta mbanim. U shkund disa herë, pastaj filloi të fshihej me shami e të gëlltitej. Në oborr na kërkoi të falur.

— S'e di se si më erdhi, — tha. — Morët vesh për Kriston, e kanë kthyer në fshat?

— Baltazar! — dëgjova të më thërrisnin. Ishite doktor Zhavelloja, që na vëzhgonte nga dritarja i shqetësuar për të birin.

— Kriston e kanë kthyer, — i thashë Kondos. Mbetëm dhe një grimë në oborr, nën shiun që po dendësohej.

— Të kam ditur njeri me mend, Baltazar, — tha përsëri doktori, — po qenke vërtet firifiu. Hajdeni pra, këtu kemi Çondën që pret t'i bëjmë nderimet e rundit. Ah, ç'respekt të lartë kam pasur për gjenerafin! — u doganis në dritare.

Xhemë Kurti deshi t'ym për mushkëritë, po cigarja e lagur i qe shuar në buzë. E flaku dhe pështyu. Ai pështyu i neveritur, sikur të ndiente

erë muti. Megjithëse me vonesë, u kujtua për pyetjen që i kisha bërë dhe më tha:

— Besoj se edhe në fshatin tonë bie shi. Të bjerë, Baltazar, vera ka shumë pluhur!

Koha, që të mbrëmshmen, kishte dhënë she-nja për t'u prishur. Një vetëtimë që llapsi në të ngrysur, e detyroi togerin t'i bënte të vëllait një propozim të çastit: Sikur ta shtronim darkën brenda? Doktor Zhavelloja nuk pranoi. Ajo ishte vetëm një fushqetë për dasmën e tim biri, qeshi. Kur bëjnë dasmë njerëzit e mirë, edhe zoti... Togërit, që nuk po i shqitej nga hunda shkumbi i rrufesë, iu dukën fjalë në erë. Megjithatë, nuk ia fishkëlleu më gjatë me fjalë, po u tha grave të mos rrinin në mëdyshje, darka do të shtrohej në oborr, siç dëshironte babai i dhëndrit. Është urdhër i heqimit, tha për Zhavellon tjetër.

Ne të gjithë dëshironim që darkën ta kalonim në oborr, sepse ndiheshim më lirshëm. Shkreptimat erdhën duke u dëgjuar më larg. Pastaj s'u dëgjuan më. Por qielli mbeti i vrenjtur dhe në oborr u shtuan dhe ca llamba të tjera me vajguri. Djemtë e rinj, që ishin caktuar për të shërbyer, filluan ta bënë punën sahat.

Tani më duhet t'i mbyll sytë një çast, që të mundem të shoh gjithçka e të gjithë njëherësh. Me sytë hapur mund të shohësh vetëm çfarë të del përpara. Anën, për shembull, nuk do të mundja ta shihja. Ajo ishte në *qyler*, në dhomën e saj e të dhëndrit. Nusja nuk rrinte me dasmorët në darkën e së dielës. Kondoja ishte i kënaqur që Ana do të hante në *qyler*. Këtu do të nusëronte si ku-

kull, më tha, kurse ajo është lodhur duke nusëruar tërë ditën dhe ka qarë shumë.

Po, Anën e shoh duke qarë. Ndoshta edhe atë çast, ndërsa priste Kondon në shoqërinë e një gruaje, qante nga pak. E ndieja veten si të më kishin mbyllur në një shishe manikyri, më tha kur e pyeta më vonë. E kishte trazuar gjithë ajo ngjyrë e kuqerremtë në *qyler*.

Kuptohet, unë isha ulur në tryezën kryesore. Doktorin me Lolën na kishin vënë në mes mua dhe Kondon. Pastaj vinte togeri me të shoqen dhe me kunatin e tij, të vëllanë e Katerinës. Pastaj të tjerë që i kam përmendur me emër dhe të tjerë që nuk i kam përmendur. Por të gjithë më duket sikur i shoh. Oborri ishte rreth e qark me tryeza. Edhe në pjesën e ngritur me tarracë, në krahun e xhadesë që dilte sipër murit, ishte vënë një tryezë e gjatë. Atje do të uleshin ata që vinin pa u ftuar. Por, për t'ua bërë pakëz më të lehtë, togeri uli qysh në fillim edhe disa nga të ftuarit. Hierarkia nuk më pëlqen në dasmë, ndërsa në ushtri është punë tjetër, më tha mua, i kënaqur që kisha qenë në një mendje me të. Këtu ka vetëm një mbret dhe një mbretëreshë, dhëndri me nusen. Ka dhe një adjutant të mbretit: shoqëruesi i dhëndrit. Të tjerët janë popull, tha togeri. I urova që, me rastin e **FESTËS SË USHTRISË**, të gradohej kapiten. Për të parë njëri-tjetrin, na duhej të përkuleshim përpara ose prapa, se kishim Lolën në mes. Ajo i kishte bërë flokët gjithë bukle me mashë të nxehtë. Mot, tha togeri, se sivjet **FESTA E USHTRISË** ka ditë që ka kaluar dhe u gradua kush kishte për t'u graduar, por ti nuk e lexon gazetën për të martë. I thashë se ga-

zeta e së martës qenka vërtet gazepi im. Por ai nuk më dëgjoi, se po mbushte revolverin. Qëlloi në hava gjysmë karikatori për nder të FESTËS SË USHTRISË, ndonëse ajo kishte kaluar. Qëlluan edhe më tej, në një tryezë tjetër dhe thanë se, ashtu si togeri, e kishin për nder të çiftit. Nuk ishin marrë vesh.

— Më vjen keq që fotografi nuk e mbajti fjalën dhe u kthye në qytet, — më tha Kondoja. — Me Anën do të bëj fotografi pas dasmës.

— Sonte mos pi shumë, — thashë.

— Dëshiroja të kisha fotografi edhe me ty, Baltazar, — tha Kondoja. — Dhe mos harro se kemi lindur në një natë, natën që dha shfaqje ai klouni në fshatin tonë. Je binjaku im.

— Togerit sapo më quajti adjutanti yt, — qesha. — Kurse Kristo Kubati zgjodhi një fjalë tjetër: ordinancë.

Ai më ra me gju poshtë tryezës. Foli duke e drejtuar vështrimin gjetiu.

— Përmende qenin, bëj gati shkopin.

Drejt tryezës sonë po vinte Kristo Kubati.

Kondoja gjithnjë ka ngulur këmbë se këto fjalë të rënda i tha në Livadh, pasi i dhuruan atë bastunin për muzeun. Por, siç do ta kuptoja shpejt, ai ngatërronte edhe ca hollësira të tjera. Për she-mbull, kur në shtëpinë e Çondës së vdekur doktor Zhavelloja doli për herë të dytë në dritare dhe më tha mua (i binte pragut për të dëgjuar i biri) që të ngjiteshim lart për t'i bërë nderimet e fundit gjeneralit, Kondos sikur i hodhën ujë të përvëlur. «Doktor, — i thirri të atit, — vetëm je apo me përgjues?» «Ç'përgjues, mor bir?!» — u hoq sikur s'e kapi Zhavelloja. «Qejvan Qejvanin, pra! Ti kuj-

toje se, meqë i kishte ngelur vetëm një sy, nuk duhej t'i kishte ngelur asnjë dhëmb?.. Por po del ndryshe: tani që i iku edhe syri tjetër, është be-tuar se ty do të të hajë për së gjalli. Dhe po të hëngri, s'kam si t'i kërkoj as gjakun! Ata që ia hapën baxhën, thonë se qenka ankuar për zotë-rinë tënde: e ke paguar me kallpe. Ç'do të bënte qorri ditë e natë në tavan, veçse të provonte me dhëmbë floririn tënd?!» Ia kujtova Kondos, më pas, këtë skenë dhe ai më kundërshtoi. Nuk ndo-dhi në oborrin e shtëpisë së Çondës, më tha, po rrugës ndërsa venim në Dardhali. Unë nuk e bëra rrugën me ty, i thashë, në Dardhali vajta me ti-me ëmë. Ai ngeci.

Kristo Kubati u afrua te të zotët e shtëpisë dhe u bëri urime për dasmën.

— Më kishte marrë malli të këndoja, doktor. Dhuratën time do të ta jap më vonë, — i tha Kondos.

M'u duk se në tryezën ngjitur me tonën, Ku-bat Kubati u ndie ngushtë. Nuk e kishte pritur ardhjen e të vëllait.

Doktori e mirëseardhi Kriston, por nuk e di se çfarë dyzoi nën zë. Kristo Kubati ishte veshur përsëri me këmishë pëlhure, me gjoksore të qën-disur, po kopsat të gjitha i kishte mbërthyer, madje edhe ato të dorezave të mëngëve. Në kash-tën e flokëve i shndrisnin si sumbulla vese piklat e kolonjës. Sapo kishte dalë nga shtëpia ime, i po-hoi hetuesit berberi i fshatit. Erdhi të kërkonte kolonjë tjetër, se nuk i kishte pëlqyer livandoja e vet, u spërkat dhe nuk deshi të krihej më. Nga-që ma dha dorën me përtesë dhe supet i mbante si të ngrira, m'u bë se trupin e kishte gjithë plagë.

Kristo Kubati nuk tha asnjë fjalë të tepërt përpara nesh. Përshëndeti edhe një herë doktorin me dinjitet dhe vajti vetë në tryezën e tarracës. Kishte një ecje pak të ngathtësuar, po mendova se e bënte për t'i dhënë më rëndësi vetes dhe tjetër gjë nuk futa në hesap. Për të treguar se ishte i kënaqur në vendin që kishte zënë apo për të falënderuar që nuk u ndodh vetëm atje, me t'u ulur përshëndeti Kondon nga larg, duke i treguar gotën. Pastaj u bë zemërgjerë, e harroi ftohtësinë që kishte shfaqur në Livadh ndaj meje e më përshëndeti edhe mua.

— S'është njeri i keq, — tha Kondoja, — po ndoshta është e keqja e vetes.

Nuk iu përgjigja. Ishte disi i mallëngjyer dhe fjalët e tij m'u dukën të dëgjua nëpër fshat.

Doktori thirri një nga djemtë që shërbenin dhe e urdhëroi ta ndërronin rakinë në tryezën e tarracës.

— Rakia që kemi vënë atje është shpirtë e gjallë, — tha. — Kurse unë nuk dua njerëz të dejshëm në dasmë.

Pastaj mbushi gotën dhe iu përgjigj urimit që po i bënte Xhemë Kurti.

U afruam te shkallët dhe Xhemë Kurti filloi të ngjitej i pari.

— Po të kesh helm me doktorin, duro ta zbrazësh në shtëpinë tënde, — i tha Kondos, që sapo kishte vjellë prapa murit. — I vdekuri ka veshë sa është pa u kallur në varr, pse t'i marrë vesh të gjitha?!

— Makar të kishte t'i merrte vesh, — pshe-rëtiu Kondoja.

— Nuk i hyjnë në punë, sepse nuk mundet të ngrihet më, — tha Xhema. — Po të mundnin të ngriheshin të vdekurit, kushedi sa të gjallë do të ndiheshin fajtorë.

Dikush tha se gruaja e Çondës po na priste në kuzhinë. Gjetëm atje edhe Gurbën e Norës. Nora kishte vënë një sharp të zi mbi flokë, po ishte prej leshi dhe duket ia zambullonte kokën.

— A do të vijë e motra? Më erdhi rëndë ta pyesja Anën, — tha gruaja e Çondës.

Mua nuk më binte të përgjigjesha. As Xhema nuk u ngut të fliste, por u pajtua me Kondon.

— Shushulla ka për të ardhur, — tha Kondoja.

Pas pak, kaluam në dhomën tjetër. Gruaja e Çondës u ul pranë kokës së të vdekurit dhe filloi ta qante. I tha atij se motra do t'i vinte, se ajo e kishte vendin aty, te koka e tij, dhe se, posa të vinte, Shushulla do t'i binte të vëllait përsipër duke vajtuar.

Pasdite, kur afroi ora e varrimit dhe Shushulla nuk po dukej, të gjithë ne u vumë në zor të madh. Gruaja e Çondës na takoi përsëri.

— A do të vijë ime kunatë? Unë e pyeta Anën, por ajo nuk pranon të flasë dhe vetëm qan.

— Po, — tha Kondoja, — ka për të ardhur.

Ne të tjerët prapë nuk folëm, por njëjloj u pajtuam me Kondon: si mund të bëjë pa ardhur motra për vëllanë?!

Kur e ngritëm arkivolin në supe dhe dolëm nga shtëpia, m'u kujtuan fjalët që Çonda më kishte thënë të mbrëmshmen: «Baltazar, rrugën do ta bëjmë bashkë.» Mirëpo nuk po shkonim në

qytet, po në varreza dhe m'u duk vetja gjysmë i vdekur.

Rrugës binte shi dhe në varreza kishte baltë, sikur gjithçka atje të ishte kalbur. Akaciet ishin plot me gjethe dhe vile të bardha që i shkoklonte era.

Përpara se të zbrisnim arkivolin në gropë, gruaja e Çondës pyeti edhe një herë:

— A do të vijë Shushulla?

— U vonua, — tha Kondoja, — por ka për të ardhur patjetër. Megjithatë, varri nuk mund të rrijë i hapur.

Filluam ta mbulonim, ndërsa shiu binte me rrebesh. Secili filloi gjithashtu të justifikonte mungesën e Shushullës. Por kur u dëgjua ulërима e saj, m'u duk se të gjithë kishin qenë të sigurt që ajo do të vinte.

E si të mos vinte edhe Çonda në dasmë për vajzën e Shushullës?!

Sapo e pamë, u ktheva nga Kondoja dhe Kondoja u kthye nga unë. Kot më së koti kishim bërë hamendje të ndryshme. Mendova se po ash-tu, heshturazi, të gjithë e kishim marrë me mend ardhjen e tij. E di se po gëzohem, Baltazar?, më tha Kondoja dhe u ngrit për t'i dalë përpara. Por doktori e zuri nga dora me takt:

— Dale, mor bir, — tha. — Deri më sot, nje-rëzia ka vuajtur nga trutë, po nuk di të jetë ankuar nga shalët! Ata që vijnë, i kanë shalët me vete e mund të afrohen vetë.

Dhe, vërtet, u duk se Çonda po drejtohej nga tryeza jonë, e cila ishte vendosur në atë mënyrë

që ta zotëronte oborrin. Ai mbante po ato rroba të reja, setrën me jakë të ngushtë dhe pantallonat me kallca. Kondoja ishte ende në këmbë, kur Çonda u ndal si ta kishte tërhequr dikush prapa nga xhaketa. Për herë të parë u kujtova për fjalën «jashtëzakonisht». Ajo vjen nga dy fjalë të tjera: *jashtë zakonit*. Si daja i nuses, Çonda ishte *jashtë zakonit* të dielën mbrëma te dhëndri, prandaj dhe jashtëzakonisht i sëkëlldisur. E kishte sjellë dhembja për Anën aty dhe të gjitha i kishte marrë në sy. Po të gjitha nuk mund të gëlltiten menjëherë. U step dhe i drejtoi krushkut, prej atje, një përshëndetje me dorë në zemër: «Të trashëgoheh, doktor!»

— Eja, Çonda, vendi yt lart ka qenë gjithmonë. Në këtë pope oborri e ndien veten si në stan, megjithëse ty ndoshta të duket stan me lepuj!...

U kthye andej nga i flisnin dhe pa Kristo Kubatin që po e sodiste. I thirrën njëherësh edhe Xhemë Kurti, edhe opingari, por ai shkoi e ul në tryezën e tarracës. Dhe kur vajta për ta marrë, nuk pranoi të lëvizte. E dinte se, në çdo dasmë, shtrohej një tryezë për ata që mund të vinin pa ftuar. Jam mirë, më tha, guri dhe njeriu ndihen mirë në vendin e tyre. Atë që do t'ia pija Kondos në tavernën e qytetit, po e pi sonte këtu. Kishte marrë vesh nga nëna ime se të nesërmen në mëngjes unë nisesha për në qytet dhe më tha se do ta bënim rrugën bashkë.

Kur kishte dalë nga shtëpia ime, ishte kandidur të vinte për dhëmballën te xherahja e Kurtëve. Ajo i kishte bërë barin e rrëshirës dhe ai ishte detyruar të rrinte atje një copë herë, do-

methënë dy seanca bari. Nga ana e ënjtur faqja i qe nxirë pakëz dhe nën mjekër i dukej ende she-nja e shtrëngimit të shamisë. M'u bë sikur po e shihja plakën e Kurtëve duke ia lidhur nofullat me shami, siç u lidhen të vdekurve.

Vajta te Kondoja dhe i tregova për sa biseduam me Çondën.

— Do ta kenë ftuar në qytet për ndonjë ceremoni, — u kujtua Kondoja, — prandaj mund ta bëni rrugën bashkë. Edhe gjeneral Kubati kishte ftesë.

— Ai nuk më zuri në gojë ndonjë ftesë. Ndoshta mendon se do t'i bie me këmbë deri në Dardhali, sepse atje e kam më lehtë të gjej makinë.

— Ka kohë, — tha Kondoja, — kemi një natë të tërë përpara.

— Është nata jote, — qesha.

— Imja dhe e Shën Anës, — qeshi i kënaqur edhe ai. — Anën e ke kujdes vetë, binjaku im kloun.

— S'i mungon gjë, — thashë, — por po vete ta takoj prapë. T'i them gjë për Çondën?

— Jo, — ma ndaloi Kondoja, — do ta kishte më të rëndë po ta dinte se është në oborr dhe ajo s'mund ta takojë. Kushedi si mund të vijë rasti dhe e takojmë sonte, pa e marrë vesh të tjerët.

U nisa tek Ana, po në treme dhashë porosi që tryezës së të paftuarve t'u shërbehej sa më mirë. Ata djemtë e rinj mezi më dëgjuan nga tamtamet e daulleve. Pasuan nja dyt-tri të shtëna dhe nuk i njoha në ishin nga municioni i togerit apo nga ai i dasmorëve të tjerë. Por më erdhi gjynah për dallëndyshët. Kishin nxjerrë kokat të trembura dhe nga foletë e tyre binte pluhur vazhdimisht. Erdha

të të shoh, i thashë Anës. Pandeha se ishte Kondoja, tha ajo. Kondoja do të vijë kur t'i jepet leja, qesha. Ke ngrënë ndopak? Anës i është prerë oreksi, tha gruaja që e shoqëronte, të gjithë janë mbledhur enkas e hanë për të, kurse kjo vetë nuk ha. Nusen e hanë në dasmë, tha gruaja, e hanë me sy.

Kush e ha nusen në dasmë?, pyeta gruan. Syri i keq, u mbrojt ajo. M'u kujtua hëna e ngrënë dhe nuk dija çfarë të thosha. Duke dalë, ngrita fitilat e llambave. Në treme fishkëllenin mushkornjat. Daullet kishin pushuar, ndërsa në tryezën e tarracës po qeshnin. Kristo Kubati po pyeste se sa lloje zogjsh ekzistojnë. Çonda e kishte mbyllur njërin sy. Gropëzat e fytyrës ia mbulonte jaka e këmbës, unë i shihja vetëm fikthin dhe fikthi më dukej se i lëvizte.

Sipas shijes së atyre që shërbenin, në mes të pijes njerëzit duhej të mbathnin stomakun me çorbë. Derisa vajta te tryeza jonë, kishin mbërritur atje edhe pjatat, edhe pyetja për llojet e zogjve. Doktor Zhavelloja po fliste për një zog të rrallë në Azinë Juglindore.

— Jeton nëpër shpella, — tha doktori, — dhe pështyma është elementi i tij më i kushtueshëm. Nuk e paguan dot as me flori! Pështymën e lëshon fije-fije dhe, me ato fije të thara, bëhet një supë e klasit të parë.

— Doktor, po na pështyn në çorbë, — u neverit kunati i togerit.

Unë mbarova pjatën time. Çorba e togerit u ftoh dhe Kondoja e uli pjatën në tokë; ia dha për ta lëpirë një qengji që u vërtitej njerëzve ndër këmbë. Ku qenka togeri?, pyeta. Për ty u ngrit, tha Kondoja, nuk u takuat? Mendova se dikush

do ta kishte hapur derën e plevicës, përderisa kishte dalë qengji.

Togerin e gjeta në plevicë duke u freskuar me ujë të ndenjtur. Ishte zhveshur nga mësi e sipër dhe lahej pa sapun.

— Të të hedh ujë dhe ty? — më pyeti.

— Nuk dua, — thashë.

— Po me revole nuk do të shtiesh?

— Jo, — thashë.

— E kam gjakun të ëmbël, Baltazar, më grinë mushkonjat. Por edhe zagushia bën të sajën, — u ankua.

Kopsiti këmishën dhe i uli deri në fund mëngët e shpërvjela. Kanotiere nuk kishte veshur.

— Ti vajte te Çonda, — më tha, — kishte armë me vete?

— Sa njerëz kanë armë këtu, toger! Bjeri shkurt, ku e ke hallin?

— Nuk më pëlqen që janë bashkë me Kriston, — tha togeri, — ata të dy nuk shkojnë. Si s'u kujtuam të digjnim ca bajga për mushkonjat?! Çfarë zagushie! — u ankua prapë.

S'e mora vesh në fliste për zagushi apo për angështi. Mua m'u shtua njëfarë angështie që, deri atëherë, nuk kisha dashur t'ia pohoja vetes. Më hipi më keq se nuk po e merrja vesh as përse më kishte thirrur në të vërtetë togeri. Njeriu, ndoshka, s'e kupton gjithnjë se cila nga ndjenjat bëhet zotëruese në një çast. Togerin tha:

— Ekstra fare, mjafton të martohet njëri që njëqind të bëjnë dasmë. Sonte më duket sikur është edhe dasma ime, Baltazar, prandaj e teprava me revole. Kur jam martuar unë, as kam shtënë me armë, as kam bërë dasmë.

— Si s'ke bërë dasmë, — thashë. — Në këtë oborr kemi kënduar.

— Kemi kënduar për Katerinën, por jo kur u martova me Kristinën, — tha ai. Nuk psherëtiu dhe nuk i mbylli sytë. Po duket se e shihte atë që tregonte, sepse filloi të rregullonte kapakët e xhepave të këmishës. — E di se xhepi bosh nganjëherë vlen më shumë se xhepi plot?... Kisha dalë me Kristinën, Baltazar, dhe po vërtiteshim nga Kulla e Sahatit në Tiranë. E dinim që diçka na kishte ndezur për njëri-tjetrin, po s'e kishim biseduar dhe ajo ishte nata e parë që dilnim bashkë. Bënte ftohtë, unë isha i detyruar që, herë pas here, t'i nxirrja duart nga xhepi i palltos për të nderuar ushtarakisht. Nuk u lodhe?, më pyeti Kristina. U lodha, thashë, por... Nuk përmbysët botë po ta shkelim rregulloren, tha ajo. E kisha në të mëngjër dhe më doli në të djathtën time. Kur po afrohej një graduat, Kristina më futi krahun. Unë u tremba. S'qenke gjë, toger, tha ajo. Ç'gradë ka ushtaraku që po vjen? Major, thashë. Kush është më lart, pyeti ajo, major apo toger? Major, thashë. Nuk kisha si ta ngrija krahun dhe kalova pa e nderuar eprorin. Por prapë isha i trembur. Po të jepeshin grada për trimëri, unë do të meritoja menjëherë gradën e kapitenit, tha Kristina dhe futi dorën në xhepin tim. Pastaj e mbajti hapin dhe, me dorën tjetër, më ngriti palën e palltos. Në atë anë astari i xhepit ishte fërtele. Pëllëmba e saj kishte kaluar lirisht, ndërsa imja ishte edhe më poshtë. Duke parë duart tona të bashkuara, Kristina qeshi. Nuk ka shumë që ka mbaruar lufta, tha, por bota e ka ngritur tashmë çatinë e re. Kurse dashnorët po njëlloj, ata kurrë

s'kanë pasur çati mbi kokë. Pastaj e lëshoi kindin e palltos dhe ndjeva se po shtrëngonte gishtërinjtë e mi.

Befas, ai filloi të qeshte dhe unë u zëmërova me togerin.

— Pse bëhesh kalama, — thashë, — ç'të hipi kështu?!

— Si të mos qesh, Baltazar! Rrugës, kur po ia shtrëngoja dorën edhe unë, më gradoi kapiten, sepse kujtonte që grada e kapitenit është më lart nga e majorit. Do të më gradonte kapiten, po të mos e kisha xhepin të shpuar?!

E lashë të qeshte. Nga gazi iu mbushën sytë me lot dhe unë mendova se ishte hera e parë që, në njëfarë mënyre, qante për Kristinën. Të nesërmen, në Dardhali, më kërkoi të falur. Kishim varrosur Çondën, ai rrinte nën shkallën e shtëpisë dhe nuk pranonte të ngjitej lart për drekën e të vdekurit. U habita kur e pashë të ngashërehej, sepse togeri nuk kishte qarë as në vdekjen e Kristinës. Qaj për veten time, më tha, dhe e kam nga inati se u tregova vërtet kalama. Po të mos isha marrë aq shumë me atë veremlien e shkretë, nuk do të harroja përse të kisha thirrur në plevicë. Unë doja të këshillohesha me ty se si ta hiqnim Çondën nga tryeza e Kristos.

Kur dola nga plevica, megjithatë, unë vajta vetë drejt e te Çonda. Po në tryezën e tarracës tani kishte ndodhur një ndryshim: në krah të Çondës rrinte Gurba i Norës. Dikush e kishte dërguar në atë tryezë. Ndoshta opingari ose Xhemë Kurti. Që në fillim, ata i kishin ulur në tryezën kryesore, në atë të dhëndrit, ku ishte edhe gjene-

ral Kubati. Nuk mund të ngriheshin vetë, se binin në sy për keq.

— Baltazar, — m'u drejtua Kristoja, — kam bërë një pyetje, po s'm'u përgjigj njeri. Sa lloj zogjsh ka?

Çondës i fërgëlluan qerpikët e atij syrit që e mbante të mbyllur, sikur në gropë të mos kishte kokërdhokun, po ndonjë zog të vogël. Punë zogjsh, thashë me vete, nuk ka pse të trazohet.

— Ç'do të thuash me zogjtë ti? — e pyeti Kriston Gurba.

— Atë që dua të them, frikën s'ia kam kujt dhe askush s'mund të ma mbyllë gojën.

— Baltazar, mos të shaftë i shari dhe mos të ngacmoftë i ngacmuari, — tha Gurba. Dhe, për t'ia mbyllur gojën Kristos, lëshoi një mufkë: — Pse erdhe në dasmë, ti nuk ishe i ftuar?

— Se mos vetëm unë! Këtu ka dhe të tjerë të pafuar, — ia priti Kristoja.

Çonda hapi përgjysmë syrin me kapak të rrëzuar dhe unë pashë ata damarët e hollë të gjakut. M'u ngulit në kokë sikur, me atë sy, Çonda shihte në oborr vetëm njolla të kuqe. Nuk ishin njolla të kuqe, po fitilat e ndezur të llambave. Llamba me vajguri kishte gjithandej, në tryeza, në kamaret e mureve dhe disa i kishin varur edhe në shtyllat e hardhisë.

U dëgjua blegërima e qengjit që i ishte afruar tarracës.

— Nuk ka ndodhur kund që në dasmë njerëzia të rrijë me gojën kyçur. Për zogjtë qenka e ndaluar, po për qengjat lejohet të flasësh? — qeshi Kristoja.

Më erdhi mirë që po qeshte dhe, meqë isha

sjellë disi rëndë me të, e lavdërova për garën e kuajve dhe për qengjin që kishte fituar. U bë imi, tha, dhe askush s'mund të ma marrë! Ta mori urata, e kujtova. Jo, tha, vajta deri të shtëpia e priftit, por pastaj u pendova. Në u bëftë nesër pëshpirtja për babanë tim, ta dini se uratën e kam paguar me para në dorë. Qengjin nuk e dhashë.

Pas pak, filloi të tregonte se si i kishte ndodhur një fshatari nga Borja me qengjin e tij. E përmendi me emër e mbiemër atë fshatarin dhe tha se ishte puna jonë në e besonim apo jo çfarë kishte ngjarë.

Njëherë, fshatari po kalonte përmes pyllit të mështeknave me një qengj dhe dikush ia preu rrugën. A nuk ma jep mua qengjin? E kam për vete, tha fshatari, po ty nuk po të njoh, kush je? Ai që u ka në dorë shpirtin njerëzve dhe çdo gjëje të gjallë, u përgjigj tjetri, jam Xhebraili. Po shpirtin tim ku e ke?, e pyeti fshatari. Atje ku mbahen, tha Xhebraili, me shpirtraf e tjerë. Fshatari e luti që ta merrte me vete për t'ia treguar. Xhebraili nuk deshi, i tha se rruga ishte shumë e largët, po pastaj u nisën. Më në fund, fshatari pa një mjegull tejteje dhe, duke u afruar, kuptoi se vendi ishte plot me drita të zbehta. U çudit dhe pyeti se ç'ishin ato drita. Kandila, u përgjigj Xhebraili, çdo kandil është një shpirt. Fshatari shtrëngoi këmbët e qengjit që mbante në zverk dhe...

E po, muhabet qengjash e kandilash, thashë përsëri me vete, Çonda nuk ka pse të trazohet: edhe oborri ynë është plot me kandila.

U ngrita për të vajtur në tryezën e dhëndrit, se më duhej t'i bëja shoqëri Kondos. Andej-këtej,

prapa tryezave, rrinin në këmbë djem e vajza të reja që hynin në valle herë pas here. Në një anë pashë atë zullapin e sime motre dhe, pak më tutje, vetë Meropin. M'u kujtuan fjalët e togerit se njëri martohet dhe njëqind bëjnë dasmë. Ndoshta ata të dy, me mend, bënë gjithashtu dasmën e tyre. Megjithatë, u përkula pas kurrizit të gjeneral Kubatit dhe e pyeta se si mund të bënim për t'ia ndërruar tryezën Kristos. Unë jam vëllai i tij i madh, tha ai, dhe mund ta urdhëroj të ngrihet prej atje. Po në qoftë se nuk pranon, s'më mbetet veçse t'i jap një dackë turinjve. Kam frikë se ju prish dasmën, po ta kërkon këtë prej meje, tha shumë i vrerosur gjenerali. I thashë se ishte thjesht mendimi im dhe u ula pranë Kondos.

Nuk kishte qenë daja i nuses, po vetë Kondoja që shihte njolla të kuqe në oborr.

— Më duket sikur të gjithë këta burra që pinë sonte këtu janë mbledhur për gjakun e nuses, — më tha. — Kurse unë, pikërisht se e di këtë, ka mundësi të mos mundem të bie sonte me Anën. Burrave edhe u ndodhin frenime emocionale, Baltazar. Nuk çaj kokën nga të tjerët, por më erdhi një amanet nga Çonda. Ma solli Xhemë Kurti.

— Ç'amanet? — pyeta.

— Çonda kërkon që nesër në mëngjes çarçafi të nxirret patjetër në oborr. Nuk i duron fjalët që janë hapur në fshat dhe nuk duron sidomos dyshimet e tim eti. Një copë leckë u mbyll gojën të tjerëve, thotë.

Kubat Kubati u përpoq të ndërronte shprehjen e vrerosur të fytyrës, kur u ngrit për t'u bërë urimet e fundit dhëndrit dhe të zotit të shtëpisë.

I bëri të ditur doktorit se nuk mund të rrinte më gjatë, pasi të nesërmen ishte për rrugë. Ndërsa po largohej, e dëgjuam të gjithë që i tha të vëllait: «Nuk po ia vë llozin derës së jashtme.» Dhe kjo ishte një lloj si t'i thoshte: «Pirdhu prej këtu sa më parë dhe eja të mblidhesh në shtëpinë tënde!» Kristoja u skuq në fytyrë. Brenda një grimë here piu dy-tri gota. Pastaj mbushi gotën përsëri dhe u ngrit në këmbë.

— Doktor, — i bëri zë Zhavellos, — në kam ardhur këtu pa u ftuar, të kërkoj të falur. Po tani që erdha, në më fyen njeri, nuk ta fal. — E zbrazti gotën përgjysmë dhe tha se pinte për gjeneralin.

— Cilin gjeneral? — i dogji Gurbës.

— Bota ka shumë gjeneralë, po të gjithë e dini se cili është im vëlla. Pi për zotin Kubati, — tha Kristoja. — Si të mos i jem atij mirënjohës?! Sa herë më duhet tani të shkruaj ndonjë kartë për biografinë, shënoj se vëllai im ka qenë partizan i vjetër. Ndërsa ai shënon se vëllai i tij ka qenë ca ditë me bashibozukët. E kujt i doli më mirë, vëllait të madh apo të voglit? Të voglit, natyrisht, po nga i madhi ama! Të gjitha të mirat dhe të gjitha të këqijat nga të mëdhenjtë i kanë ardhur kësaj bote. Ata vërtet lindin me këmishë, po kjo s'do të thotë se edhe fëmijët s'kanë këmishën e tyre. — Kristo Kubati qeshi dhe puploi me gishtërinj këmishën e vet. Qeshën edhe disa nga dasmorët. Pastaj ai vazhdoi, duke pupluar këmishën: — Doktor, unë nuk jam prej hekuri dhe s'dua t'ia prish dasmën askujt. Po dhe vetmia më ka lodhur e nuk duroj që të tjerët të më shohin shtrembër. Ne jemi njerëz dhe, nganjëherë, fati vendos mbi ne. Pi për shëndetin e Zhavellove!

— Karagjozi, — murmuriti Kondoja dhe ngriti gotën sa për dukje. — S'e marr vesh, si e duron im atë!

Doktori iu përgjigj me një gotë për shëndetin e të pranishmëve. Të gjithë sa janë këtu, janë të mirëpritur. Sidoqoftë, dasma ka dhe rregulla të tjera, tha ai, dhe rregullat do të zbatohen deri në fund.

— Ç'do të thuash? — i dogji Gurbës atje, në tryezën e tarracës. Ai u ngrit dhe iu drejtua doktorit.

Çonda e zuri për mënge dhe e uli në vend.

— Ç'më plasi! — i thashë Kondos për Gurbën.

Pashë Xhemë Kurtin që u kthye nga opingari. Ndoshta edhe ata ishin të pakënaqur me Gurbën.

U tërhoqa në treme dhe i çova fjalë edhe Gurbës. I thashë se nuk e kishin dërguar atje që të kërcente si zorra në prush. Ti nuk e di sa u trondit Çonda, më tha ai. Unë kisha një arsye timen dhe i kërkova të ma saktësonte se kur ishte tronditur Çonda.

— Kur Kristoja tha se nganjëherë fati vendos mbi ne? — e pyeta.

— Kur e mbaroi atë ngjarjen me Xhebrailin, — tha Gurba. — Ti s'e dëgjove deri në fund.

Ai fshatari shtrëngoi këmbët e qengjit që mbante në zverk dhe ngriti kokën. Cili është kandili im?, pyeti Xhebrailin. Ky kërkoi andej-këtej dhe e gjeti. Ja ku është yti, tha Xhebraili. Po ti, ua heq vajin kandileve?, pyeti fshatari përsëri. Jo, tha Xhebraili, unë pres gjersa t'u mbarohet. E po mirë, tha fshatari, kandili im paska

akoma shumë vaj. E pse të ta jap qengjin atëherë?!... I ktheu shpinën Xhebrailit dhe mori rru-
gën për në shtëpinë e tij.

— Ti i zmadhon gjërat, — i thashë Gurbës.
— E ç'ka këtu për t'u tronditur?

Përgjigjen ai ma dha të nesërmen: «Kishte apo nuk kishte zmadhim, Baltazar?!... Kristoja deshi t'i thoshte se, çfarëdo që kishte ndodhur mes tyre, Çonda s'mund të bënte më shumë se Xhebraili dhe Çonda u kujtua se vërtet, sado inat të hante, shpirtin s'ia kishte në dorë atij tjetrit.»

Por, aty për aty, Gurba u step dhe më tha se do të tregohej më i matur. Meqë isha afër, vajta prapë në *qyler* të shihja Anën. Mua më duhej të zgjidhja për të e t'ia çoja edhe të ngrënat. Në dhomën e saj s'mund të hynte njeri tjetër përveç meje.

Kovaç Kovaçi erdhi me tre anëtarë të tjerë të KOMISIONIT PËR KORENË. Në fshatrat përreth kishte përfunduar grumbullimi i ndihmave dhe komisioni i Bardhgolemit e kishte lënë t'i përfundonte po atë natë, në dasmë. Në dasmë njerëzit pinë nga pak, janë më të mallëngjyer e bëhen më bujarë, kishte thënë njëri nga anëtarët e komisionit, ai që shpresonte se Bardhgolemi do të fitonte FLAMURIN E NDIHMAVE.

Unë sapo kisha dalë nga Ana, kur dëgjova Kovaç Kovaçin:

— Meqë dhëndri qenka ulur me dajën e nuses, unë po ulem me babanë e dhëndrit.

Pashë Kondon që kishte vajtur në tryezën e tarracës dhe ia shkela syrin gjithë qejf. Atë

çast, togeri po shfrynte te qoshja e murit: «O zot, ç'më gjeti mua me këtë mjekërcjap!»

Shushulla ia kishte kthyer me falënderime gjelin e egër nëpërmjet një anëtari të komisionit, pasi nuk kishte dashur mish të tjetërkujt në dasmën e vajzës së saj. Toger i lidhi gjalmin shkurt me një kanxhë, braktisi gjelin e më tha mua:

— Kondos i takon tabakaja, po ti je shoqëruesi i tij dhe mund ta zëvendësosh.

Mora bllokun e komisionit, e vura në tabaka dhe dola të mblidhja ndihmat. Togerit nuk iu drejtova, mendova se e kishte të gatshme pjesën e tij të ndihmës. Por ai tha se, kur nuk kishte arritur të kënaqte krushkën, si mund të kënaqte Korenë me atë gjel?! Një në dorë, Baltazar. Hoqi keq, por, më në fund, ia kujtoi emrin atij që kishte dhënë pesëqind lekë, tre metra stof dhe një këmishë. Unë dyqanxhi nuk jam, po më poshtë se Selmani i Gramshit toger Zhavelloja nuk bie! Dy në dorë, Baltazar. Hodhi në tabaka një shumë të mirë parash dhe paralajmëroi dasmorët: Kush ka dhe thotë se nuk ka, dihet që ia merr i Papjesi! Tri në dorë, Baltazar, të tjerat plotësohen me kobure. Ai qëlloi me dy fishekë e ngriti edhe dy gishtërinj, për të plotësuar pëllëmbën e dorës.

U vërtita tryezë më tryezë, ndërsa ai zullapi i Meropit vinte pas meje e bënte regjistrimet. Pa arritur te tryeza e tarracës ia lëshova tabakanë në dorë dhe i thashë të vazhdonte me Meropin. U habit dhe më pëshpëriti:

— Kam pasur nevojë për ndihmë, Baltazar.

— Ti s'je Koreja, — thashë.

— Unë e Meropi jemi si Koreja e ndarë më dysh, — tha ai.

— Shko, mos më çaj kokën!

Ai iu afrua tarracës dhe deri tek unë erdhi zëri i Kristos:

— Kam diçka që mund t'i vrente KOMISIONIT, por e kam taksur për Kondon.

Unë nuk i dëgjova këto fjalë, më tha pas një jave togeri, por edhe ti që i dëgjove, ku ta mbaje mendjen më parë! Do ta gropos kutinë e flokut, Baltazar, megjithëse nuk është floku i Kristinës që më lidh me të. Ditën që të gradohem kapiten, kam frikë se do të më kujtohet ajo që ma dha e para këtë gradë, do të më kujtohet xhepi i grisur i palltos dhe dora e Kristinës e skuqur nga të ftohtët. Ishte grua e mësuar dhe më duket se të gjitha i dinte, dinte edhe se kur do të vdiste.

«Ne të gjithë jemi të dënuar me vdekje, po askush s'e di ditën e ekzekutimit të tij», m'u ngatërruan ca fjalë nga ato që kishte thënë Zhavelloja duke ngushëlluar Kubatët në shtëpinë e tyre.

KOMISIONI I NDIHMAVE u largua për të bërë llogarinë e përgjithshme në zyrën e këshillit. Ne u mblodhëm përsëri në tryezën tonë dhe Kondoja më pyeti për Anën. Përse e zgjat, thashë, a nuk ka ardhur koha që dhëndrit t'i jepet leja për t'u ngritur? Edhe pak, tha ai, ka shumë dasmorë që duan të gëzojnë, ndërsa kur dhëndri ikën në dhomën e tij, dasma bie. Na u duk se edhe në tarracë tymi i kandilave po shkonte drejt. Çondës filloi t'i zgjidhej goja, tha Kondoja, dhe tani që ka Xhemë Kurtin aty, do të kenë ç'të bisedojnë. Por ishim gabuar. Çondës do t'i shkonte gjuha pikërisht të dhëmballa e sëmure.

Kur krisi fisheku i parë, ne tashmë e kishim kthyer kokën andej. E pata shumë të vështirë, tregonte në fshat Xhemë Kurti, sepse i dëgjova të gjitha dhe, në çastin e fundit, nuk pata mundësi t'ia mbaja dorën.

Kristoja filloi t'i përgjigjej vetë pyetjes që kishte bërë në fillim.

— Lloji i parë: zogjtë që fluturojnë.

— Ti the se njerëz jemi dhe se, nganjëherë, fati vendos mbi ne.

— S'e paske harruar? — qeshi Kristoja. — Atë e thashë njëherë.

— S'e kam harruar, — qeshi edhe Çonda.

Tani e ngacmonin njëri-tjetrin të dy dhe të dy qeshnin nga pak. Fqinji i Zhavellove, drupunuesi që ishte i famshëm për rrotat e karrocave dhe kallot e këmbëve, i kërkoi Kristos të këndonte. Ai ia mori ulët «Nuk dua të më mbyllësh në zemrën tënde». Drupunuesi u kënaq, por tha se nuk ishte këngë *katundi*, atë e kishte sjellë në Bardhgolem një mësues emigrant. Atëherë Kristoja këndoi këngën e Voglit dhe drupunuesi i shkoi prapa me një zë të prishur basi. Kështu po, tha në fund drupunuesi dhe pyeti kushëririn, Gurbën e Norës, se si i binte më mirë një mashkulli: të blinte furçë dhëmbësh apo brisqe rroje? Gurba, kushedi përse, pandehu mos kishte ndonjë hile në atë pyetje dhe e ndërroi bisedën krejtësisht. Ai tha se doktor Zhavelloja e kishte zgjidhur qesën mirë për dasmën e të birit dhe nuk ishte treguar cingun, siç flitej për të. Pastaj arsyetoi në ishte e vërtetë se i Papjesi ia merr njeriut atë gjë që ka, kur thotë që nuk e ka. Ca thonë ia merr

e ca nuk ia merr, u luhat, por po të mos merrte asgjë, si do të mundte të rronte Djalli?

Ndërsa mua, që të nesërmen, Gurba më po hoi se do të kishte bërë më mirë sikur të mos kishte folur fare. U mundova të isha i matur, po çfarëdo të thoshe, prapëseprapë ajri mes tyre binte erë benzinë, m'u ankua. I thashë, si të mbrëmshmen, se po vazhdonte të zmadhonte gjithçka dhe se kjo nuk ishte në të mirë të fshatit tonë. Zvogëloje sa të duash, ma ktheu Gurba. Edhe njeriu, kur vdes, zvogëlohet. Gjithë sa ka qenë, shumë-shumë, dy metra vend zë. Por po mohuam e thamë se «nuk është jona», edhe kjo ngjarje bëhet e Djallit. Ndërsa unë nuk dua të përlyej kujtimin e të vdekurit. E dëgjova me veshët e mi Çondën kur tha: «Unë jam njeri, nuk jam Djalli!»

— Ta tregoi xherahja jonë ëndrrën? — pyeti Xhemë Kurti Çondën në tryezën e tarracës.

— Nuk ma tregoi si ëndërr, — tha Çonda.

— Shumë vjet më parë, dikush pati ardhur me dy kuaj dhe e mori për një hall, — xha Xhema. — Ne ishim mësuar me plakën, vinin dhe e merrnin ngamos. Po kur u kthye asaj here, nuk mbante mend ku kishte qenë dhe të gjithëve na u duk më e plakur. Më vonë, pastaj, ka parë ndonjë ëndërr dhe kështu i ka ngatërruar lëmshtet.

Pasi kaluan Grykën e të Pajjesit, kuajt e lanë shtegun dhe morën malit përpjetë, rrugë e pa rrugë. Xherahja e Kurtëve po bëhej njëqind vjeçe, po andej nuk kishte kaluar ndonjëherë. As atë që kishte ardhur për ta marrë nuk e kishte parë ndonjëherë. I kishte thënë se gruaja e tij ishte për lindje dhe gruan vërtet e gjetën në shpellë. Xherahja e ndihmoi lehonën dhe ajo lin-

di një kërthi, që plakën e çuditi. Pastaj filloi të çuditej me gjithçka që shihte aty. Në atë shtëpi-shpellë kishte edhe sheka djathi, edhe voza gjalpi, mish të tymosur e mish të freskët, stofra, pëlhura, dhoga, gozhdë, lesh të patjerrur etj. Në anën tjetër, rresht e rresht, dukeshin ca arka me gjithfarë parash, kartëmonedha me prerje të mëdha e të vogla, monedha prej metali të thjeshtë, prej argjendi dhe floriri. Sipër arkave, përmes gungave të murit, ishin varur stringla nga më të ndryshmet, që nga byzylykët e çmuar e deri te frerët e zakonshëm të kuajve. Përmes të çarave të gurit, që nuk dalloheshin mirë, vinin mbyturazi një kor blegërimash, hingëllimash e bulërimash. Herë pas here, nga e djathta dhe nga e majta, nga nëndyshemeja dhe mbitavani, depërtonin kllocitje pulash, gagaritje patash, guatje pëllumbash, klukurisje bibash, hungëritje derrash. Xherahja e Kurtëve sa s'po lajthiste, i dukej se ca rrangulla e xhingla që shihte rreth e qark i kishte parë dikur gjatë. Befas i zuri syri një sahat me qostek që ishte varur mu sipër kokës së lehonës. Në vend të dymbëdhjetë shifrave, fusha kishte dymbëdhjetë gjysmëhëna dhe atë sahat, që kishte ardhur nga Turqia, xherahja e njohu menjëherë. Në Bardhgolem, dikur, ishte bërë gërnjë e madhe. Nafuz Ruka po gjuante peshk në krua dhe kaloi andej braci i njohur i fshatit, i cili e pyeti se sa ishte ora. Kur Nafuzi mblodhi koshat dhe kërkoi jelekun në breg, nuk e gjeti. S'kishte hallin e jelekut, por të sahatit. Ca thoshin se kishte fryrë erë dhe jeleku kishte rënë në ujë, të tjerë e nxitën t'ia kërkonte Kici bracit. Ky sahat një herë e një kohë ka qenë i

Nafuz Rukës, i tha lehonës xherahja e Kurtëve. Ka qenë, tha lehona, nuk gabohesh. Një ditë Nafuz Rukën e pyeti dikush se sa ishte ora. Nafuzi përtoi të linte koshat, të shkonte te guri ku kish-te vënë jelekun dhe të nxirrte nga xhepi sahatin. Nuk kam sahat, i tha tjetrit. Meqë kishte, por tha se nuk kishte, im shoq ia mori sahatin. Ai merr nga njerëzit gjithçka që është e tyre, po që ata i bien mohit. Ku jam këtu?, pyeti xherahja. Në shtëpinë e Djallit, tha lehona. Po si t'ia bëj që të kthehem në shtëpinë time?, u frikësua plaka. Do të kthehesh, i tha lehona, burri im është te dera. Plaka doli. Çfarë kërkon për të mirën që më bëre?, e pyeti Djalli. Xherahja ra në mendime. Kishte rrojtur njëqind vjet, po sikur të rronte një mijë, nuk do të ishte keq. E ç'janë për ty një mijë vjet?, e vuri në provë. Hiç, tha Djalli, një minutë. Po një qyp me para, janë shumë për ty? Hiç, tha Djalli prapë, një santim. Plaka e ndjeu se për një mijë vjet jetë nuk kishte më kockë, kurse për një qyp me para kishte ende shpirt. Prandaj, sado që u hëngër me vetveten, i kërkoi të dytën. Për të mirën që të bëra, nuk më jep një santim? Posi, tha Djalli, prit një minutë.

— S'e dimë pse, — tha Xhemë Kurti, — kur u kthye prej andej të gjithëve na u duk më e plakur, sikur të mos kishte tri a katër ditë po trembëdhjetë a katërmbëdhjetë vjet që kishte ikur nga shtëpia. Edhe tani, sa herë na bie dera në mbrëmje vonë, plaka e shkretë kujton se është ai, i Papjesi, që ka ardhur t'i sjellë pjesën e saj. Po Djalli, me sa duket, vetëm merr e nuk jep.

— E lagu, s'e lagu, — tha drupunuesi, —

kjo nuk është njësoj e rëndësishme si furça e dhëmbëve dhe brisqet e rrojës. S'ka shumë ditë që bleva një furçë dhëmbësh, por u pendova dhe i vajta shitësit përsëri që të ma ndërronte me brisqe rroje. Pse u pendove, më pyeti ai, ti je burrë i martuar, nuk je Vogël Heta. Vetëm Vogli do të kishte dalë nga turpi, po t'i ishte gjendur një brisk natën e parë të martesës: mjaft t'i bënte së shoqes një vizatje rrëzë kofshës dhe ua mbyllte gojën të gjithëve me gjakun e çarçafit. Ama, ç'zakon i rëndë! — u ligështua drupunuesi. — Mua më tremb gjaku.

As që më ra në mend se, në atë tryezë, Çonda ishte daja i nuses dhe kishte hallin e tij, iu betua hetuesit më vonë drupunuesi. Nëse kjo harresë përbën faj, le të dënohem. Lipsur qofsh me dënimin tënd, i tha i nervozuar hetuesi, por herë tjetër mos u jep aq tepër pas mjekrës sa të harrosh gojën.

U hap enigma se me cilin e kishte pasur barën lënësia e Vogël Hetës.

— Llafë janë këto?! — qeshi Kristoja. — A dihet më kë e pati Krishtin shën Mëria?! Kur e pickon, ç'rëndësi ka në e pickon gjarpri apo akrepi?! Femrës njëlloj i duket, mjaltë.

Pati një shkundje të beftë të kokës, sikur po i pëlçisnin tëmthat, më tha Xhemë Kurti për Çondën. Pastaj liroi jakën nga komça dhe vuri gishtërinjtë në gropëzat rreth fytit. Mendova se e kishte nga pija dhe, duke qenë miku i tij, ia hoqa gotën. Kur porositi t'i sillnin ujë të pijshëm, e pyeta në ma kishte marrë për keq atë punën e gotës. Çonda buzëqeshi dhe më zgjati kutinë e duhanit. Nuk ma kishte marrë për keq.

— Si the, — iu kthye Kristos, — gjarpri apo akrepi?

— Ah, — bëri një tërheqje të vogël tjetri, — ajo dihet, femra nuk është një shën Mëri dhe fëmija gjithmonë e ka një baba. Në fund të fundit, e kujt do t'i vlente po të ishte femra një shenj-tore?!

— Ngëc, ngëc, — mohoi me pëshpërimë Çonda. Ai se ç'deshi të shtonte, por pati një ngecje, goja i vajti shtrembër dhe për disa çaste nuk mundi t'i komandonte nofullat.

Kur arriti të fliste përsëri, nxitoi si për të mbuluar boshllëkun që u krijua.

— Nuk di që mëkatarët t'i kenë vlejtur ndokujt, Kristo, — tha Çonda. — Këtë ia kam thënë edhe vajzës së Shushullës, asaj së madhes, ditën që do të vdiste në mal. Bën mirë që ma kujton Kaninë!... Tamam atë ditë, kur do të lahej në gjak, ajo më ka folur me gojën tënde dhe tamam sonte, kur kërkohet një gjak çarçafi, ti po më flet me gojën e saj.

— Njerëzit, gjithë sa numërohen këtu, shpirta janë, Çonda, — luajti Kristoja, — dhe shpirtat japin e marrin me njëri-tjetrin. Prandaj nuk është për t'u çuditur që unë e Kania paskemi folur njëlloj!

Ishte ndezur pulla-pulla në fytyrë, siç skuqet një njeri që i afrohet shumë zjarrit. Ai me zjarrin kishte luajtur deri atë çast. Kishte qenë i pirë apo kishte dashur të provonte se hakmarrja është thikë me dy tehe? E kishte kthyer thikën në të kundërt dhe e ndjeu se ia kishte çuar tjetrit tehun për asht. Tani mjaftonte, mund të ndalej. Edhe e mira, edhe e keqja kanë kufi. Kot

thoshte fshati se, sa shkulet pylli nga era, aq të hiqet Kristoja nga dera. Ai filloi të fishkëllente ulët. Pastaj e ndërpreu edhe fishkëllimën dhe iu lut drupunuesit të kërcenin bashkë këllçen e parë. Por, për çudi, drupunuesi nuk donte më as të kërcente, as të këndonte. Ai e mbante kokën ulur dhe, vetëm më të rrallë, shihte Çondën me bisht të syrit.

Çonda thua se kishte ngrirë në karrige. Goja ashtu i kishte mbetur, shtrembër. Nuk po e zmadhoj aspak, më siguroi Gurba të nesërmen, dukej sikur i kishte rënë ndonjë damlla. Merrte frymë rëndë, po në të vërtetë thithej dhe, sapo hoqi një kleçkë të squllët nga cepi i buzës, m'u bë se palca e kockave i kishte ardhur në gojë. Me cilin flet, e ndala, me Baltazarin apo me doktor Zhavellon? Me Baltazarin, tha Gurba, ty të pyes: do të ketë dyshuar Çonda më parë se mbesa e tij, Kania e Shushullës, e kishte pasur barrën me Kriston e Kubatëve apo atë natë e zbuloi të vërtetën? Ia ka përmendur Kania atëherë, përpara se të vdiste, emrin e Kristos apo ajo e donte shumë dhe e mbuloi të fshehtë në varr? Po Kristos vetë i shkau gjuha më tepër ngaqë ishte i pirë, apo ishte i bindur se Çonda e çoi në burg dhe ai deshi t'i linte të kuptonte se nuk kishte shkuar humbur, se në fund të fundit hesapi midis tyre kishte vajtur jek e jek? Përgjigju vetë, thashë. Ç'të përgjigjem, ma ktheu Gurba, kur thahet përroi, gurët e nënujshëm dalin në diell. E ç'ke që pyet, pra, ti s'je hetuesi! Kot, tha Gurba, desha të dija ç'gisht kam unë në këto ngjarje. Të shtunën në mëngjes, si miku i tij, i kisha thënë Çondës se, për Anën, do të ishte e udhës ta kërkonte

patjetër gjakun e çarçafit. Kisha frikë mos të ndërronte mendja ty, Baltazar. Një gjest i qytetëruar shpërblehet mirë vetëm në qytet, këtu jemi në fshat dhe të dyja palët do të bëheshin me fjalë. Nderi është nder, nuk të kujtohet sa veta u bënë me fjalë atëherë për gjakun e Kanisë? Ne për Anën u mblodhëm mbrëmë, po më duket sikur u mblodhëm edhe për Kaninë. Jo vetëm Çonda, por të gjithë ne sikur e kemi kërkuar atë gjak, Baltazar! Çonda... E piu Çonda ujin që kërkoi?, e ndala prapë. E piu, tha Gurba. Nuk e zgjati, po sapo ia sollën gotën, e përpiu me dy-tri hurba të gjata.

Pikërisht atë çast, unë duhet të jem ngritur nga tryeza e kreut që të përgatiteshim për hyrjen e dhëndrit në dhomën e nuses. Po shkoja tek Ana, kur pashë një nga ata djemtë që shërbenin duke mbushur gotën prej bidonit të tremes dhe thashë me vete se cilit prej burrave i kishte dhënë kaq shpejt etje rakia e rrushit. Nusja tani duhet të jetë gati, i thashë gruas që i bënte Anës shoqëri dhe ajo doli menjëherë nga *qyleri*. Në korridor u dëgjuan ca mërmërima. U mor vesh se po bëheshin përgatitjet e natës së parë. Pa shiko ç'dhuratë më ka rënë nga qielli, Baltazar, qeshi Ana. Nuk ka kuptim, thashë, hiqe nga prehri. Po ajo më dhimbset, tha Ana, ku ta lë? Aty, qesha, me dhuratat e tjera, Kondos i kanë ardhur plot dhurata. Ajo e mbajti edhe një grimë dallëndyshen në prehër. Pastaj e mori në dorë. Dallëndyshja hapi sqepin e çarë deri te sytë. E kishte fare të vockël. Si këmbët, thashë, edhe këmbët i ka fare

të shkurtër. Ç'i duhen këmbët dallëndyshe, tha Ana, ajo nuk është bërë për të ecur, po për të fluturuar. Me vete isha gati që këtë pjesë të bisedës sonë ta merrte i Papjesi, ngaqë u kujtova se diçka të tillë kishte thënë edhe doktor Zha-velloja. Ia hoqa nga dora, se na duhej të merreshim me gjëra më tokësore dhe e vura dallëndyshen e re në një kanistër, ku kishte ca rroba. Dysheku i çiftit për natën e parë, sipas një tradite të hershme të ne, ishte shtruar përtokë. Dhoma e nuses do të rregullohej përfundimisht të nesërmen. Të dy këllëfët e jastëkëve ishin të qëndisur dhe çarçafi i sipërm, i hapur përgjysmë, kishte anash enteri.

Tani unë e dija vendin tim: do të rrija pas derës, duke pritur Kondon. Sapo të hynte ai, do t'i jepja ca grushtë pas kurrizit dhe do të dilja menjëherë. Më kishte porositur të mos e goditja fort, pasi as ai dhe as unë nuk ishim të sigurt se sa i bënte mirë ajo shkundje e beftë dhëndrit mu në shtyllën e kurrizit. Edhe mua ashtu më kanë goditur, i kisha thënë, dhe nëna më ka përcjellë deri te dera e *qylerit*. Përfytyrova Lolën dhe Zhavellon duke përcjellë Kondon. Përse na përcjellin, më kishte pyetur ai, dhe përse na përqafojnë përpara se të hyjmë në *qyler*, sikur do të ikim nga kjo botë për në një botë tjetër? Ndoshta se lëmë prapa botën që s'kthehet kurrë më, i kisha thënë, kalojmë nga bota e beqarit në atë të burrit të martuar. Edhe kur vijnë të marrin dikë për ta burgosur, të afërmit e përqafojnë, kishte qeshur Kondoja. Te dera do të gjesh edhe gra të tjera, e kisha paralajmëruar, dhe të gjitha ato do të të qëllojnë në kurriz. Ndërsa nëna dhe babai, kur të

jesh mbyllur brenda, nuk do të hiqen nga dera pa dëgjuar një fjalë nga ti dhe nga nusja. O nënë, i kam folur unë nënës sime atëherë kur më mbyllën me nusen, ç'ditë është sot? Mesnata kaloi, mor bir, hymë për të hënë. Megjithatë ajo nuk kishte lëvizur pa dëgjuar edhe zërin tjetër. Po, nënë, tha nusja, e hënë duhet të jetë, sepse dje ka qenë e diel. Ama, fjalë të mëdha paskeni nxjerrë nga goja!, më kishte ngacmuar Kondoja. Do ta provosh, Kondo, të hipën një zor që të vjen mendja rrotull dhe kërkon të shpëtosh me çfarëdo broçkullash. U jam lutur atyre që të mos më vijnë prapa derës dhe besoj se im atë më ka kuptuar, Baltazar.

— Anë, kam bërë një marrëzi, — thashë.

— Ti nuk bën marrëzira, — më zbuti ajo.

— Duhej t'i kisha thënë kunatit të togerit që të kërkonte leje për Kondon.

— Atij ia paskan lënë këtë nder? — pyeti Ana.

— Ndoshta ka qenë një dëshirë e togerit, — thashë, — ka dashur t'ia bëjë qejfin së shoqes. Po dal dhe, për pak, Kondon do ta kesh këtu.

Me të zbritur shkallët e tremes, togeri më përshëndeti me një breshëri false: ngriti revolen lart dhe shkërbeu me gojë pau-pau-pau! Pastaj ia zgjati revolen të kunatit, vëllait të gruas, sepse e kuptoi përse po afrohesha. U dëgjua e shtëna e tij dhe në qoshe të oborrit, i lidhur shkurt te kanxha, ia dha një «kollitje» gjeli i egër. Unë po shihja një copë hënë që ndriste përmes reve. Nuk e fsheh, m'u duk si një gji gruaja që zbulohet natën nga këmisha. Drita s'ishte më ajo e mëparshmeja në oborr. Aty-këtu, niveli i vajit nëpër llam-

ba kishte rënë dhe disa fytyra sikur ishin terruar pak e disa të tjera sikur ishin zbardhur. Nuk e di pse, ktheva kokën nga tryeza e tarracës dhe s'iu përgjigja togerit që më thirri: «Ke ndonjë fjalë për tim kunat, Baltazar?» Gota me dorezë, me dy gisht ujë në fund, kishte mbetur në zgrip, pranë pjatës së Çondës dhe unë u habita që pikërisht Conda kishte kërkuar ujë në pije e sipër. Drita atje ishte e mjaftueshme, por krejt padashur i mbajta sytë një grimë te kandilat.

— Të ka rënë pija në kokë, Baltazar, pse je zbehur kështu? — më pyeti doktori, që nuk u pajtua me ngathtësinë time.

— Jo, — thashë, — më ka rënë hëna në fytyrë.

— Ç'hënë, — ia bëri Zhavelloja, — hënë i thua asaj?! Ajo nuk është veçse një sisë deleje!

U turbullova që kishim parë gati njëloj, por turbullimin tim e mori prapë për ngathtësi dhe më tha se po e vonoja kotsëkoti dhëndrin.

Në atë çast gota duhet të jetë përmbysur në tryezë dhe uji që kishte mbetur u derdh. Xhemë Kurti e kishte ndeshur pa dashje me bërryl. Dasha t'i jepja Çondës cigare nga kutia ime, më tha. Ai e mori, por nuk e ndezi. Më tha se dëshironte edhe një raki. Ia hodha në gotën që i kisha hequr, por as atë nuk e ngau. Imja është, më tha, do ta pi.

— Do ta pish me miqtë apo me mua? — e pyeti Kristoja. — Ç'ke, o Conda, që tharton trutë, gjysma e mijës pesëqind! Të gjithë ne e kemi fatin në dorë, po aq sa fati na ka në dorë ne. Dhe sado që t'i shtrëngojë burgjitë njeriu i shkretë, me kalimin e kohës ato vijnë duke u liruuar. Ja, tamam këtë, kohën që liron burgjitë ti s'mund ta kesh

plotësisht në dorë. Dje më hodhe në gjyq si dezertor, sot pi me mua në një tryezë. A nuk na doli të dyve njëlloj? Dhe ku ta dish si mund të dalë nesër! Ma thua dot në do të jetë e lagësht apo e thatë vjeshta e vitit 2019? Ma thua dot me cilin do të pinë një gotë fëmijët e mi dhe nipërit e tu? Mund të vijë një ditë që gjithfarë zabërhanësh, nga ata që ia kanë mbathur jashtë dhe që sot fa-refisi i tyre i mohon, nesër t'ua mbushin hejbet me plaçkë e me dollarë njerëzve të tyre këtu dhe fëmijëve tanë t'u bëhet syri bakër: ose t'u afrohen e të zënë miqësi me ta, ose të durojnë ngasjen e të plasin nga zilia! Gjysma e mijës pesëqind do të jetë gjithmonë, Çondë, veçse pesëqindëshja s'ka për të qenë gjithnjë po ajo. E pse tharton trutë, mor i gjorë, për të gjetur atë që nuk gjenet?! Se mos ia gjeti njeri fundin botës! Të kujtohet lloji i dytë i zogjve, Çondë?

Ja cakërroi gotën dhe qeshi gjithë potere.

— Herë tjetër të mos qeshësh, — s'iu durua Gurbës.

— E pse të mos qesh? — ia bëri Kristoja.

— Se nuk e dimë arsyen, — tha Gurba.

Çonda, më në fund, u bë i gjallë. Pandeha se i hipi inati me mua, më tha Gurba. E kisha përballë dhe me atë syrin e rrëzuar, që nuk e hapi më, më dukej sikur po më merrte në vijë shënji-mi.

— Ngrehu, — i tha Kristos, — yt vëlla e ka lënë pa lloz derën e jashtme. Shko tani.

Unë isha afruar te kunati i togerit dhe po i kujtoja përsëri se ai duhej t'u kërkonte dasmorrëve leje për dhëndrin. Sipas Gurbës, gota me dorezë ishte përmbysur këtë çast dhe nuk ishte

Xhemë Kurti, po vetë Çonda që e kishte ndeshur padashur me pjesën e parakrahut. Xhema e ngriti gotën menjëherë dhe e mblodhi ujin, duke e tërhequr me pëllëmbën skiç, në një pjatë boshe. Por, pas kësaj, s'pipëtiu më njeri në tryezën e tyre. Kur Çonda foli prapë, unë po shihja nga tarraca. Duhet të ketë qenë heshtja dhe jo tingëllima e qelqit që më kishte detyruar ta ktheja kokën andej.

— Ngrehu pra, — tha Çonda.

— Jo, — kundërshtoi përsëri Kristoja, — këtu më gjete dhe nuk më pëlqen të largohem i pari nga kjo tryezë. Ë pse u dashka të ngrihem?!

— Se do të të vras, — tha Çonda. — Por je në bukë dhe bukën këtu e ka shtruar tjetërkush.

Unë pashë Çondën që u ngrit dhe Xhemë Kurtin që u zgjat nga ai. Por tashmë Çonda e kishte nxjerrë revolverin. Ç'ka Xhema që nuk e lë të shtjerë, mendova, dasmë është dhe të gjithë ata që kanë armë me vete, kanë shtënë para Çondës? Ti je i marrë, ndërrova në çast, kur pashë Kristo Kubatin që po ngrihej mëdyshazi.

I fola togerit (diçka po i thoshte Katerinës) dhe u vërsulëm andej. Brofën pastaj të gjithë dasmorët. Po Çonda nuk lejoi t'i afrohej njeri. Ai e bëri veshin të shurdhër ndaj Xhemë Kurtit, kurse përgjërimit të Zhavellos iu përgjigj gjithë tërsëllëm: «Pirdhu, doktor, m'u hiq nga sytë tani!»

— Shaka bëra, — iu lut Kristoja, — të mërreri vesh, dale, një minutë!

— Minuta është shumë e gjatë, Kristo, — tha Çonda. — Unë nuk kam kohë të pres, siç e sheh jam njeri, nuk jam Djalli.

— Në je njeri, — bëri t'i afrohej tjetri për t'ia

ndalur dorën, — ç'ke me mua atëherë?! Unë dua të qesh, mor zot! Më pëlqen gazi, më tërheq algria. Përse u dashka t'i merret erë sivjet mutit që bëri qeni vjet?! Në gjyq dola, një muaj burg e bëra, pastaj vetë më nxorën. Gjykatësi ma fali dënimin.

— Ai mund të të ketë falur, Kristo, ty edhe Kania të fali. Po Çonda nuk fal, — tha tjetri.

Pasi e nxori në shesh emrin e Kanisë, e qëlloi Kriston në gjoks. Nuk e kishte më larg se pesë-gjashtë hapa. Kristoja lëshoi një ofshamë, u ngërdhesh në fytyrë dhe plumbi i nxehtë e përshkoi tejpertej. Ai u lëkund duke u thyer më gjunjë, i kthyer gjithnjë nga vrasësi i tij. Kur Çonda e qëlloi edhe dy herë të tjera në gjoks, Kristoja ofshani përsëri: «Unë desha të qesh, mor zot!» Pastaj u palos pa frymë. Por, për çudi, nuk i doli pikë gjaku, sikur tërë lëngjet t'i kishin rënë në fund të këmbëve.

Dëgjua gratë që ulërinë dhe u përpoqëm t'i bënim zap menjëherë. Çonda mbeti vetëm në tryezë. Ndoshta ende s'lejonte njerëz pranë, po tani nuk kishte më përse. U ngjita në tarracë dhe iu afrova. Ai hoqi dorën nga nofulla që të më shihte. Më pa fare shkurt dhe vazhdoi ta mbante kokën mes duarve. Përpara kishte revolen dhe rakinë që kishte thënë se do ta pinte.

Fqinji i Zhavellove, drupunuesi, kishte vajtur të merrte karrocën e tij dhe, kur u kthye, e futi brenda me gjithë kalë. Kristos i kishin hedhur një batanije përsipër. Në oborr çarkullonin gjithfarë zërash: disa thoshin se kufoma duhej çuar në shtëpinë e Kubatëve, të tjerë në zyrën e këshillit. Doktor Zhavelloja nguli këmbë të çohet në

infirmierinë e fshatit. Ai e ekzaminoi kufomën shpejt e shpejt, me një vështrim të mprehtë prej specialisti. Ka mbaruar, tha, megjithatë rregulli është rregull, të çohet në infirmieri.

Kriston e vunë në karrocë, mbështjellë këmbë e kokë me batanije. Drupunuesi zuri frerin duke qarë. Gjithë ai burrë ishte mbledhur sa një grusht, sikur deri atëherë të mës e kishte njohur vdekjen. Rrotat kërkëllinë dhe, duke dalë nga oborri, karroca zuri pakëz me bisht në kashën e derës.

Pastaj rrotat filluan të kërkëllinin në kall-drëm. Karroca kishte marrë më të djathtë dhe po i ngjitej xhadesë. Nuk vonoi dhe, prapa murit të oborrit, mu në krahun e tarracës, u duk koka e drupunuesit. Pas një grime, pamë në të përpjetë gjithë karrocën dhe ata që e shoqëronin. Shkonin me kurrizin të kërrusur dhe shumica mbanin fenerë. Dritat e fenerëve lëpiheshin andej e këtej murit. Dhe heshtje kishte sa të duash. Natyrisht, ne po heshtnim për të vdekurin, kur ai e prishi heshtjen vetë.

Befas, duart e Kristos u mbërthyen në parmakët e karrocës. I vdekuri u ngrit ndenjur. Ata që ishin pas, ngrinë në vend. Drupunuesi çoc ndjeu, e mbajti karrocën dhe ktheu kokën prapa. Kur pa të vdekurin që po ngrihej në këmbë, u lebetit edhe më nga tmerri e kërceu në xhade me obobunë në gojë. Kristoja e mëshiroi me një qeshje dhe u kthye nga ne:

— E ku po më çoni kështu, o njerëz? Pse nxi-toheni, unë akoma s'i kam dhënë Kondos as dhuratën time për martesën!

Në heshtjen e përgjithshme që ra, ai bëri një pushim të shkurtër. Pastaj tha prapë:

— Në varreza çohen vetëm të vdekurit, o njerëz, ata s'mund të qeshin më. Kurse i gjalli ka nevojë të qeshë dhe qesh që të mos ndihet i vdekur. Çonda, — e veçoi armikun e tij duke e thirrur në emër, — mos pandeh se vetëm ti dhe im vëlla keni lindur me këmishë. Këmishët nuk mungojnë, ka për të gjithë, por jo të gjithë janë trima!

Në foli Çonda ndonjë fjalë, nuk jam në gjendje ta pohoj. Po karrigen e la si të tjerët dhe nuk e di në qe habia apo ndonjë forcë tjetër që e ngriti.

— Të kujtohet, Çonda, sa lloje zogjsh kemi? — i thirri Kristoja. — Kur isha në burg, kishte njerëz që akoma e mbanin mend atje ish-drejtorin e tyre, Çondën e Vitorisë. S'ishte burrë i keq, tregonin, bile për ndonjë hall na jepte edhe leje. Na mblodhi njëherë në një mbledhje dhe, në fund, na pyeti se sa lloje zogj ka në këtë botë. Lloji i parë, i thanë të burgosurit, janë zogjtë që fluturojnë. Lloji i dytë janë zogjtë e putanave, dhe zogj putanash jemi ne që na kanë rrasur brenda. Lloji i tretë, i thanë ata, janë zogjtë e gomarëve, dhe zog gomari je ti që pyet pikërisht të burgosurit për zogjtë që fluturojnë!... Çonda, qesh, mor njeri!

Qeshën disa të tjerë, tashmë të lehtësuar. Po Kristoja ia dha gazit edhe vetë. Ai zuri të hidhej pupthi në shtratin e karrocës, rrotullohej nga të katër anët dhe bënte gjithfarë gjestesh me këmbë e me duar, si një xhind. Kur e mori plumbi, vuri dorën në shpatull si të mos e besonte pa e prekur gjakun me dorë. Pastaj deshi ta hiqte dorën, po nuk mundi, e zunë ngërçet shpejt. Ai u pengua në parmakun e karrocës dhe u shemb në atë anë me turinj të në kalldrëm.

M'u duk edhe më i rëndë tani, më tha opingari që ndihmoi për herë të dytë ta vinin në karrocë. Drupunuesi nuk pranoi të mbante më frerin dhe karrocën deri te sheshi i fshatit e ngau opingari. Sapo e zhveshën në infirmieri, më tha ai, i gjetën në trup këmishën e hekurt, atë që kishte taksur dhuratë për ty.

Ajo ishte një parzmore prej tunxhi, si zor ta thuash në ç'kohë ishte punuar dhe te cili farkëtar ishte rrahur. Mbase ishte ndonjë prodhim i huaj dhe dikush e dikur e kishte sjellë nga jashtë. Në pjesën e prapme ishte e hapur dhe lidhej me ca rripa të vjetër. Kristoja e kishte menduar për Kondon, mbasi kishte dëgjuar se kërkonte një parzmore për muzeun. Ai e kishte gjetur në Borje te kushërinjtë e së ëmës, po aty ku kishte huajtur edhe kalin e vrapimit. I zoti i parztores doli shpejt, por për shumë kohë s'u mor vesh se kush e vrau Kriston. Në fillim u tha se plumbi që iu gjet në trup ishte plumb mauzeri, ndërsa Çonda kishte vetëm armë të shkurtra me vete. Nga disa fqinjë u fol se Kriston e kishte vrarë Shushulla, së cilës dikush ia kishte çuar në vesh, po atë natë, të vërtetën për Kaninë. Pastaj u tha se e vrau Kubat Kubati, e qëlloi me pushkë nga dritarja e shtëpisë së tij, në një çast kur s'mundi të duronte më marrëzinë e të vëllait. Kaloi ca kohë dhe nga Lagjja e Epërme, që shtrihej në këmbët e malit, doli një fjalë tjetër: sikur, atë natë, dikush pas-kësh parë të kalonte andej një fantazmë. Flokët e saj ishin të shprishur, të ulur deri në supe. Nuk mund të vije dorën në zjarr në ishte mashkull apo femër. Por ai që e kishte parë betohej se fantazma mbante pushkë dhe se, deri diku, i ngjante Ka-

nisë. Pastaj, dalëngadalë, shteruan fjalët dhe mbeti ajo që ishte për t'u besuar: Kriston e kishte vrarë Çonda.

Dhe vërtet, kur tjetri u përmbys nga karroca, unë pashë se Çonda kishte revolen në dorë.

Të tjerat, pastaj, rrodhën shpejt e shpejt.

Nuk ishte hera e parë që ndodhte gjëmë në dasma. Po sa herë kishte ndodhur, ishin gjendur njerëz që merreshin me të vdekurin dhe të tjerë që merreshin me të gjallët. Nuk kishte kob më të madh sesa të lije nuse e dhëndër pa u bashkuar në dhomën e tyre.

— Mendoj t'i japim leje dhëndrit, — tha formalisht kunati i togerit.

Të gjithë sa kishim mbetur në oborr ndiheshim si pa frymë dhe secili donte që gjithëcka të mbaronte sa më parë. Kondoja nuk ishte në vendin e tij. Ishte afruar te brezi i tarracës dhe shihte nga Çonda. Edhe Çonda nga ai i mbante sytë, madje edhe të rrëzuarin, po kushedi si e shihte Kondon.

— Eja, — i thashë Kondos. I fola ulët, sepse e kisha zënë nga krahu. — Ana mund të jetë bërë merak. Ndoshta është më mirë të hysh brenda.

— Po. — tha ai, — dasma mbaroi. Tani është mirë që edhe të tjerët të shkojnë, me përjashtim të mysafirëve të largët.

Se ç'e porositi togerin, i cili hipi në tarracë dhe u ul në tryezë, përkundruall Çondës.

Doktori nuk lëvizti. As Lola nuk dha ndonjë shenjë se do ta shoqëronte të birin. Mua nuk më la ta çoja te dera e dhomës, po më ktheu që në

treme. Unë u ula në një stol druri, ngjitur me bidonat e ujit. Në një qoshe ishte mbledhur hamaku i Zhavellos, sikur çfarë kishte pasur për të rënë në rrjetë tashmë të kishte rënë. Kur, më vonë, doktori hoqi dorë nga disa stringla dhe ia fali hamakun një peshkatari, e urova me mend.

Kaloi një copë herë e gjatë dhe gjithandej vetëm heshtje. Asnjë nga ata që kishin shoqëruar kufomën e Kristos nuk po kthehej. Xhemë Kurti u kishte dalë përpara për të mos lënë asgjë mangut. Më në fund, u dëgjua një ulërimë e thekshme. Te Kubatët njerëzit kishin çuar lajmin e vdekjes dhe plaka, duke u çjerrë, kishte dalë në dritare për të vënë kujën.

— Çondë, — tha togeri, — mua më duhet të kryej detyrën time: ma jep armën!

Çonda nuk foli, revolja mbi tryezë ishte. Edhe gota me raki kishte mbetur në tryezë. Ai kishte thënë se do ta pinte dhe e piu.

— Për të mirë, doktor, — i tha babait të dhëndrit. — Për të mirë, krushkë, — i tha Lolës. Pastaj u kthye nga Zhavelloja tjetër: — Gjithkush ka detyra për të kryer, toger.

Nuk m'u duk se duhej ta ndaloja. Kur u ngrit, revolen e la në tryezë dhe unë mendova se ai kishte të drejtë të ndahej me çiftin. Më kaloi fare pranë dhe njëri krah i tij m'i ciku duart. Doktori erdhi me nxit që të më fliste. Po s'patëm kohë as ai e as unë të flisnim. Dëgjua trokitjet. Një pritje e shkurtër dhe një lëvizje e dorezës. Dera u hap dhe u mbyll përsëri. Kondoja duhej ta kishte futur brenda.

Nga dhoma ngjitur me tonën dëgjova mbyturazi se dikush e hapi derën e *qylerit* dhe i vuri

mandallin, më tha Kondoja, por unë pandeha se ishte ti, Baltazar. Anën e gjeta shumë të shqetësuar, nuk i kishin pëlqyer të shtënat e fundit dhe një si ulërimë grash në oborr. Ç'ka ndodhur, Kondo?, më pyeti e trembur. Meqë Çondën e dinte në Dardhali, siç e kishte thënë ti, nuk i shkante mendja për keq, veçse ishte trembur mos ishte plagosur njeri pa dashje nga të shtënat e dasmorëve. I thashë se ishte plagosur Kristo Kubati, por pa ndonjë dëm të madh, pasi plumbi e kishte zënë rrëshqitazi. Sa ters që vajti, Kondo, sa ters!, filloi të qante ajo. Ndenjëm të dy mbi dyshekun e shtruar pa u zhveshur. Por ndenjëm fare pak. Ngjyra e kuqerremtë e *qylerit* më nervozonte dhe më dukej sikur gjithçka aty ishte stërpikur me gjak. Po më zihet fryma, Kondo, tha ajo, era e bojës më ka hyrë në mushkëri. U ngrita dhe kalova me Anën në dhomën matanë. Doja ta qetësoja. Çelësin e asaj dhome vetëm unë e mbaja. Andej ishte ndryshe, nga dyshemeja e re vinte era e drurit të zdrukthuar që të kujtonte erën e dyllit. Unë po mendoja se ç'bënit ju në oborr. I kisha thënë togerit të përdorte takt dhe t'ia hiqte revolen Çondës. Pastaj të përpiquej ta fuste në kuzhinë, në mënyrë që, kur të vinte policia për ta marrë, ta gjente ulur dhe pa armë. Kur dëgjova hapa në *qyler*, pandeha se ti po vije për të më sjellë ndonjë lajm, Baltazar.

Çonda është ky apo më duket mua?, ishte habitur Qejvan Qejvani, duke vështruar mes plaseve të tavanit. E ç'dashka daja i nuses në *qyler*?! Nuk i kishte dhënë zgjidhje me vete përgjuesi i paguar me ar të rremë. Syri i vetëm që i kishte mbetur i dridhej vazhdimisht dhe ai shihte si nëpër mjegull.

Largësia nga dera deri te dysheku ishte e vogël, por Çonda hoqi keq për ta përshkuar. Nganjëherë, një metër vend është një rrugë me të vërtetë e gjatë, sepse pasi ta kesh përshkuar këtë largësi minimale, ndodhesh aq larg pikës nga je nisur, sa nuk mund të kthehesh më tek ajo. Merrret me mend sa e gjatë i është dukur Çondës edhe koha për të prekur dyshekun me dorë. Ai u befasua që në fillim, kur pa se *qyleri* ishte bosh, ndërsa në jastëkët dhe në dyshekun e shtruar dukeshin format që ishin sajuar nga trupa njerëzore.

Ja hoqi vetes shpejt, i betohej hetuesit Qejvan Qejvani, pa më lënë kohë të veproja a të thërrisja. Unë do të kisha thirrur, por nuk e dija çfarë kishte ndodhur përjashta. Pastaj nuk pashë asgjë më.

Ajo turbullira e vështimit të tij nuk kishte qenë mjegull, po tym. Atij po i shuhej drita e fundit edhe në syrin e vetëm. U thanë gjithfarë fjalësh, madje sikur e verboi bukuria e nuses, mëkati ndaj të martuarve ose vdekja e Çondës. Plaku, sidoqoftë, betohej se Çondës nuk i kishte parë armë në dorë.

Dhe është e besueshme që armën ta këtë nxjerrë në sekondat që pasuan e që ishin për atë po aq të gjata e tronditëse. Edhe çarçafi i shtruar, edhe jastëkët e qëndisur ishin ende të ngrohtë. Atë ngrohtësi dora e tij e ftohur e ndjeu menjëherë. Mbulesa sesi ishte mbledhur në një krah, sikur ai që kishte rënë në krahun tjetër të kishte konstatuar diçka shumë zhgënjyese dhe të ishte ngritur plot pezmatim, duke ia përplasur së shoqes çarçafin në turinj. Pikërisht në jastëkun e asaj ane ai gjeti edhe një fije floku të spërdredhur, siç u

spërdridhnin flokët nuseve, atëherë, me biguti. Nuk thonë kot se, shpesh, jetën e vdekjen i ndan vetëm një qime floku, komentonte i mallëngjyer togeri.

E gjetëm të shtrirë e pa jetë në dyshek. Ana dhe Kondoja kishin dalë nga dhoma ngjitur me të dëgjuar të shtënë. Ne mezi e kishim dëgjuar në oborr krismën e mbytur, si të kishte qenë një e shtënë në pus. Ana qante me dënësje. Por të gjitha gratë u ngashëryen kur ngritën trupin e tij të përgjakur. Nën brinjë, ngjitur me mbulesën e mbledhur, bënte ferk një njollë e kaftë përzier me të kuqe. Pa dashje, Çonda kishte shtypur atë dallëndyshen e re që, me sa duket, kishte lëvizur nga kanistra kur qyleri kishte mbetur pa njeri.

Filluam ta mbartnim Çondën për ta nxjerrë në oborr. Zhavelloja kishte sjellë batanije dhe, ashtu si për Kriston, propozoi ta çonim sa më shpejt në infermieri.

— Edhe spitalet e vërteta, doktor, — kundër-shtoi dikush, — shumë-shumë shërojnë të gjallët, por nuk i ngjallin të vdekurit.

Ishte ai zullapi i Meropit. S'e kisha vënë re dhe u habita që kishte ndenjur deri në fund. Ai kishte ndenjur për mua, sepse e kishte mbajtur një frikë e pashpjegueshme.

— Mirë thotë, — e mora në mbrojtje para doktorit.

Zhavelloja kroi zërin.

— Rri ti, — ma ktheu, — ty të iku nga duart, qyqar!

— Të gjithëye nga duart na paska iku, doktor, — ia priti në oborr Xhemë Kurti, që po kthehej nga Kubatët. I ra përsipër trupit të mikut dhe e thirri disa herë: «Çondë, Çondë!» Merret

vesh se i vdekuri s'e dinte më emrin e vet.
Unë isha tym dhe sytë më bënin perde, kur më zunë prapa nga këmisha.

— Baltazar, unë nuk dua të martohem. Më dëgjon?! — më foli ime motër. — I thuaj atij të mos e sjellë bukën e bardhë. I thuaj, Baltazar!

Meropi më ndoqi një copë rrugë. Vinin pas nesh edhe të tjerë, po zërin e saj e dalloja qartë. Mbaja njërin kind të batanijes dhe nuk mund të liroheshja, që t'i jepja një shuplakë për ta sjellë në vete.

— Ik në shtëpi, mbathja! — i bërtita.

— Nuk dua, kam frikë! — klithi ajo.

E ktheva kokën përgjysmë dhe ajo e ngjeshi faqen menjëherë te goja ime. Duke e puthur, ndjeva në buzë shijen e kripës. Ajo kishte frikë të martohej.

— Ç'pret, zullap, — i bërtita tjetrit, — merre të fejuarën e çoje në shtëpi!

Ata ikën dhe ne vazhduam për në zyrën e këshillit. Edhe Kriston, gabimisht, atje e kishin çuar. Për hir të këtij gabimi apo ngaqë policia po vonohej, Kovaçi vendosi që të dyja kufomat t'i nisnim në qytet.

Unë s'mund t'i shihja të vdekurit dhe dola shpejt përjashta. Në errësirë, mu te qoshja e murit, dëgjova një përplasje, sikur dikujt t'i kishte fluturuar koka. Pastaj erdhi një ankim i rëndë:

— Këta mutra mutrash akoma s'e paskan shkukur?!

Doktor Zhavelloja kishte pandehur se do t'i gjente kufomat në infermieri dhe i kishte rënë, siç i binte dikur, ndërtesës rrotull. Mirëpo te qo-

shja i kishte fluturuar borsalina në atë shufrën e telit që dilte nga muri.

— Koka në vend, doktor, — shfrytëzova rastin për t'i kthyer reston. — Njeriu është mirë t'i heqë vetë bëzhdilet që i dalin përpara. Zotrote ke vite që lufton me atë copë shufër!

— Ti qenke, Baltazar? — u përtyp Zhavelloja.

I thashë se kufomat ishin në zyrën e këshillit dhe se do t'i nisnin për në qytet. Ai u përtyp përsëri. Pastaj, s'e mora vesh përse, tha se në fshat ka njerëz të mençur.

— Po Rrota e Sansarës? — e pyeta unë.

— Rrota vërtitet, Baltazar, — u mbajt ai, — po s'dihet gjithmonë në shkon përpara apo prapa. Kësaj here patëm një indietro.

Isha deri në fyt me dinjitetin e tij dhe u ktheva vetëm. Në oborrin e Zhavellove gjeta togerin. Ishte mes kandilave që bëlbiteshin dhe m'u duk si Xhebraili. Në oborr kishte më shumë hënë, por kishte më pak dritë.

Togeri ishte veshur me rrobat ushtarake dhe po mbathte opingat. Kur ngriti kokën, besova sikur ishte hequr në fytyrë.

— Iku, — më njoftoi, — gjeli i egër ka këputur gjalmin dhe ka marrë arratinë. Për t'u çuditur apo jo, as Shushulla nuk pranoi ta merrte!

— Diku rrotull do të jetë, — thashë.

— Jo, — tha skeptik togeri, — ia ka mbatthur në pyll. Ka një nuhatje të mprehtë ai dhe largohet menjëherë, sapo ndien diçka të dyshimtë. Prandaj është e vështirë gjuetia e tij. Ta kisha ditur, — shtoi me keqardhje, — e jepja edhe atë për tartarët e Mongolisë.

— Ç'tartarë, toger, ata janë koreanë!

— E kam humbur fare, Baltazar, — u leqendis tjetri.

Ai vajti në treme dhe takoi të shoqen që po sillte armët e tij. Katerina ia mbërtheu kopsat e bluzës së uniformës. Toger i hodhi automatikun në krah, pastaj mori edhe torbën me bomba. M'u duk se vërtet ishte hequr në fytyrë, por edhe mollëzat e dala, edhe faqet që i bënë gropë e tregonin prapë simpatik.

— Nuk i mbyll pakëz sytë? — më tha mua. — E kam të vështirë me publik.

E shoqja e shtyu lehtë, por ai e afroi nga vetja dhe ata u përqaftuan «publikisht», sepse unë nuk ua ktheva kurrizin dhe as i mbylla sytë. Ai e ngriti njërin krah mbi supin e gruas dhe në shpatullat e saj u mbështet torba me bomba.

— Mos qaj, budallaqe, sikur e kam luftën për herë të parë. Apo ti qan për të vdekurit? — e pyeti.

Katerina s'foli.

Ai po shkonte në pyll që të përleshej me bandat. Po sapo më kishte thënë se në pyllnaja thellë rron edhe gjeli i egër dhe mua më dukej sikur po shkonte t'i zinte shtegun.

Te porta e oborrit u kujtua se nuk ishte ndarë me mua.

— S'dihet në shihemi apo nuk shihemi në darkë, — më tha.

— Dihet, — thashë, — sot nuk nisem në qytet.

Ai doli. Pak më tej e priste ushtari korrier. Në lartësinë e xhadesë, sipër murit, më foli prapë:

— Megjithatë, topi është i rrumbullakët, Bal-

tazar! S'dihet në shihemi apo nuk shihemi në darkë.

Katerina më solli kafe të hidhur. Ajo më pyeti në duhej të më ngrohte ujë për t'u rruar. Im vëlla po rruhet te sqolli, më tha. Unë nuk dua, thashë. Në vdekje vetëm njerëzit e shtëpisë rrinë pa u rruar, më kujtoi. Ti nuk do të shkosh për Çondën në Dardhali?

Kur erdhi Kondoja, unë kisha mbaruar me briskun. Ai po kthehej nga shtëpia e Shushullës. Kishte lënë atje Anën dhe Lolën. U ul në tryçzën time, po në cepin tjetër. Ishim kaq afër dhe aq larg. Mendova se kishim shumë për të biseduar, por nuk folëm, sikur të mos e ndienim praninë e njëri-tjetrit. Vetëm një herë më kërkoi të falur: S'ma kishe borxh gjithë këtë, Baltazar!

Rigonte nga pak. Ne dëgjonim brerimën e lehtë të shiut mbi tendën e hardhisë. Pastaj shiu u ndal. Kishte filluar të zbardhte, në xhade kalonin njerëz dhe Kondoja u ngrit.

Pas pak, ai nxori në oborr çarçafin e natës së parë. Filloi ta hapte që në treme dhe dallëndyshet u trembën. Disa fluturuan e disa ranë për tokë. S'guxoja të hidhja një hap, se më dukej sikur do t'i shkelja me këmbë.

Çarçafi ishte gjithë vurrata-vurrata. Natyrisht, gjakun e kishte ftohur vdekja, po dhembjen, thonë, nuk e ftoh as dheu.

Në stacion

Ai e mbaroi rrëfimin, para se treni të arrinte stacionin e fundit. Shterni më kishte shërbyer për aq sa shërbejnë të vdekurit: e kisha lënë tjetrin të më tregonte sipas dëshirës së vet, ashtu si i kishin ardhur ngjarjet dhe pa e ndërprerë. Po të përdorja një shprehje të tij, duke e vënë mirë në hesap, dilte se të gjitha m'i kishte thënë. Shumë-shumë, kishte kursyer ndonjë hollësi që mund të kishte rëndësi vetëm për të.

Kur mbaroi, ndihej i molisur, në fytyrë i përronte një djersë e lehtë dhe, ndoshta, nga pigmenti i veçantë i lëkurës (duhej të ishte karakteristik për Zhavellot), dukej sikur kishte bërë banjë me kininë. Ai mbështeti kokën dhe në xhamin e dritares shëmbëllyen kaçurrelat e tij.

Zbritëm në peron njëri pas tjetrit. Ai do të vazhdonte më tej udhëtimin me autobus dhe unë

e pyeta në i lejonte koha të pinim diçka në barin e stacionit. Nuk deshi, sepse kishte vënë re që shoferët e autobusëve, zakonisht, presin më pak nga trenistët.

— Sigurisht, nuk je trajner futbolloi? — e pyeta kalimthi.

— Nuk jam, — tha.

— Dhe nuk je as Baltazari, po Kondoja, — thashë.

Ai qëndroi një grimë. Nuk kundërshtoi, po deshi të dinte se ku e kishte tradhtuar veten.

— Ke pasur ndonjë lajthitje të vogël gjatë rrëfimit, — thashë. — Për shembull, kur togeri ju doli në rrugë me të shoqen, Katerina krehu vetëm Baltazarin, se ai i ka flokët të lëpirë si togeri. Kurse ti nuk kishe nevojë për krehër. Kondon e ka krehur vetë zoti, tha Katerina për ty, përderisa e ka bërë me kaçurrela. Ti je kaçurrel.

— Një në dorë, — u mundua të buzëqeshte ai. — Po, xhaxhai im e kishte zakon t'i numëronte argumentet me gishta. Po tjetër, ku e tradhtova veten?

— Tani për tani e kam të vështirë të ta provoj, — thashë.

Dyshi më ngeli në dorë, sepse nuk po guxoja ta pyesja në rronte ende togeri. Ai e kuptoi ndryshe ngurrimin tim.

— Posi, — tha — togeri u bë edhe kapiten. Po kanë kaluar vite që atëherë, ndërsa im atë nuk ka shumë që ka vdekur.

— Në hamak vdiq doktori? — pyeta.

Isha treguar i pavëmendshëm dhe, në këtë pikë, Kondoja më bëri një korrigjim të nevojshëm.

— Në shtrat, — tha. — E zunë ca dhimbje

kockash, sa dhe dysheku i dukej se e vriste. Vdiq gjithë pishmanllëk që, në fund, nuk iu ndodh hamaku i vjetër, pasi ia kishte falur atij peshkatarit.

Po kalonim ndanë barit dhe përsërita dëshirën që të pinim diçka në këmbë. Ia lashë valixhen time banakierit dhe morëm konjak. Ndërkaq ndiqnim nga xhamat udhëtarët që kishin filluar të hipnin në autobusë.

— Po Baltazari? — pyeta.

— Më vonë, ai u bë trajner, — u përgjigj, — po jo ndonjë emër kushedi çfarë. Nga fshati ynë vetëm Timo Kubati u bë futbollist me emër.

— Kur gjeneral Çonda deshi të të takonte ty dhe Anën, armën e kishte lënë në oborr, mbi tryezë. Pra, ai hyri në dhomën tuaj pa armë. Si ndodhi që?...

E kuptoi menjëherë ku e kisha fjalën.

— Pranë trupit të tij gjetëm armë tjetër, një «Beretë». Ndoshta ishte revolveri i atij dëshmorit të luftës dhe Çonda e kishte sjellë për mua, domethënë për muzeun.

Ai mori çantën në dorë, për të qenë i gatshëm, dhe ne i zbrazëm gotat.

— Përsëndete Anën nga unë, të lutem.

— Do ta përsëndes, — tha Kondoja.

Ndërsa po dilnim, dëgjuam boritë e autobusëve. Po bëhesha gati t'i zgjasja dorën, kur ai tha:

— Ana e ka takuar Peron.

— Cilin Pero? — u habita, se më kishte shpëtuar ky emër.

— Atë, pra, që u ndodh pranë Çondës kur vdiq Kania. Vajtëm bashkë me Anën për ta takuar. Peroja i kishte marrë vesh edhe ato që ngja-

në më vonë dhe unë e pyeta se cili ishte mendimi i tij. Ai tha se çdo gjë që njeriu përpiqet ta kalojë nga kurrizi i të tjerëve në kurrizin e tij, sado e rëndë qoftë, nuk është kurrë po ajo. Njeriut prandaj nuk i mërzhitet jeta, sepse vetë atij i bie të provojë vetëm një pjesë të vogël të asaj që heqin të tjerët. S'e paskeni vënë re, na tha Peroja, edhe të flasësh për të tjerët, gjithmonë është më lehtë!

Një bori u bë alarmuese dhe Kondoja vrapoi për të zënë autobusin. Nuk e ktheu kokën nga unë. Po mendoja se e kishte të rëndë dhe se, ndoshta, kurrë më nuk do të fliste për të kaluarën. Kjo ishte puna e tij, po ç'armë kishte zgjedhur për t'u mbrojtur prej saj?

Nuk është për t'u çuditur që Kondoja të shpresonte se e kishte gjetur për vete *këmishën e hekurt*. Ai ishte hequr para meje si një tjetër dhe gjithçka e kishte rrëfyer me gojën e Baltazarit, me të cilin kishte mbajtur në fëmijëri të njëjtin emër, atë të një klouni.

Hyra në bar dhe banakieri më pyeti nëse do të pija prapë konjak.

— U ktheva për valixhen time të udhëtimit,
— thashë.

Tetor-dhjetor 1989

45812



Pedagogjike
Pomdeli Setiri

Ne SE 21. tetor
Be MA 6. Gusht
hi Ja 6. shtator

WWW.COM.NEBELI.ARABI/ALBANI

Çela, Zija **SEMAJA**
Gjaku i dallëndyshes: Roman / Zija Çela;
Red.: A. Plasari. — T.: Naim Frashëri,
1990. — 216 f.; 18 cm.
891.983-31
Ç 37

~~Ne 1 shi~~
~~Be 7 20 shi~~
~~hi 3 shi~~

U dorëzua për shtyp më 23 qershor 1990
Doli nga shtypi në gusht 1990.

Tirazhi 20000 kopje Formatii 49x78/16 Stash 2204-82

Shtypur Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1990

“... Varreza jonë është
është e përbashkët e
nuk të duket e çuditshme
aq të lirë dhe aq të lidhur
të thuash: gjysmë
vdekur. Ne jemi lënë
të shohim, por deri ne
rtesës na është ndaluar
kush ka guxuar, ka qenë
ato që dyshohej, janë këto
në natën e parë... A
se ajo që kishte ndodhur
sëritshme dhe ia vlen të
hesap.”

“... Wishim për të u
orë të mira bashkë dhe
tepër në hesap ishte koha
me gjithfarë përgjigjesh
etjesh që më ngjallte kra
s'do të mjaftonte. Më erdhi
instikti i Shternit: njeri
tregojnë ashtu si dinë.”

të e përbashkët, sepse
shkuara jonë. Dhe a
ne që ne jemi rritur
hur?! Është një lloj si
gjallë e gjysmë të
lirë të zgjedhim,
parë të ma-
jonë të prekim.
në : nëmur dhe për
urdisur edhe kurthe
të mbushet mendja
është krejt e papër-
ta tregoj? Vëre në

dhëtuar nja gjashtë
e ajo që vura më
na. Po ta ndërprisja
e me gjithfarë py-
ëshëria e parë, koha
zhi në ndihmë edhe
ëzitet duhen lënë të